

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail: gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXVI - Nr. 7871 E premte 3 Maj 2019 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion i Ditës

Të diplomuarit dhe të punësuarit mbas të ashtuquajturës “veprimtari armigësore” në naftë, në vitin 1974, mund të konsiderohen pa hezitim një ...

Vijon në faqen 20

Nga FATOS ÇOÇOLI

Për ata që kanë naftë në vend të mushkërive



Opinion i Ditës

Me avionin privat të Lordit të Marecit të gjithë personat e rëndësishëm të politikës shqiptare ishin nisur për në kryeqytetin e Gjermanisë, për të marrë pjesë në një ngjarje ...

Vijon në faqen 21

Nga BERAT BUZHALA

Drama në Berlin, kush, çfarë i tha kujt (dhe Baton Haxhiu über alles)



Dardan Hajdini: Nuk është grabitës

Djali i “dajës” nga Kosova: Ai mori pjesë në varrimin e Admir Muratajt

Vëllai i Ragip Hajdinit: Nëse ka lidhje me “Rinasin”, le të mbahet 30 vjetë në burg

TIRANË-Tri javë pas grabitjes spektakolare në Rinas, kanë reaguar djali dhe babai 50-vjeçarit Ragip Hajdini i njohur me nofkëm “daja”. Ata kanë deklaruar dje për mediat se ai është i pafajshëm dhe nuk ka lidhje me grabitjen e milionave euro në barkun e avionit që kishte si destinacion Vjenën. Djali i kosovarit, Dardani dhe vëllai i të arrestuarit, Mustafai ...

Në faqen 9

DOKUMENTI/ PROPOZIMI I BASHES: MANDAT 4-6 MUJOR, JO MINISTRA TE PS

OPOZITA: JA PLATFORMA PER QEVERI TRANZITORE

Mbështetësit e PD-LSI bllokajnë rrugët në 12 qarqet e vendit: Të shtyhen zgjedhjet vendore. Basha hedh poshtë mundësinë e paktit me Ramën: S’ka koalicion PS-PD



(Në foto) Mbështetës të opozitës ndezin tymuese ndërsa kanë bllokuar hyrjen e Tiranës të rrethrotullimi ‘Shqiponja’

“EUROPEAN INTEREST”

Shqipëria ka nevojë për shtet të fortë, jo drejtues të fortë

NGA MONIKA KRYEMADHI
Në faqen 19

“ZGJEDHJET NUK SHTYHEN”

Ndryshon Kodi Penal, Rama: 10 vjetë burg për ata që abuzojnë me sigurinë ushqimore

Në faqen 5

DOKUMENTACIONI

Del kalendari, datat e provimeve të shtetit për çdo degë të mjekësisë

Në faqen 11

30 QERSHORI

Surpriza e zgjedhjeve, regjistrohen dy koalicione

Në faqen 4

REPLIKA PAS SAMITIT



“Berlini”, Haradinaj, i përgjigjet Ramësi: Shqiptarëve u kam borxh të vërtetë

Në faqen 14

Panairi “Work and Study”, stenda pushtohet nga maturantët e interesuar

“Luarasi”, ja bursat që ofron universiteti

Aelita Mani: Prezantuar ofertën financiare për vitin e ri akademik

NGA VOLTIZA DURO

Në ditën e tretë dhe të fundit të panairit “Work & Study”, zhvilluar në kryeqytet, stenda e universitetit “Luarasi” është “pushtuar” nga maturantët. Qindra të rinj kanë shfaqur interes për të studiuar në



këtë institucion elitare të arsimit të lartë dhe janë informuar në mënyrë të detajuar mbi programet e studimit në 3 fakultetet e “Luarasit” si në nivelin Bachelor, ashtu edhe në master. Staf akademik i këtij universiteti i ka shpjeguar ...

Në faqen 10

PROTESTA OPOZITA

Opozita paralizon qarkullimin në gjithë vendin, hidhen flakadanë dhe digjen goma

Valentina Madani

Opozita bllokoj dje për dy orë me radhë në 12 qarqe akset kryesore të rrugëve në vend, në shenjë proteste duke kërkuar largimin e kryeministrit Rama, si personi përgjegjës për bashkëpunimin me krimin në blerjen e votës. Policia u detyrua që të devijonte trafikun në rrugë dytësore. Kreu i PD, Lulzim Basha ishte në Elbasan, në bllokimin që u bë te kryqëzimi i Bradasheshit, ndërsa Monika Krymadhi iu bashkua protestuesve te zona e Plepave në Durrës. Basha në ecje me protestuesit në Elbasan u shpreh: "Mirënjohje për qëndresën e jashtëzakonshme që keni demonstruar deri më sot". Protestuesit hodhën flakadanë, shashka, tymese dhe dogjën goma. Ish-deputetët e opozitës ishin bashkë me protestuesit të përgjendur në disa akse kryesore kombëtare në vend. Ata u vendosen në pikat kyçe në 12 qarqe ku bllokuan lëvizjen në shenjë proteste kundër qeverisë dhe për plotësimin e kërkesave të opozitës së bashkuar nga ora 18:00 deri në orën 20:00. Përgjendrimi më i madh i deputetëve ishte në Shkodër dhe Tiranë. Qarkullimi u bllokua në qarkun Kukës-Ura e Drinit në hyrje të Rrugës Kombit, qarku Shkodër, në zonën e quajtur Krye-Bushat, qarku Lezhë në rrotullimin e rrugës së Milotit ku lidhet rruga me Kosovën, Qarku Dibër, bllokim në rrugën që lidhet me Bulqizën, qarku Tiranë-Rrethrotullimi i sheshit "Shqiponja", qarku Durrës, aksin Durrës-Kavajë, në rrethrotullimin pranë vendit të quajtur zona e Plepave, qarku Elbasan në Bradashesh pranë Karburant Gega, Qarku Fier, ura e Mbrostari, rrethrotullimi i Sheqit, qarku i Beratit, grumbullimi tek Ura e Haniit, qarku Korçë. Tek rrethrotullimi në Ramiq, në hyrje të Korçës, qarku Vlorë- Rruga në hyrje të superstradës Vlorë, Levan, qarku Gjirokastrë- Ura Leklit në Tepelenë. Kreu i PD, Lulzim Basha nga Elbasani deklaroi se nuk do të ketë asnjë hap pas, por vetëm para. Mesazhi i Shqipërisë së bashkuar -tha Basha- është i qartë, Rama ik! "Nuk ka asnjë hap pas, por vetëm para para në betejën për liri dhe demokraci. "Rama ik! Mirënjohje për mijëra shoferë që iu bashkuan protestës tonë. E gjithë Shqipëria e bashkuar çon një mesazh të qartë: Rama ik! Shkaktari i krizës totale të Shqipërisë, njeriu që ia mbylli përsëri dyert Evropës ka bërë zullume dhe

Mosbindja civile, opozita bllokon akset kryesore në 12 qarqe

Basha: Të caktohet një datë tjetër për zgjedhjet vendore



Kreu i PD-së, Lulzim Basha dje në Elbasan

BLLOKIMI

Kreu i PD, Lulzim Basha ishte në Elbasan, në bllokimin që u bë tek kryqëzimi i Bradasheshit, ndërsa Monika Krymadhi iu bashkua protestuesve tek zona e Plepave në Durrës. Basha në ecje me protestuesit në Elbasan u shpreh: "Mirënjohje për qëndresën e jashtëzakonshme që keni demonstruar deri më sot".

BELIND KËLLIÇI

"Dialog me Edi Ramën nuk mund të ketë. Mundësia iu dha më 17 maj, por ai e shkeli këtë marrëveshje dhe vodhi zgjedhjet dhe është ai që përmes prokurorisë bllokon heitmet e dosjeve 339 dhe 184. Pa u zbardhur ky krim elektoral nuk mund të ketë dialog me Edi Ramën. Nuk duam pushtet në tavolinë, por duam zgjedhje të lira dhe të ndershme"-tha Belind Këlliçi, kreu i FRPD.



Kreu demokrat Lulzim Basha gjatë prezantimit të detyrave të qeverisë tranzitore

Paloka: Protestat do të përshkallëzohen, Rama në burg

Nënkryetari i PD, Edi Paloka deklaroi dje se opozita do të vazhdojë të protestojë. Z.Paloka bëri të qartë se nëse Rama nuk tërhiqet, protestat do të përshkallëzohen. "Kryeministri duhet të tërhiqet sa më parë. Është vetëm e opozitës, por është gjithë qytetarëve shqiptarë për t'i hapur rrugë zgjedhjeve të lira në Shqipëri. Për bllokimin e rrugëve i them shqiptarëve që të na mirëkuptojnë. Në Shqipëri janë 3 lloj qytetarësh. Ata që sot protestojnë. Ata qytetarë që kanë pranuar të ulin kokën përballë Ramës le të vazhdojnë. Nuk po flas fare për shërbëtorët e Ramës. Ne do të protestojmë dhe do të kërkojmë ndryshim, sepse ajo që na pret është shumë më e keqe sesa qëndrimi dy orë në rrugë. Këto janë sakrificat të vogla që i kërkojnë qytetarëve. Ky është një akt, një sinjal që jepet. Nëse Rama do të vazhdojë me arrogancë, qytetarët na kërkojnë me përshkallëzim të situatës. Pas dyerve të burgut do të jetë Rama", -tha z.Paloka.

"Një i çmendur ka marrë peng vendin"

Protesta, Kryemadhi: Shqiptarët do t'i japin fund gjenocidit heshtës

Kryetarja e LSI-së, Monika Kryemadhi u bë dje pjesë e protestës së opozitës, për bllokimin e rrugëve nga Durrësi. Kryemadhi shprehu shqetësimin se "jemi në situatën kur shqiptarët janë të gatshëm për t'i dhënë fund këtij gjenocidi heshtës". Kryemadhi tha se Rama ka marrë peng Shqipërinë dhe institucionet demokratike të saj, duke i futur nën thundrën e vet. "Edi Rama ka marrë peng Shqipërinë, ka kapur të gjitha institucionet demokratike, duke iu humbur peng funksionet që kanë. Rama është një i çmendur që duhet të shkojë në burg për të këqijat që i ka bërë popullit shqiptar. Ajo deklaroi se nuk dëshironte përshkallëzimin e protestës, por kërkonte re-

flektimin e PS-së, ndërsa theksoi se opozita nuk ka qëllim pushtimin e godinave dhe rrugëve, por ka qëllim të pushtojë mendjet dhe zemrat e shqiptarëve. "Sistemi është rënuar për shkak të kapjes së shtetit dhe çdo segmenti. Një demokraci pa liri, është autokraci, diktaturë. Do dëshiroja mos kishte përshkallëzim, të shikoja një reagim nga PS, për t'i kthyer vlerat, e për ta kthyer në shinat kushtetuese, në atë kornizë të socialdemokracisë. Përsh-



kallëzimi nuk është mirë as për PS, as për qeverinë, por mbi të gjithë nuk është mirë për shqiptarët. Mosbindja civile dhe përshkallëzimi

nuk ka filluar akoma. Jemi në atë shkallë për të thënë se shqiptarët janë të gatshëm për t'i dhënë fund këtij gjenocidi heshtës. Gjenocidit kanë sjellë shpërngulje të madhe njerëzore dhe të gjitha popujt i janë përgjigjur me luftë. Ajo që është e rëndësishme është që opozita nuk ka qëllim pushtimin e godinave dhe rrugëve, ka qëllim të pushtojë mendjet dhe zemrat e shqiptarëve", tha kryetarja e LSI-së.

krime në shtëpitë dhe jetët e çdo shqiptari", deklaroi z.Basha. Kreu i PD-së foli për një datë tjetër jashtë asaj të 30 qershorit për mbajtjen e zgjedhjeve lokale dhe atyre të parakohshme. "Të caktohet një datë tjetër për zgjedhjet vendore dhe më pas ato të parakohshme. Zgjedhje pa opozitë nuk do të ketë. T'i japim fund tranzicionit të tejgjatuar. Ju ftoj të gjithëve në protestën e 11 majit në protestën e katërt kombëtare. Jam këtu për një të nesërme më të mirë. Opozita

është mazhoranca morale e këtij vendi", deklaroi z.Basha. **INCIDENTET** Protestuesit në Fier çanë kordonin e policisë për të vazhduar rrugën ndërkohe që në Berat u dogjën gomat në mes të rrugës. Ata i bënë thirrje policisë që të hapin rrugën dhe të mos pengojnë qytetarët të protestojnë. Një protestues nga Korça i bëri thirrje kryeministrit Rama që të largohet, pasi në të kundërt do ta pësojë si Çausheku. "Kjo protesta është bërë

për të përmbysur atë qenin, kriminelin, bastardin që ia ka vënë thikën në grykë të gjithë popullit. Prandaj ai të qërohet që mos e pësojë si Çausheku",-tha protestuesja. Opozita bllokoj rrugën edhe në aksin Tepelenë-Gjirokastrë, ku nuk munguan edhe konfrontimet mes ish-zyrtarëve dhe policisë. Ish-kryetari i Komunës Lazarat, Dasho Aliko u konfrontua me policinë për shkak se kërkoi zhbllokimi i rrugës, pasi qytarët, që do shkonin në shtetin fqinj Gre-

qi dhe që ishin kthyer prej andej ishin të revoltuar për situatën. Në Durrës u ndalua një autoambulancë ndërkohe që protestuesit kërkuar të shohin brenda nëse kish të pacient, dhe vetëm pasi u siguruan e lejuan që të kalojë. Edhe protestuesit në Shkodër kërkuar largimin e Edi Ramës, ndërsa kërkojnë qeveri tranzitore. Protestuesit kanë thirrur në korr: "Rama ik, Rama ik", "E duam Shqipërinë si gjithë Europa" etj. Në Tiranë protestuesit ndezën tymese dhe

flakadanë dhe lëshuan thirrje "Rama ik". Në krye të protestuesve ishin ish-deputetët të opozitës. Sekretari i përgjithshëm i Partisë Demokratike, Gazment Bardhi i ndodhur tek rrethrotullimi në sheshin "Shqiponja" bëri të qartë se PD-ja nuk do të ulet në tryezë me shaktarin e krizës politike, i cili sipas tij është kryeministri Edi Rama. Edhe në qarkun e Dibërës, pati shumë anëtarë, qytetarë dhe simpatizantë bllokuan rrugët, ndërsa dogjën goma automjetesh.

REDAKSIA: Redaktor i Suplementeve dhe Sociale: Rezarta Delisula, Redaktor i Rrethve: Trëndafille VISHA, Redaktor i Kulturës: Fatmira Nikolli, Art Designer: Nevila SAMARXHI.

ADMINISTRATA: Përgjegjëse e Financës: Alma Smokthina 0682074397, Shpërndarja: Elvis Lliaka Cel 0682074416, Marketingu: Cel:0688087823-email:marketing@gazetashqiptare.com, ADRESA: Ish-Drejtoria e Uzinës

së Autotraktoreve, Tiranë - Tel:(04) 2359-104 Tel&Fax:(04) 2359-116 Marketingu: Tel:(04) 2359-104/359-123. Tiranë, Internet: www.balkanweb.com, Email: gazetashqiptare@hotmail.com; redaksia@gazetashqiptare.com, SHTYPUR në "Klasik" Shpk



PD prezanton strukturën e qeverisë kujdestare për zgjedhje të lira: Jo ministra të PS

Basha: Qeveria tranzitore 4-6 muaj para zgjedhjeve, jo koalicion PS-PD

"Zgjedhje me Ramën, as pa opozitën nuk do të ketë"

Valentina Madani

Opozita e Bashkuar prezantoi djetërat e qeverisë tranzitore që ajo propozon për organizimin e zgjedhjeve të lira e të ndershme. Dhjetë (10) janë djetërat që do të ketë sipas demokratëve kjo qeveri, të cilat i paraqiti para medias dhe shoqërisë civile. Platforma e opozitës parashikon goditjen ndaj çdo strukture politike dhe kriminale që përfshihen në shpërbërjen e votës, ndalimin e presionit qeveritar mbi drejtësinë për t'i hapur rrugë hetimit të krimtë dhe pushtetarëve për manipulimin e zgjedhjeve. Sipas platformës, qeveria tranzitore do të ketë 10 djetëra kryesore ku mes të cilave ajo e goditjes së strukturave politike në përfshirjen e shpërbërjes së votës; pajisjen e shtetasve me letërnjoftime; shkëputjen e qeverisë nga krimi apo dhe monitorimit ndaj presionit që ushtrohet ndaj administratës publike. Qeveria tranzitore, sipas Lulzim Bashës, do të qëndrojë në detyrë për një periudhë 4 deri në 6 muaj.



KOHËZGJATJA

Qeveria tranzitore, sipas Bashës, do të qëndrojë në detyrë për një periudhë 4 deri në 6 muaj. "Në disa vende ka një praktikë ku ministrat që kanë përgjegjësi për infrastrukturën zgjedhore 3-6 muaj para zgjedhjeve zëvendësohen nga figura politike apo jo me konsensus opozitar", deklaroi z.Basha.

kuhor të 15 viteve. Kreu i demokratëve Lulzim Basha nuk i dha një përgjigje shteruese, duke lënë ende të hapur diskutimin mbi pika të platformës së partive aleate, që nuk janë pjesë e marrëveshjes së firmosur me koalicionin opozitar: Sipas tij 6 muaj para çdo procesi zgjedhor duhet të nisë punë qeveria kujdestare. "Në disa vende ka një praktikë ku ministrat që kanë përgjegjësi për infrastrukturën zgjedhore 3-6 muaj para zgjedhjeve, zëvendësohen nga figura politike apo jo me konsensus opozitar", deklaroi z.Basha. Duke e konsideruar largimin e Ramës si garanci për zgjedhje të lira, Basha tha se prokuroria nuk funksionon dhe deri tani çdo hetim për blerje votash është lënë në harresë.

ZGJEDHJET

Në prezantimin e detyrave të qeverisë kalimtare, kryetari i PD-së, Lulzim Basha, bëri të qartë se nuk do të lejohet zgjedhje pa opozitën dhe as diktimi të tyre nga bandat kriminale. I bindur se zgjedhje me Edi Ramën nuk do të ketë Basha shprehur bindjen e plotë se ka ardhur koha që vota e shqiptarëve të lexohet drejtë. "Me sistemin elektoral, proporcional rajonal, parlament me 100 deputetë, sistem me dy dhoma, senat, maxhoritar i pastër janë disa nga idetë. Zgjedhje me Ramën nuk do të ketë, as zgjedhje pa opozitën nuk do të ketë. Zgjedhjet do të mbahen pasi të ndëshkohen hajdutët e votave të vitit 2017", deklaroi z.Basha. Për kreun e PD-së, krijimi i një qeverie tranzitore dhe zbatimi i platformës do të mund të nxirrte vendin nga kolapsi institucional dhe ekonomik. Sipas Bashës, e vetmja mënyrë për t'u përballur me këtë qeveria është mosbindja civile.

PROPOZIMET E OPOZITËS PËR QEVERINË KUJDESTARE, DETYRAT TË DETAJUARA

LUFTA KUNDËR SHITBLERJES SË VOTËS

- Ashpërsimi i goditjes së krimtë të organizuar nga policia.
- Goditja me tolerancë zero e shitblerjes së votës.
- Kërkesë ndaj prokurorisë dhe SHISH për të hetuar me prioritet krimin zgjedhor, veçanërisht dosjet 184 dhe 339.
- Vendosja e institucioneve ligjzbatuese qeveritare (Policia, Drejtoria e Pastrimit të Parave etj.) në funksion të goditjes së krimtë zgjedhor.

ABUZIMI ME BURIMET SHETËRORE

- Ndalim i menjëhershëm i përdorimit të burimeve materiale dhe financiare me ndikim në zgjedhje.
- Moratorium i punësimeve deri në datën e zgjedhjeve.
- Monitorim i rreptë i penalizimeve dhe përfitimve sociale (ndihma ekonomike, personat me aftësi të kufizuara, banesat sociale) dhe vënies para ligjit e shkelësve.
- Ndalim i aktivitetëve promovues qeveritare në fushatë zgjedhore.
- Moratorium i akteve qeveritare që krijojnë përfitim të periudhë zgjedhore.

PRESIONI MBI ADMINISTRATËN DHE ZGJEDHËSIT

- Ngritja e strukturave për mbikëqyrjen, denoncimin, regjistrimin dhe ndjekjen e rasteve të presionit mbi zgjedhësit, sidomos atyre në administratë.
- Prioriteti dhe tolerancë zero në hetimin dhe ndëshkimin e presioneve mbi administratën dhe zgjedhësit.
- Koordinim institucional me prokurorinë për të hetuar presionin mbi zgjedhësit.

IDENTIFIKIMI I BESUESHËM I ZGJEDHËSVE

- Fuqizim dhe financim i menjëhershëm i infrastrukturës për pajisje me letërnjoftime.
- Skema subvencionimi të çmimit të letërnjoftimit për personat në nevojë.

MONITORIMI DHE NDËSHKIMI TË RASTEVE PENGUESË PËR ZGJEDHËSIT

- Fushatë proaktive ndërgjegjësimi dhe njoftimi.
- Ngritja e një sistemi për verifikimin e letërnjoftimeve në çdo QV dhe goditja penale e falsifikimeve.

LISTAT E ZGJEDHËSVE & SISTEMI I ADRESAVE

- Regjistrim derë më derë i shtetasve dhe identifikim i adresës së çdo shtetasi.
- Integrimi i adresave me Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile.
- Regjistrim i zgjedhësit vetëm në listën e QV që i korrespondon vendbanimit faktik.
- Përditësim i hartave zgjedhore.
- Masa për caktimin e adresës së zgjedhësve emigrantë dhe caktimin e QV përkatëse.
- Hartim i listave të zgjedhësve drejtpërdrejt nga Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile.

VOTIMI FIKTIV I EMIGRANTËVE

- Ngritja e një sistemi kontrolli dhe monitorimi të hyrje-daljeve në kufi dhe në sistemin TIMS.
- Sigurimi i aksesit të plotë në TIMS për KQZ-në për të hetuar ankesat për votim fiktiv të emigrantëve.
- Ndjekje penale me tolerancë zero të shkeljeve.

ROLI I POLICISË NË ZGJEDHJE

- Monitorim institucional i veprimtarisë së policisë në proces zgjedhor.

RAPORTIMI DHE NDËSHKIMI I SHKELJEVE.

- Largim i menjëhershëm i drejtuesve dhe policëve të lidhur me krimin.
- Prioriteti në goditjen e krimeve zgjedhore.
- Garantim i sigurisë në zgjedhje dhe goditja e bandave.
- Nxjerrje e akteve ligjore që disiplinonin rolin e policisë në zgjedhje.
- Raportim transparent i veprimtarisë së policisë.

OERD BYLYKBASHI

Prezantimin e detyrave të qeverisë kalimtare e bëri Oerd Bylykbashi. Për asnjë nga 10 pikat e parashtruara nuk kërkohet ndryshime në Kodin Zgjedhor. "Zgjedhjet e lira dhe të ndershme janë themeli i legjitimitetit të parlamentit qeverisë dhe pushtetit vendor", -tha ish-deputeti i PD-së.

DETYRAT E QEVERISË TRANZITORE QË DO ÇOJË VENDIN NË ZGJEDHJE TË PARAKOHSHME

- Opozita publikon 10 djetëra konkrete të qeverisë tranzitore, e cila do ta çojë vendin në zgjedhje të parakohshme.
- 1.Goditje me tolerancë zero e strukturave politike dhe kriminale të përfshira në shpërbërjen e votës, intimidimin e votuesve dhe manipulimin e zgjedhjeve.
 - 2.Ndalim i presionit qeveritar mbi drejtësinë për t'i hapur rrugë hetimit të bashkëpunimit me krimtë të organizuar dhe pushtetarëve për manipulimin e zgjedhjeve.
 - 3.Monitorim i rreptë dhe goditje me tolerancë zero ndaj presionit mbi administratën publike dhe zgjedhësit.
 - 4.Ndalim i prokurimeve, tenderëve, koncesioneve/PPP-ve, licencave, favoreve dhe abuzimeve të tjera me burimet shtetërore.
 - 5.Kontroll dhe mbazje masash për emërimet dhe shkarkimet e paligjshme nga administrata publike dhe kompanitë shtetërore, si dhe për ndryshimet e paligjshme në listat e ndihmës ekonomike, personave me aftësi të kufizuara etj.
 - 6.Pajisje e shtetasve me letërnjoftime, skema lehtësuese dhe hetim penal i falsifikimeve të letërnjoftimeve.
 - 7.Regjistrim i adresave të të gjithë shtetasve dhe hartim me integritet i listave të zgjedhësve.
 - 8.Hetim dhe ndëshkim me tolerancë zero i votimit fiktiv të emigrantëve.
 - 9.Shkëputje e lidhjes së policisë me krimin, goditje e policëve të inkriminuar, angazhim i policisë kundër krimtë zgjedhor dhe garantim i sigurisë në zgjedhje.
 - 10.Raportim me transparencë i veprimtarisë ligjzbatuese dhe akses i besueshëm për opozitën.

kërkojë disa muaj kohë duke mos saktësuar se sa do të jetë mandati. Duke iu referuar marrëveshjes së vitit 2017 Basha tha se qeveria teknike nuk funksionoi, sepse Rama ishte kryeministër dhe se raportimi me 400 faqe u la në harresë. "Eshhtë e vërtetë që task forcë e zgjedhjeve 2017 nuk funksionoi. Këtë po kërkojmë sot. Të largojmë shkakuin e mosfunksionimit. Ka një raport prej 400 faqesh të task forcë të ministrave teknikë", deklaroi z.Basha. Kreu i PD-së iu kundërpërgjigj dhe akuzave se opozita po kërkon fitoren në tavolinë. "Kundërshtari ynë politik thotë që ne kërkojmë pushtetin në tavolinë, por, në fakt, pushtetin në tavolinë e ka marrë Edi Rama. Në tav-

olinë ulur me Emiliano Shulazin, Ymer Lalën, Bajret", deklaroi z.Basha.

MANDATI

Kreu i opozitës njehej nevojën për dialog, por nuk lëviz nga qëndrimi i tij edhe pas kërkesës së grupimit të qendrës së djathtë drejtuar presidentit për një tryezë mazhorancë-opozitë me përfaqësim në nivel kryetarësh. Parashikimin për 30 qershorin, e shëh në rastin më të mirë jo si ditë zgjedhesh, e në më të keqin si një përsëritje të historisë diktatoriale. Sa i përket përbërjes apo kohëzgjatjes së kësaj qeverie tranzitore iu referua propozimit të grupimit të qendrës së djathtë për përcaktimin e një qeverie tranzitore 6 muaj përpara zgjedhjeve në harkun

ZGJEDHJET KOALICIONET

Krahas koalicionit të PS dje ka dorëzuar kërkesën edhe koalicioni i partive opozitare

Surpriza e zgjedhjeve, regjistrohen dy koalicione elektorale në KQZ

"Shpresa për ndryshimin" ka në përbërje 7 parti të djathta

Në zgjedhjet e ardhshme vendore të 30 qershorit do të konkurrojnë dy koalicione zgjedhore dhe disa forca të tjera politike që kanë vendosur të konkurrojnë me vete. Kështu në limitet e fundit ligjore, dje pasdite në KQZ kanë dorëzuar kërkesën për regjistrimin e dy koalicioneve zgjedhore. Krahas koalicionit të bërë publik pak ditë më parë "Aleanca për Shqipërinë Europiane" që kryesohet nga Partia Socialiste gjatë mbrëmjes së djeshme është dorëzuar kërkesa për regjistrimin e një koalicioni opozitar me emrin "Shpresa për Ndryshimin".

KOALICIONI PS

Ndonëse në dokumentin e firmosur pak ditë më parë në koalicionin "ASE" ishin renditur 24 parti së bashku me PS, koalicioni i dorëzuar dje nga PS përmban vetëm 21 të tilla. Partitë që janë pjesë e koalicionit me PS-në firmosën pak ditë më parë edhe një marrëveshje bashkëpunimi ku përcaktohej ndër të tjera se të gjitha mandatet për këshilltarë bashkiakë që mund të fitojnë partitë aleate në këtë koalicion, do të jenë në harmoni të plotë me politikën dhe strategjitë e aktivitetit të grupit të këshilltarëve të Koalicionit "ASE". Nga ana e saj Partia Socialiste e Shqipërisë në bazë të kësaj marrëveshje garanton aleatët se përfaqësuesit e saj në Komisionet zgjedhore dhe të numërimit të votave do të numërojnë dhe ruajnë me korrektesë çdo votë të partive aleate. Koalicioni i PS përmban afërsisht gjysmën e subjekteve të regjistruara në KQZ për të marrë pjesë në zgjedhjet e 30 qershorit dhe në përgjithësi janë parti tradicionale aleatë të PS-së, si PDS e Paskal Milos, PSD e Skënder Gjiniushit, PSM e Gjergj Kojës, PUK e Idajet Beqirit, etj. Por nuk kanë munguar në këtë koalicion edhe forca që në zgjedhjet e shkuara ishin pjesë e koalicionit të PD-së, siç është rasti i MEGA-s apo Partia Demokratike e Re Europiane e Koçi Tahirit. Nga ana tjetër, PS ka lënë jashtë koalicionin Partinë e Punës dhe Partinë Komuniste. Ndonëse në tryezën e para dy muajve Partia e Punës së Shqipërisë dhe Partia Komuniste e Shqipërisë - 8 Nëntori ishin pjesë e tryezës së thirrur nga PS, ato nuk figuronin në listën e partive që përbëjnë koalicionin zyrtar të PS.

KOALICIONI OPOZITAR

Nga ana tjetër koalicioni opozitar "Shpresa për ndryshimin" përbëhet nga një numër më i vogël partish politike. Sipas kërkesës së dorëzuar në KQZ në përbërje të tij janë vetëm 7 parti politike, kryesisht të spektrit të djathtë dhe shumica dërrmuese e tyre ish - aleatë të Partisë Demokratike. Kështu forca



KQZ

PARTITË E KOALICIONIT TË OPOZITËS

- ALEANCA KUQ E ZI
- BASHKIMI LIBERAL DEMOKRAT
- DEMOKRACIA E RE EUROPIANE
- ALEANCA POPULLORE
- PARTIA BALLI KOMBËTAR
- PARTIA EMIGRACIONI SHQIPTAR
- PARTIA ORA E SHQIPËRISË.

Vendoret, PS miraton listën me 61 kandidatët në fillim të javës

Paralelisht me krijimin dhe regjistrimin e koalicionit zgjedhor, Partia Socialiste po punon që të përmbyllë brenda afatit ligjor edhe procesin e zgjedhjes së kandidatëve për kryetar bashkie, aty ku ky proces nuk ka përfunduar ende si dhe të kandidatëve për këshilltarë. Madje kjo çështje ka qenë pjesë e diskutimeve edhe në mbledhjen me detyrë të mblylura të Grupit Parlamentar të PS-së, ku kryeministri Edi Rama ka dhënë udhëzimet që të zgjidhen kandidatët më të mirë. "Punoni për të gjetur kandidatuarat më të mira e të besueshme për kryetarë bashkish dhe këshilltarë. Të vijojnë takimet në bazë për



organizimin e strukturave për zgjedhjet e 30 qershorit. Kandidatët duhet të jenë të fortë, të zgjidhen sikur opozita do futet në zgjedhje", - mësohet të jetë shprehur Rama. Gjithashtu, mësohet se ai ka kërkuar që të shmanget çdo ndikim i deputetëve për të zgjedhur kandidat në bazë të lidhjeve të ngushta apo në

më e madhe që është pjesë e këtij koalicioni është Fryma e Re Demokratike e drejtuar nga Bamir Topi. Balli Kombëtar i Adriatik Alimadhit, Bashkimi Liberal Demokrat i Arjan Starovës dhe 4 parti të tjera më të vogla si: Demokratike e Re Europiane,

konflikt interesi. "Kandidatët për anëtarë këshillash të jenë njerëz pa lidhje me personat e zgjedhur, kushëri, krushku, miku dhe shoku", mësohet të jetë shprehur kryeministri Rama. Ndërkohë që lista përfundimtare e kandidatëve për kryetar bashkie pritet të miratohet në mbledhjen e kryesisë së PS-së që do të mbahet në fillim të javës së ardhshme dhe për të kaluar më pas për vendim-marrje në mbledhjen e Asamblesë Kombëtare që është parashikuar të mbahet në datë 10 maj, një ditë para protestës së opozitës. Kujtojmë që afati i fundit ligjor për dorëzimin e kandidatëve është data 13 maj.

vetme kushtetuese për përtëritjen dhe zhvillimin e një shoqërie demokratike është pjesëmarrja në proceset e saj zgjedhore; të shqetësuar se rrethanat politike të tanishme në Shqipëri po ndikojnë për krijimin e një klime mosbesimi në vlerat e

SHKURTE

Dy kandidatët të tjerë nga listat e PD marrin mandatin e deputetit

Dy kandidatët të tjerë nga listat shumëmbrore të Partisë Demokratike kanë dorëzuar dje formularin e dekriminalizimit në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, duke nënkuptuar kështu shprehjen e dëshirës për të marrë mandatin e deputetit. Ata janë Krenar Rryci, kandidat për qarkun Durrës dhe Durrësit dhe Kostaq Papa, kandidat për qarkun Tiranë. Ky është hapi i parë, që kandidatët bëjnë në rrugën deri në betimin në Kuvendin e Republikës, ndërsa Komisioni Qendror i Zgjedhjeve do të verifikojë paraprakisht emrat dhe formularët e tyre të dekriminalizimit. Po ashtu gjatë ditës së djeshme në media qarkulloi lajmi se edhe kandidatit dhe Ares Ypi po nga lista e Tiranës kishte dorëzuar formularin e dekriminalizimit në KQZ, informacion ky që u hodh poshtë nga vet kandidatit nëpërmjet një përgënjeshtrimi të shpërndarë nga zyra e shtypit e PD. Bashkë me këta kandidatë numri i deputetëve në Kuvend shkon në mbi 110, nga të cilët 79 janë të mazhorancës dhe pjesa tjetër të opozitës.

Gjikhuri pret Cutillon: Koordinim për vëzhgimin e zgjedhjeve

Sekretari i Partisë Socialiste për Çështjet Zgjedhore, Damian Gjikhuri ka pritur dje në një takim ambasadorin e Italisë në vendin tonë Alberto Cutillo me të cilin bisedoi mbi përgatitjet elektorale dhe reformën zgjedhore. Lajmin e ka bërë të ditur vetë Gjikhuri, teksa ka theksuar se në këtë takim u fol edhe për koordinimin me faktorët ndërkombëtarë për monitorimin e zgjedhjeve. "Procesi i reformës zgjedhore, agjenda e Komisionit të Posaçëm Parlamentar, krijimi i hapësirave për të gjithë aktorët brenda e jashtë parlamentit dhe koordinimi me institucionet ndërkombëtare që monitorojnë zgjedhjet ishin temat e diskutimit me ambasadorin e Italisë në Tiranë Alberto Cutillo dhe zv/ambasadorin Nicoletta Piccirillo", - shkroi Gjikhuri.

institucioneve demokratikë, ne si një grup i partive politike opozitare kemi vendosur së bashku për të marrë pjesë në zgjedhjet e ardhshme vendore si koalicion me emërtimin "Shpresa për ndryshimin". Nëpërmjet kësaj letre, partitë politike të posh-



Kryeministri Edi Rama gjatë mbledhjes së Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste

tëshnuara po i drejtohen Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për regjistrimin e tyre si koalicion në zgjedhjet e ardhshme vendore" - thuhet në kërkesën e këtij koalicioni. Ndërkohë që 14 parti të tjera do të garojnë si subjekte më vete.

**ZGJEDHJET**

"Në demokraci askush nuk është i detyruar të hyjë me zor në zgjedhje. S'është detyrë e qeverisë të fusë me zor në zgjedhje partitë, as e drejtë të shtyjë afatet pse disa parti nuk duan të hyjnë. Ndërsa për parti apo individë që duan të kthehen në zjarrvënës të zgjedhjeve ka një kapitull në Kod. Duhet të informojmë mirë publikun, në këtë aspekt Kodi Penal s'ka nevojë për asnjë ndryshim, përbën një bazë solide ligjore"



Kandidimi i Dakos, Balla: Këtë do e vendosë kryesia javën tjetër

Kryetari i Grupit Parlamentar Socialist, Taulant Balla ka konfirmuar edhe një herë vendosmërinë e mazhorancës për të shkruar në zgjedhjet e 30 qershorit, pavarësisht faktit se tashmë opozita ka mbetur jashtë këtij procesi elektoral. Në studion e News24, në rubrikën "Opinion", numri dy i PS-së tha se zgjedhjet e 30 qershorit do të jenë të lira dhe të ndershme dhe se qeverisja e socialistëve do iu sigurojë shërbimet qytetarëve edhe në ato bashki që deri tani janë drejtuar nga opozita. "Më 30 qershor më në fund ne do të arrijmë të japim shërbimet që duan qytetarët. Jemi në diskutime me partitë që përfaqësojnë minoritetet për të identifikuar kandidatë që vijnë nga këto minoritete", - u shpreh Balla. Sa iu përket kandidatëve ai tha se do të vendoset në mbledhjen e javës së ardhshme të kryesisë dhe do të shpallen në 13 qershor kur është edhe afati i fundit ligjor i depozitimit të tyre në KQZ. "Një prej ditëve të para të javës së ardhshme do kemi dhe mbledhjen përfundimtare të Kryesisë, institucioni vendimmarrës. Janë të shumta kandidaturat dhe kryesia do përcaktojë 61 kandidatët e saj", - tha ai. Ai nuk pranoi të shprehë nëse Vangjush Dako do të rikandidohet për Bashkinë e Durrësit, duke theksuar se këtë do e përcaktojë kryesia. "Javës tjetër do ju informoj për vendimet e kryesisë së PS. Vendimmarrjen e ka kryesia", - tha Balla.

Kreu i qeverisë ka hedhur poshtë mundësinë e shtyrjes së datës së zgjedhjeve

Rama: Deri në 10 vjet burg për ata që abuzojnë me sigurinë ushqimore

Forcim i dënimeve për dhunën për shkak të detyrës

Qeveria do të forcojë dënimet penale ndaj të gjithë atyre fermerëve dhe tregtarëve që abuzojnë me cilësinë e produkteve bujqësore dhe ushqimit. Nisur edhe nga debati më i fundit, ai për cilësinë e perimeve që prodhohen nga fermerët, kreu i qeverisë Edi Rama ka deklaruar dje gjatë mbledhjes së Grupit Parlamentar se do të ndërmerren masa për të forcur dënimet penale ndaj çdo abuzuesi me cilësinë ushqimore në vend. Sipas tij dënimet do të ashpërsohen duke parashikuar burg deri në 10 vjet për të gjithë ata që do të injektojnë substanca kimike të ndalura në prodhimet bujqësore dhe blegtorale si dhe ndaj atyre që falsifikojnë etiketat e cilësisë dhe garancisë për produktet e tjera ushqimore. "Dua t'i referohem disa neneve për sigurinë ushqimore, importimi, prodhimi, ruajtja, prodhimi, shitja apo vendosja në qarkullim e pijeve ushqimore, barnave, futja e kimikateve do të dënohet me burg. E njëjta gjë për tregtimin e produkteve jashtë afatit. Kjo është një lojë që vazhdon prej 30 vitesh, që afatet e përdorimit të produkteve ushqimore shkelen. S'ia ka borxh asnjë familje kësaj shumice që të rrijë dhe bëjë sehir, është një vepër që dënohet me 10 vjet burg", - tha Rama në fjalën e tij. Sipas tij shkelësit e sigurisë ushqimore nuk mund të dënohen më vetëm me gjoba. "Këtyre forcave të së keqes që guxojnë të kërcënojnë shëndetin e fëmijëve tanë dhe të gjithë atyre që në këtë vend konsumojnë ushqim, duhet t'u rezervojmë ndëshkimin më shembullor, të heqjes së lirisë së aktivitetit, dhe individuale", - tha Rama. Gjithashtu, kryeministri paralajmëron burg dhe kjo përmes ashpërsimeve të parashikimeve në Kodin Penal për këdo që ushtron dhunë ndaj personave në detyrë, përfshi policët, mjekët apo edhe arbitrat. "Domosdoshmëria mbi një përgjigje të prerë mbi dhunën, nga salla e parlamentit, deri në çdo metër katror të Republikës ekziston. Dhunën ndaj punonjësve të policisë që nga kundërshtimi me forcë i forcave të policisë, ndaj bluzave të bardha, në sport, posaçërisht, do të adresohet pa asnjë ekuivok në paketën e re të ndryshimeve në Kodin Penal" tha me tej kryeminis-



Kryeministri Edi Rama

Kryeministri e pranon, negociatat u shtynë për në shtator

Kreu i qeverisë, Edi Rama e ka pranuar dje se në qershor nuk do ketë hapje të negociatave të anëtarësimit në Bashkimin Europian për Shqipërinë. Duke folur në mbledhjen e grupit parlamentar, Rama ka sqaruar se pse çelja e negociatave u shty në qershor. Sipas tij sa i përket Gjermanisë çështja ka të bëjë me mungesën e kohës për miratimin e vendimit nga dalja e raportit të Komisionit Europian. "Jo vetëm që nuk bëhet llaft të na kenë thënë se Shqipëria e ka derën e mbyllur, por na kanë siguruar për disponimin pozitiv në njohjen e meritës së Shqipërisë përmes zyrtarizimit të çeljes së negociatave. E përdor termin zyrtarizim duke patur parasysh edhe shumë broçulla të thëna lidhur me si e kemi trajtuar qasjen e negociatave vitin e kaluar. I vetmi problem i miqve gjermanë, është



të se koha fizike nga data e daljes në ditën e vendimmarrjes është tejte e shkurtër. Pse KE vendosi të nxjerrë raportin në fund të majit, për të mos e nxjerrë gjatë zgjedhjeve të PE dhe për të mos e kthyer rekomandimin e pritshëm pozitiv si mish për top për fushatat në ato vendet ku problemi nuk është as ecuria faktike e vendit tonë për dinami-ka e brendshme elektorale dhe politike. Ndaj është folur për shtatorin nga pala gjer-

janë në burg për shkak të tyre dhe morën dhe do të marrin mbrapsht, deri kur të vazhdojnë kështu, vetëm përgjigjen proporcionale të forcave të rendit, asgjë më shumë dhe asgjë më pak", - tha Rama. Në mbledhjen e grupit parlamentar, ku dhe edhe mesazhin pas kthimit nga Samiti i Berlinit, kryeministri Edi Rama, u ndal edhe në zgjedhjet vendore të 30 qershorit, për të cilat u shpreh i bindur se nuk do të ketë shtyrje të tyre. "U tha se do më tërhiqnin veshin për zgjedhjet, nuk më zuri veshi, asnjë fjalë të kësaj natyre, zero. Në demokraci askush nuk është i detyruar të hyjë me zor në zgjedhje. S'është detyrë e qeverisë të fusë me zor në zgjedhje partitë, as e drejtë të shtyjë afatet pse disa parti nuk duan të hyjnë. Ndërsa për parti apo individë që duan të kthehen në zjarrvënës të zgjedhjeve ka një kapitull në Kod. Duhet të informojmë mirë publikun, në këtë aspekt Kodi Penal s'ka nevojë për asnjë ndryshim, përbën një bazë solide ligjore", - u shpreh Rama.

Marrëveshja e rishikuar për Bllokun 2 dhe 3 me kompaninë Shell garanton që shteti shqiptar të marrë përfitim që në fuçinë e parë të naftës që del nga nëntoka. Në një ceremoni të mbajtur këtë të enjte pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë u bë edhe nënshkrimi i dokumentit të rishikuar. Ministria për Infrastruktura dhe Energjinë Belinda Balluku u shpreh se rishikimi erdhi pas nënshkrimit të marrëveshjes për Bllokun 4 që vendosje të standard dhe balancë të re për përfitimin mes palëve. "Marrëveshja hid-

Nënshkruhet marrëveshja e amenduar me Shell, shteti merr fitim që në fuçinë e parë

rokarbure për kërkimin dhe prodhim në Bllokun 4 mes shtetit shqiptar dhe Shell në vitin 2017 shënoi vendosjen e një standardi të ri cilësor në këtë sektor si në aspektin teknik ashtu edhe në atë financiar. Në këtë marrëveshje sigurohet respektimi i plotë dhe balancimi mes palëve duke rritur kështu përfitimet e shtetit shqiptar krahasuar me marrëveshjet e mëparshme"-tha Balluku. Sipas saj nënshkrimi i kësaj marrëveshje cilësohet si një

arritje në drejtim të rritjes së bashkëpunimit dhe në drejtim të rritjes së sektorit të hidrokarbureve në vend. "Qeveria shqiptare është e angazhuar të nxisë dhe mbrojë të gjithë iniciativat e suksesshme të investitorëve"-nënvizoi Balluku. Përfaqësuesi i Shell nënvizoi se kompania është prezent në Shqipëri prej 2012 dhe aktiviteti vit pas viti ka ardhur në rritje. "Këtë vit do të operojmë Bllokun 4. Zotohemi të japim një kontribut poziti-

ndaj Shqipërisë dhe ky kontribut vjen përmes timitit dhe taksave por jo vetëm kaq, por edhe punësimi të individëve lokalë. Çdo ditë në bëjmë biznes me 200 nënkontraktorë shqiptarë, dhe në mënyrë të tërthortë kemi 300 punonjës lokalë që mbështesin projektet tona. Për nga natyra projektet e gazit dhe naftës kërkojnë kohë. Kjo do të thotë që ende kemi shpime pusesha para se të hyjmë përfitimin komercial të mund-



Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Belinda Balluku

shëm. Kjo kontratë siguron që përfitimet e palës shqiptare do të jenë dirtekte që në fuçinë e parë që do të nxirret. Kur bën një investim shumëdekladësh dhe shu-

më miliardësh kërkon garanci dhe kjo kontratë ofron këtë. Kjo marrëveshje është një shembull i mirë për Shqipërinë dhe Shell"-u shpreh përfaqësuesi i Shell.

Bashkimi i Prodhuesve për Sigurinë Ushqimore: Problem siguria dhe po deformon tregun

Siguria ushqimore, Kraja: Po dëmtohet shëndeti i konsumatorëve

Të hetohen dhe dënohen abuzuesit me prodhimet

Bashkimi i Prodhuesve Shqiptarë ngre shqetësimin në lidhje me abuzimet që po ndodhin në tregun ushqimor, duke pranuar se po dëmtohet shëndeti i konsumatorëve, por edhe po deformohet tregu. Prodhuesit kërkojnë hetim të personave që abuzojnë si dhe marrjen e masave ndaj tyre. Bashkimi i Prodhuesve Shqiptarë doli dje në një deklaratë për shtyp në mbrojtje të shëndetit të konsumatorëve dhe në mbështetje të prodhuesve të ndershëm. Në fundmi siguria ushqimore ka qenë në qendër të debatit publik, pas raportimeve në media dhe shqetësimit të krijuar të qytetarët. Shoqata bëri me dije se, fenomeni po dëmton shëndetin e konsumatorëve dhe po deformon tregun dhe se mediat duhet të dalin patjetër me emra konkret. Sokol Kraja, përfaqësues i Bashkimit tha se nevojitet ndërgjegjësim i opinionit publik në lidhje me sigurinë ushqimore dhe ndajmë shqetësim të përbashkët për këtë fenomen. "Jemi po aq të ekspozuar ndaj rrezikut të ushqimeve të pakontrolluara. Ne kërkojmë nga institucionet publike monitorimin, identifikimin dhe ndëshkimin maksimal të çdo individi apo subjekti. Prodhuesit e ndershëm po preken nga akuzat dhe investitimet gjithëpërfshirëse, tha Kraja. "Vendi ynë ka një ekonomi që bazohet te bujqësia, agropëpunimi dhe turizmi. Çfarë mesazhi po japim në tregjet e huaja për prodhimet Made in Albania. Denoncimet duhet të jenë të vazhdueshme dhe me emra konkret. Denoncimet pa emër krijojnë panik dhe deformojnë tregun. Ne kërkojmë të forcohet kontrolli në treg"- shtoi Kraja. Në rast kur konstatohen shkeljet flagrante të referojnë menjëherë, bëri sërish ai thirrje. Prodhimi vendas ka nevojë për mbështetje dhe promovim, shtoi z. Kraja. Agim Rrapaj, president i Agrobiznesit shqiptar, tha



KËRKESA

Prodhuesit shqiptarë kërkojnë që të mos bëhet panik për çështjen e sigurisë ushqimore në vend. Prodhuesit bëjnë thirrje mediave si dhe organeve përkatëse të evitojnë denoncimet të pazabura dhe pa pro-

va konkrete abuzimi për të mos krijuar një panik kolektiv. Ekonomia vendase është e mbështetur në prodhimet bujqësore dhe në prag të sezonit të ri turistik kur pikërisht fillojnë eksportet më të mëdha në vend, duhet bërë kujdes për të mos dëmtuar imazhin e produkteve 'Made in Albania'. Produkti vendas është krenari kombëtare që duhet mbështetur, ndaj duhet të denoncohen shkeljet flagrante dhe çdokush që abuzon në treg. Por nga ana tjetër nuk duhet të dëmtohen përfaqësuesit e ndershëm të ekonomisë vendase që prodhojnë me standarde europiane, të cilët janë të gatshëm të krijojnë një aleancë për mbrojtjen e konsumatorit, nga mashtuesit dhe shkelësit e ligjit.



Raporti i Bankës së Shqipërisë

Kredia për shtëpi, ra me 1.3 për qind

Kredia për shtëpi e individëve është produkti më cilësor në treg të kredive të huasë bankare. Mbështetur në të dhënat e Bankës së Shqipërisë, raporti i kredisë me probleme për këtë produkt në fund të vitit të kaluar ishte 5.7%. Gjatë vitit 2018, ky tregues ra me 1.3 pikë përqindje, ndërsa është afërsisht sa gjysma e raportit mesatar të kredive me probleme të sistemit bankar shqiptar. Në tërësi, individët kanë një raport të kredisë me probleme shumë më të ulët krahasuar me bizneset. Në fund të vitit të kaluar, raporti i kredive me probleme për individët ishte 6.4%, ndërsa për bizneset ky tregues ishte në nivelin 14.3%. Po të krahasojmë këto dy shifra, mund të kuptohet qartë pse në vitet e fundit kreditdhënia ka qenë më e mirë të individëve. Kjo iu mundëson bankave më pak përqendrimet të mëdha dhe një shpërndarje më të mirë të rrezikut të kredisë. Në fund të vitit 2018, kredia për bizneset ishte rreth 13% më e ulët nga vlera më e lartë e regjistruar gjatë 5 viteve të fundit. Ndërkohë, kredia për individët ishte 23% më e lartë nga ajo 5 viteve më parë. Në tërësi, raporti i kredive me probleme është përmirësuar gjatë viteve të fundit. Fillimisht, kjo rënie është ndikuar sidomos nga fshirja e kredive të humbura, ndërsa së fundmi faktori që po ndikon më së shumti është shlyerja e kredive.

NOJFTIM SHITJE ME ANKAND

Përmbartimi Gjyqësor Privat "Jon 2014", me permbartuese Jonida Ujkashi do të zhvillojë Ankandin e pare për pasurine :

1- "ARE", me sipërfaqe totale 261.000 m², e ndodhur në Q/Ë Kamëz, Rrethi Tiranë, në Zonën Kadastrale: 2366, Numri i Pasurisë: 53/462, Vol. 45, Faqe. 63, me pronesi te Tajana Marri Allushi dhe Hassan Sulejman Allushi. Çmimi me të cilin filloin shitja e kësaj pasurie është në vlerën e 1,000,000 (një milion). LEKË

Ankandi i pare per pasurine e mesiperme zhvillohet me date 15.05.2019, ora 16:00 në ambientet e Zyris se permbartuese gjyqesore private Jonida Ujkashi me adresë: "Rr. "Myslym Shyri, vila nr.8/1,kt.4,Tiranë,nr.kontakti 0699381883.

INSTAT: "'Boom' vizitorësh në parqet arkeologjike dhe Bibliotekën Kombëtare"

Parqet arkeologjike në Shqipëri kanë njohur një rritje të ndjeshme të vizitorëve gjatë muajit mars. Referuar të dhënave të publikuara nga INSTAT, rezultoni se numri i vizitorëve në parqet arkeologjike, në tremujorin e parë 2019 është 19.881, me rritje prej 43,3%, krahasuar me të njëjtin periudhë, të vitit të mëparshëm. Po ashtu, më rritje është edhe frekuentimi i muzeve ku rezultoni se numri i vizitorëve në muze, në tremujorin e parë 2019 është 25.916, duke shënuar rritje



me 5,9%, krahasuar me tremujorin e parë 2018. Në kala e monumente të tjera, numri i vizitorëve ka një rritje prej 2,5% ndërmjet tremujorit të parë 2019 dhe të njëjtit tremujor në vitin 2018. Në tremujorin e parë 2019, numri i viz-

itorëve të huaj në muze, parqe dhe kala ishte 15.846, duke shënuar një rritje me 27,4%, krahasuar me tremujorin e parë 2018. Përqindja më e lartë e vizitorëve të huaj është në muze, përkatesisht 27,4% të huaj nga totali i vizitorëve në muze. E njëjta tendencë rritje konstatohet edhe me frekuentimin e Bibliotekës Kombëtare. Në tremujorin e parë 2019, numri i frekuentuesve në Bibliotekën Kombëtare ka qenë 30.669, duke shënuar një rritje me 64,3%, krahasuar me të njëjtin periudhë të një viti më parë.

Treguesit fiskalë të periudhës janar-mars 2019, nuk realizohet plani i arkëtimeve

Në arkën e shtetit "mungojnë" 108 miliardë lekë

Bien të ardhurat nga TVSH-ja, ulen investimet kapitale

Në arkën e shtetit mungojnë rreth 108 miliardë lekë, sipas statistikave të publikuara nga Ministria e Financave... Sipas të dhënave të publikuara djeh mësohet se në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë, të ardhurat janë rritur me 2.6%... Duke reflektuar inflacionin prej 1.7% (mesatarja janar-mars) dhe rritjen e pritshme ekonomike prej rreth 4%, rezultoni se performanca reale e të ardhurave tatimore ishte me një rënie prej 3.1%... Edhe në raport me planin, financave u mungojnë 1.6 miliardë lekë për tre muajt e parë të vitit, ose rreth 13 milionë euro.

TREGUESIT FISKALË TË KONSOLIDUAR PËR JANAR-MARS 2019. Table with columns for Nr., EMERTIMI, Fakt 2018, Plan 2019, Fakt 2019, Differenca Fakt 2019 vs Plan 2019, and Differenca Fakt 2019 vs Fakt 2018. Includes sections for Totali të Ardhurave, Te ardhura nga ndihmat, Te ardhura tatimore, Nga Tatimet dhe Doganat, Te ardhura nga Punëtarët Vendor, Te ardhura nga Pensionistët, Te ardhura nga Fondet speciale, Sigurimi Shëndetësor, Te ardhura nga Banka dhe Shopërisë, Sigurimi Shtetëror, Te ardhura nga tregëtimet dhe shërbime, Të ardhurat nga tregëtimet dhe shërbime, Të ardhurat nga tregëtimet dhe shërbime, Të ardhurat nga tregëtimet dhe shërbime.

TOTALI I SHPENZIMEVE. Table with columns for Nr., EMERTIMI, Fakt 2018, Plan 2019, Fakt 2019, Differenca Fakt 2019 vs Plan 2019, and Differenca Fakt 2019 vs Fakt 2018. Includes sections for Personeli, Korigjencat për sigurime shoqërore, Arsimi i Lartë nga të ardhurat e veta, Korigjencat për sigurime shoqërore, Shpenzimet Operative Mbledhëse, Shpenzimet për fondet speciale, Sigurimi Shoqëror, Fondet për pagime, Fondet shpërndarë për pensionistët, Shpenzimet në shtet, Shpenzimet për shërbime të tjera, Shpenzimet për shërbime të tjera, Shpenzimet për shërbime të tjera, Shpenzimet për shërbime të tjera, Shpenzimet për shërbime të tjera.

dhe dhe që është një tregues direkt i konsumit në ekonomi ranë me 3.7% në raport me të njëjtën periudhë të një viti më parë, duke zbritur në 32.4 miliardë lekë, dhe duke rezultuar 2.1 miliardë lekë më pak se plani... Të dhënat më të detajuara tregojnë se të ardhurat nga TVSH kanë rënë si nga tatimet (-14.9%) ashtu dhe nga doganat (-5.6%). Me rënie të ardhurash ishte taksa na-

cionale dhe të tjera, me ulje prej 13.3%, duke zbritur në 8 miliardë lekë. Financat kanë arritur të mbledhin nga ky zë, ku pjesën më të madhe e zë renta minierare, 1 miliardë lekë më pak sesa plani... Performancë positive kishte tatimi mbifitimim, me rritje 20% me bazë vjetore për periudhën janar-mars, duke arritur në 11.7 miliardë lekë. Me rritje të ndjeshme ishin të

ardhurat nga pushteti vendor, ku efektin e dhanë taksat lokale, me një rritje prej gati 60%, ku ndikimin kryesor e jep taksa e infrastrukturës... Ndërsa të ardhurat nga taksa e pronës ranë me 0.4%. Pushteti lokal nuk po arrin të mbledhë më shumë të ardhura nga kjo taksa, pa varësisht përpjekjeve përmes ndryshimit të formulës së mbledhës ajo, bazuar në

vlërën e pronës. Të ardhurat nga sigurimet shoqërore e shëndetësore u rritën me 5.4%, në përputhje me planin. ULEN INVESTIMET Shpenzimet ranë me 2.7% për periudhën janar-mars 2019, në raport me tremujorin e 2018-s, duke zbritur në 104.4 miliardë lekë... I gjithë kursimi ka ardhur si rrjedhojë e reduktimit të shpenzimeve kapitale, që ranë me

13.7% në raport me janar-mars 2018, duke zbritur në 9.1 miliardë lekë. Në raport me planin, shpenzimet kapitale ishin 2.7 miliardë lekë më pak. Pavarësisht ambientit me norma të ulëta, shpenzimet për interesa u rritën me 12.2%. Mbjajtja në kontroll e shpenzimeve, ka bërë që deficit në tre muajt e parë të vitit të bëjë me 28.5%, në 3.6 miliardë lekë.

Llogaritja e Bankës së Shqipërisë

Qeveria i ka borxh 1.5 miliardë euro bizneseve dhe individëve



Foto ilustruese

lekë më shumë se llogaritë e arkëtueshme. Detyrimet financiare e përgjithshme të sektorit të qeverisë së përgjithshme vlerësohen në

nivelin 1,2 triliardë lekëve, nga 1,18 triliardë lekë në fund të vitit 2016, ku pjesa më e madhe i takon borxhit publik. Instrumenti kryesor

i financimit i përdorur nga qeveria e përgjithshme vijon të jenë "letrat me vlerë të borxhit", të cilat përbëjnë rreth 48% të totalit të detyrimeve. Mbjajtësit kryesorë të letrave me vlerë të borxhit të qeverisë janë korporatat e tjera depozituese, në një total prej 343 miliardë lekë. "Huatë afatgjata", ashtu si letrat me vlerë, kanë luajtur rol të rëndësishëm si instrumente financiare për qeverinë e përgjithshme, dhe zënë 36% të detyrimeve totale. Në fund të vitit 2017, huatë arritën nivelin 434 miliardë lekë, nga 422 miliardë lekë në vitin 2016, me një rritje vjetore prej 2.7%. Financuesi kryesor i borxhit të qeverisë së përgjithshme (hua dhe letra me vlerë) është sektori i jorënditëve, i cili mban rreth 46% të totalit, i shoqëruar nga sektori i korporatave të tjera depozituese në rreth 34%. Detyrimet financiare më formën e llogarive të pagueshme të vlerësuar në llogaritë financiare, në terma absolutë shënuan rreth 190 miliardë lekë në fund të vitit 2017, nga rreth 203 miliardë lekë në fund të vitit 2016.

Porti i Vlorës, kalata lindore drejt rikonstruktimit, do destinohet për anijet turistike

Porti i Vlorës do të orientohet drejt përpunimit të trageteve dhe anijëve turistike. Në dokumentet e veta portit detar "Vlorë" sh.ka. ku kërkohet një kompani që do të hartojë projektin për rikonstruksionin e kalatës lindore bëhen të ditura edhe detajet. Aktualisht porti i Vlorës e zhvillon aktivitetin e vet për punëpunë në dy kalata, kalata lindore ku përpunohen anijet tregtare dhe kalata perëndimore ku përpunohen anijet tregtare. "Kalata lindore me një platformë betoni mbi pilota, shtrihet rreth 330 m nga bregu i detit, ka një thellësi maksimale prej 10.5 m, përpunohen anije tregtare deri në 6000 tonë. Është ndërturn me seksione midis viteve 1943 dhe 1973. Vazhdimi i kalatës në drejtim të tokës shërben si rrugë hyrëse. Në projektin e "Rehabilitimit të portit të Vlorës", hartuar nga GIBB në vitin 1997 dhe rishikuar nga grupi projektes Joint-venture më vonë, kalata lindore ka qenë e destinuar për t'u shembur (e amortizuar totalisht). Me përfundimin e punimeve të investimit prej 15 milion Euro për "Rehabilitimit të Portit të Vlorës" me kontraktor Shqegërimë "Piacentini Construccioni", përpunimi i anijëve që sot realizohet në kalatën lindore do të realizohet në kalatën perëndimore. Pozicionimi i portit të Vlorës pranë shtetësoris kryesorë të qytetit, Lungomare, si dhe kalimi i një pjese të aktivitetit tregtar tek Petrolifera, e kthejnë portin e Vlorës në port turistik. Rrjedhimisht kalata lindore do të destinohet për anije turistike" thuhet në dokumentet e Autoritetit Portual të Vlorës. Porti i Vlorës është porti i dytë i Shqipërisë, i radhitur pas portit të Durrësit për sa i përket madhësisë dhe kapacitetit. Është një port i hapur me dy kalata, në të cilat përpunohen anije tregtare dhe tragete. Porti i Vlorës është pjesë e rrjetit të shërbimit të 8-të. Falë pozicionit gjeografik që ka giri i Vlorës, mungësë së rrymave të fuqishme, baticave/zbativace të forta që mund të ndikojnë në lundrim, aksesimi i portit të Vlorës nga mjetet lunduese apo ankormimi i tyre në radë është i thjeshtë. Kompanitë që do të shprehin interes për të hartuar projektin për rikonstruksionin e kalatës lindore kanë kohë deri më 7 maj për të paraqitur ofertat. Fondi limit për këtë procedurë është mbi 10 milionë lekë.

NJOFTIM SHITJE ME ANKAND Përbarimi Gjyqësor Privat "Jon 2014", me përmbarese Jonida Ujkashi do të zhvillojë Ankandin e treq për pasurinë: 1- "Triull" me sipërfaqe 250 m2 dhe sipërfaqe ndërtëse 85m2, e ndodhur në Bllinckë, Devoll, në Zonën Katedrale. 1222 Numri i Pasurisë: 1831/50. Vol. 20. Faza: 70, në pronësi të Vasi Fotit Mucku. Cmimi me të cilin fillon shitja e kësaj pasurie është në vlerën e 630,000 (qashtëqind e tridhjetë mijë) LKË. Ankand i treq për pasurinë e mesjerme zhvillohet me datë 23.05.2019, ora 16:00 në ambientet e Zyrës së përmbarese gjyqësore private Jonida Ujkashi me adresë: Rr. "Myslym Shyri, vlla nr.81,Kt.4,Tiranë, nr.kontakti 0699381883.

I akuzuari është hetuar disa herë për vjedhje të kryera në disa rrethe të vendit

Vrasja e ish-policit Arben Bilali, gjykata lë në burg bashkëpunëtorin Arben Xhetani

47-vjeçari u kap nga kamerat e sigurisë teksa largonte një pistoletë nga vendi i ngjarjes

TIRANË

Një ditë pas arrestimit si bashkëpunëtor në ekzekutimin e ish-policit Arben Bilali, Gjykata e Tiranës ka lënë në burg 47-vjeçarin Arben Tirana (Xhetani). Sipas burimeve nga policia, ai dyshohet se u ka siguruar mjetin tip "Benz" autorëve të vrasjes, i cili u gjet vetëm pak minuta më vonë i braktisur në Mjull Bathore, çka do të thotë se është takuar dhe i ka parë autorët e krimit. Ndërkohë, mësohet se 47-vjeçari nga Shkoza rezultoi të jetë filmuar nga katër kamera sigurie që ndodhen pranë zonës, ku mbeti i vrarë ish-efektivi i policisë, Bilali. Në kamera, Xhetani shihet teksa largon një pistoletë nga vendi i ngjarjes, pistoletë, e cila dyshohet të jetë e autorëve të krimit apo edhe e vetë ish-policit të vrarë. Më herët Xhetani kishte mohuar të kishte lidhje me pistoletën e gjetur në vendin e ngjarjes. Arben Bilali u ekzekutua pranë shtëpisë së tij me 10 plumba, ndërsa familja e tij ishte në konflikt dhe e ngjuar. 50-vjeçari kishte dalë nga bane-sa disa orë para se ta qëllonin. Ai po kthehej në shtëpi me një makinë tip "Golf 4", ku po udhëtonte si pasagjer. Makina e tij është vënë në



ish-efektivi i policisë, Arben Bilali

ndjekje nga 2 atentatorët që udhëtonin me një "Benz" të zi. Kamerat e sigurisë tregojnë se ai u ndoq për rreth 9 kilometra që prej kryqëzimit të "Vasil Shantos" deri në rrugën "Daniel Ndreka" ku kishte shtëpinë. Ndërkaq, bëhet me dije se i arrestuari në lidhje me këtë ngjarje, Arben Tirana (Xhetani) njihet si person me precedent të mëparshëm penal, kryesisht në fushën e vjedhjes së automjeteve.

E SHIKUARA E ERRËT E ARBEN XHETANIT

Ngjarjet, për të cilat Xhetani është hetuar më parë, kanë ndodhur në Tiranë, Durrës, Lushnjë, Vlorë, por edhe në qytete të tjera. Por

ngjarja që bëri më shumë bujë, për të cilën Tirana u shpall fillimisht në kërkim e më pas u arrestua, ka qenë ajo e vitit 2013, kur u vodh atashu ushtarak i SHBA-ve në Lushnjë. Për këtë ngjarje, ai u arrestua nga shërbimet e Komisarariatit nr.1 të Tiranës, tre muaj pasi kishte ndodhur vjedhja në Lushnjë. Ngjarja kishte ndodhur në korrik të 6 viteve më parë. Burimet zyrtare të Drejtorisë së Policisë së Fierit bënë të ditur në atë kohë se ka qenë ora 17:30 e pasdites, kur atashu ushtarak që shërben në ambasadën shqiptare në SHBA, i cili po udhëtonte me një furgon nga Tirana drejt Vlorës dhe



Vendi ku ndodhi ngjarja

pasagjerët e tjerë që ndodheshin në të njëjtin automjet, janë ndalur për një kafe disaminutëshe në një bar në autostradën Lushnjë-Fier. Atashu ka pasur me vete edhe një çantë, në të cilën kishte një kompjuter portativ, ku kishte të dhëna të shërbimit që kryente dhe sende të tjera që i përkisnin punës. Sipas dyshimeve të policisë, duke qenë se nga paraqitja e jashtme, ai ndryshonte nga pasagjerët e tjerë të furgonit, është pikasur nga tre autorët e dyshuar, mes tyre edhe Arben Tirana, që ish-in ulur më parë në të njëjtin bar e po konsumonin nga një pije. Ata kanë vërejtur se para se

të zbriste, atashu ishte kujdesur ta vendoste çantën e tij në një prej sediljeve të furgonit dhe kanë vendosur ta vjedhin atë, me shpresën se mos aty gjendeshin sende me vlerë. Gjithashtu, hajdutët janë siguruar se shoferi i furgonit nuk i ka mbyllur dyert e mjetit. Sapo atashu ka porositur kafën, tre autorët janë ngritur dhe dy prej tyre kanë shkuar tek automjeti personal, të cilin e kishin parkuar para lokalit. Kur ata kanë ndezur makinën, tjetri ka nxituar të shkojë tek furgoni e të marrë çantën e atashut dhe janë larguar që të tre me shpejtësi me një autoveturë tip "Peugeot".

KAMERAT E SIGURISË

47-vjeçari Arben Tirana (Xhetani) nga Shkoza rezultoi të jetë filmuar nga katër kamera sigurie që ndodhen pranë zonës, ku mbeti i vrarë ish-efektivi i policisë, Bilali. Në kamera, Xhetani shihet teksa largon një pistoletë nga vendi i ngjarjes, pistoletë, e cila dyshohet të jetë e autorëve të krimit apo edhe e vetë ish-policit të vrarë. Më herët Xhetani kishte mohuar të kishte lidhje me pistoletën e gjetur në vendin e ngjarjes.

SHKURT

Vodhën motoskafin, kapen mat 3 grabitësit lushnjarë

SARANDË - Tre persona janë arrestuar për vjedhje në bashkëpunim nga policia e Sarandës. Sipas policisë në pranga kanë rënë shtetasit: E.G 31 vjeç, L.Xh. 24 vjeç dhe F.H. 30 vjeç, të tre me banim në Lushnjë. Mësohet, ndër të tjera, se të tre të rinjtë janë arrestuar në flagrancë në fshatin Xarrë të Konispolit duke udhëtuar me një makinë të tipit "Benz", brenda të cilit është gjetur edhe një motoskaaf, i cili sipas policisë rezultoi i vjedhur nga bane-sa e shtetasit me iniciale I.D. në Ksamil. Materialet iu referuan Prokurorisë në ngarkim për veprën penale "Vjedhja", e kryer në bashkëpunim", - njoftoi policia.

Sherr me njerëzit e gruas, vret veten 30-vjeçari

DIBËR - Një 30-vjeçar ka vrarë veten dje, pak pasi është konfliktuar me njerëzit e gruas së tij. Burime për "GSH" bëjnë me dije se ai ka rënë i identifikuar si Ari Hoxha, ka vrarë veten pas sherrit me njerëzit e bashkëshortes. Mësohet, ndër të tjera se ngjarja ka ndodhur në fshatin Plan i Bardhë të bashkisë Klos. 30-vjeçari ka vrarë veten 300 metra larg banesës së gruas së tij. Menjëherë pas ngjarjes policia ka mbërritur në vend, ku edhe është gjetur trupi pa jetë i 30-vjeçarit.

E zë korrenti, humb jetën peshkatar

LEZHË - Një peshkatar në njësinë administrative Balldrë të Lezhës ka humbur jetën teksa ka qenë duke peshkuar. Paraprakisht thuhet se ai ka rënë në kontakt me energjinë elektrike, pasi ka qenë duke peshkuar me pajisje elektrike, por nuk dihen më shumë detaje për ngjarjen. Viktima u identifikua si Aleksandër Dedgjoni 37 vjeç. Policia lokale po heton për rastin në fjalë.

Trafik kokaine, përfundojnë në pranga dy shqiptarët dhe marokeni në Itali

ITALI - Policia italiane në Marano të Riminit ka arrestuar 2 shqiptarë të moshave 23-vjeçare dhe një maroken të moshës 28-vjeçare. Ata akuzohen për trafik droge, të llojeve: kokainë, marijuanë dhe hashash. Pas raportimeve nga banorët, policia nisi investigime për grupin që shpërndante lëndë narkotike në zonë. Pas hetimeve prej 3 muajsh, tre persona me shtetësi të huaj u vunë në pranga. Ata nuk kishin leje qëndrimi të përhershme në Itali, ndërsa jetonin aty për kohësisht, raporton "AlpArkimini.it". Shpërndarësit e dyshuar të drogës shpërndanin lëndën narkotike për grup-mosha të ndryshme, nga të rinjtë deri



të të moshuarit. Dy nga 3 të arrestuarit u vunë në pranga në linjën e autobusit 11, në kohën që po bënin pazar për shit-blerje të drogës. Të rinjtë janë dërguar të gjithë në burg,

ndërsa të enjten gjykata jep për ta masën e sigurisë. Të arrestuarit janë befusuar, kur kanë parë përpara vetes policë, të cilët menjëherë iu kanë vënë prangat.

Shtyhet prapë seanca për Emiljano Shullazin, gjyqi në dorë të KLGJ-së

TIRANË - Shtyhet për të disatën herë seanca ndaj Emiljano Shullazit dhe 4 të pandehurve të tjerë të akuzuar si pjesë e bandës së tij. Senca e planifikuar ditën e djeshme në Gjykatën e Apelit për Krime të Rënda nuk është zhvilluar dhe shkak për këtë është bërë mosformimi i trupit gjyqës. Kujtojmë se një seancë më parë, mbrojtja e Shullazit dhe Zelës kanë bërë kërkesë për përjashtimin e gjyqtarës dhe gjatë ditës së djeshme kërkesa është pranuar. Pas kësaj, mësohet se Gjykata Apelit për Krime të Rënda do t'i drejtohet Këshillit të Lartë Gjyqësor për të plotësuar trupin gjyqësor. Shullazi dhe grupi i tij u shpallën fajtorë nga Gjykata për veprën penale "shtrëngim me anë të kanosjes për dhënim e pasurisë", në dëm të Ylvi Beqajt. Kjo veprë penale, sipas Gjykatës, është kryer në formën e grupit të strukturuar kriminal. Pas dënimit nga Shkalla e parë, grupi i Shullazit e apelo vendimin, që vijon të zvarritet.



"Ragipi është viktimë, ai po akuzohet vetëm se mori pjesë në varrimin e Muratajt"

TIRANË

Tri javë pas grabitjes spektakolare në Rinas, kanë reaguara djali dhe babai 50-vjeçarit Ragip Hajdini i njohur me nofkën "daja". Ata kanë deklaruar dje për mediat se ai është i pafajshëm dhe nuk ka lidhje me grabitjen e milionave euro në barkun e avionit që kishte si destinacion Vjenën. Djali i kosovarit, Dardani dhe vëllai i të arrestuarit, Mustafa janë shprehur ditën e djeshme se Ragipi është thjesht një viktimë dhe se ka përfunduar në qeli për shkak të miqësisë me familjen Murataj. "Babai është i pafajshëm dhe nuk ka lidhje me këtë ngjarje kriminale. Arrestimi i tij është i padrejtë. Ne kemi të ardhura dhe nuk kemi nevojë të grabisim", u shpreh djali i Ragip Hajdinit. Ndërkaq, Mustafa Haxhiajdini, vëllai i Ragip Hajdinit, i cili mësohet se ka ndryshuar mbiemër gjatë luftës në Kosovë, ka pranuar të ketë njohje me familjen e Admir Muratajt. Ashtu si i vëllai edhe Mustafa Haxhiajdini ka deklaruar se kanë qenë në varrimin e tij në Tropojë. "Im vëlla nuk ka lidhje me grabitjen. Kemi njohje me familjen Murataj. Ishim në varrimin e Admir-it në Tropojë. Nëse im vëlla ka lidhje me ngjarjen, le të mbahet në burg, por prokuroria duhet të sjellë provat. Të vërtetohet përfshirjen e vëllait tonë në grabitje, dhe, nëse kjo vërtetohet, le të dënohet edhe me 30 vite burgim, jam i gatshëm t'ia firmos unë dënimin", tha vëllai i të arrestuarit. Gjithashtu, ky i fundit shpjegoi edhe se çfarë ka ndodhur në Kosovë me hetimet ndaj vëllait të tij për dy grabitje të ndodhura atje, njëra në Istog ku mbeti i vrarë edhe një polic, dhe tjetra, vjedhja e 24 kg ar në Dhomën e Provave në Komisarriatin e Pejës. Mustafa Hajdini sqaroi se vëllai i tij ka dalë i pafajshëm me vendim të gjykatës së Pejës, pasi nuk janë gjetur prova kundër tij. "Gjykata e Pejës ka marrë pafajesi, ka qenë i arrestuar, por nuk kishte dëshmi, vetëm policia i merr ato gjëra, se nuk mundet një njeri të marrë arin në polici", deklaroi Haxhiajdini. Sipas tij vëllai nuk njihet me pseudonimin "daja". "Askush nuk e thërriste me emrin "daja", nuk e kam dëgjuar kurrë. Atij i thonë "Gipe", tha Mustafa. Ndërkohë, avokati mbrojtës i Ragip Hajdinit, Mirash Ndoci deklaroi se klienti i tij po mbahet në qeli vetëm bazuar mbi deklaratimet e Alkond Bengasit, personi që modifikoi furgonin e autorëve të grabitjes e që tashmë ka fituar statusin e të penduarit të drejtësisë. "Klienti im Ragip Hajdini kërkon me çdo kusht të balafaqohet me Bengasin, po mbahet në burg vetëm mbi bazën e deklaratave të tij", pohoi avokati i tij mbrojtës. Ragip Hajdini u arrestua më 26 prill në zonën e Shkëmbit të Kavajës, si një nga të dyshuarit për grabitjen e 9 Prillit në Rinas. Arrestimi i tij

Djali i "dajës": Babai është i pafajshëm, kemi të ardhura, nuk na duhet të grabisim

Vëllai: Nëse Ragipi ka lidhje me ngjarjen, të mbahet 30 vjet në burg, por prokuroria duhet të sjellë prova



Djali i të arrestuarit, Dardan Hajdini



Mustafa Haxhiajdini



I arrestuari, Ragip Hajdini

Grabitja në 2017, gjykata s'pushon çështjen ndaj Admir Muratajt

TIRANË - Mungesa e certifikatës së vdekjes dhe ADN-së që të vërtetohet se Admir Murataj vdiq në grabitjen e 9 prillit në Rinas, ka bërë që Gjykata e Krimeve të Rënda të mos pushojë çështjen ndaj tij për një tjetër grabitje, atë të blindave të bankës në 2017. Mësohet se prokurori është mjaftuar në seancë me deklaratën se gjurmët e gishtërinjve të personit që u vra në shkëmbimin e zjarrit me policinë përkojnë me ato të Admir Muratajt ndonëse nuk ka ardhur akti ende. Por, pavarësisht kësaj mësohet se edhe Gjendja Civile në Tropojë nuk e ka bërë ende çregjistrimin e tij. Për këto fakte prokuroria kërkoi edhe dy javë të tjera kohë që këto dokumente t'i vihen në dispozicion nga grupi hetimor që po heton grabitjen e 9 prillit. Seanca e radhës u caktua në datën 14 Maj. Sipas prokurorit gjurmët e gishtave kanë vërtetuar që është Admir Murataj. Por gjykatësi Klodian Kurushi u shpreh se vetëm kjo provë nuk i mjafton gjykatës. Ndaj Admir Muratajt rëndojnë akuzat për tri grabitje 2015-2017, e para ajo e një banke të nivelit të dytë tek stacioni i trenit dhe goditja e blindave që transportonin para drejt Rinasit.

"Dua emrat e efektivëve të FNSH-së që e ndoqën"

Vajza e Admir Murataj padit Policinë e Shtetit në prokurori: Nuk qëlloi me armë, e vranë qëllimisht


hur avokati i familjes Murataj në një prononim për mediat. Gjithashtu, ai u shpreh se "Admir Murataj është qëlluar për t'u vrarë. Ai që e ka qëlluar duhet të vendoset përpara drejtësisë. Mundet që edhe punonjësit policisë mund ta kenë qëlluar për ta vrarë dhe kjo duhet hetuar për t'u vënë përpara drejtësisë". Sipas avokatit, Admir Murataj u vra qëllimisht nga policia pasi uniformat blu nuk kanë vepruar në kushtet e vetëmbrojtjes. Kërkesa e vajzës së Muratajt u drejtohet prokurorëve të çështjes: Eneid Nakuci, Arens Çela, Besnik Muçi. Në padinë e saj 23-vjeçarja, në cilësinë e trashëgimtarit të viktimit kërkon të hidhet dritë mbi dy pyetje që i parashtron në padinë dorëzuar prokurorisë së krimeve të rënda:



1- Cilët kanë qenë punonjësit e policisë me gjenralitetet përkatëse anëtarë të grupit të FNSH që kanë marrë pjesë në shkëmbimin e zjarrit të pretenduar në vjedhjen me armë të ndodhur në Rinas në datë 9 prill 2019?
2- A janë respektuar dispozitat përkatëse të ligjit nr

72/2014" për përdorimin e armëve të zjarrit" dhe akteve të tjera nënligjore nga anëtarët e grupit të FNSH të policisë së shtetit?
Gjithashtu, në padinë e saj, vajza e të ndjerit Admir Murataj, kërkon nga Prokuroria e Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Tiranë zgjerimin e rrethit të personave nën hetim, duke marrë si të dyshuar, për kryerjen e veprave penale: "Shpërdorim detyrë", "Vrasje me dashje" ose "Vrasje e kryer në kapërcim të mbrojtjes së nevojshme" edhe punonjësit e Policisë së Shtetit dhe konkretisht: F.N.SH. si grup i ndërhyrjes dhe ndjekjes së veprimeve, të personave të dyshuar për grabitjen ku në të cilën ka mbetur i vrarë Admir Murataj.

erdhi pas dëshmisë së dëshmitarit të drejtësisë, Alkond Bengasi, që tha se "daja" nga Kosova ishte një person tullac, të cilin e kishte takuar disa herë me Admir Muratajn. Por në seancën për caktimin e masës së sigurisë, i arrestuari i gjashtë për grabitjen hodhi poshtë akuzat e prokurorisë, duke mohuar të ketë lidhje me ngjarjen. Hajdini ndër të tjera tha se nuk është "daja" që kërkon policia, pavarësisht se thërritet me të njëjtin nofkë dhe se ka pamje filmike që tregojnë se ku ka qenë ditën e grabitjes.



Grabitja në Rinas, kërkohet arrestimi i 5 punonjësve të ICTS dhe bankave

TIRANË - Gjykata e Krimeve të Rënda ka kërkuar ndalimin e 5 personave pjesëtarë ICTS (kompania e sigurisë në Aeroport) dhe bankave, lidhur me grabitjen e 9 prillit në Rinas. Këto urdhra ndalimi kërkojnë, pasi 5 personat kanë shpërdoruar detyrën, raporton ABCNews. Tri banka i kanë kthyer përgjigje prokurorisë dhe kanë konfirmuar shumat, të cilat ato do të transportonin drejt Austri

trisë ditën e grabitjes. Në total shuma e grabitur është 6 milion euro.
Deri tani për këtë ngjarje janë arrestuar 6 persona, por asnjëri prej tyre nuk e di ku ndodhen paratë. Alkond Bengasi i penduari, i cili ka identifikuar këta persona si të dyshuar se kanë pasur dijeni për grabitjen. Por Ragip Hajdini, Oltjon Veseli, Renaldo Sula, Saimir Çela dhe Elton Pikli kanë mohuar përfshirjen e tyre në këtë grabitje.

PËRZGJEDHJA E UNIVERSITETEVE KU "LUARASI"

Njihuni me bursat e shumta që ofron universiteti, kriteret për t'i përfituar

"Luarasi" në panairin "Work & Study", interesim maksimal nga maturantët

Aelita Mani: Prezantuar ofertën financiare për vitin e ri akademik

Voltiza Duro

Në ditën e tretë dhe të fundit të panairit "Work & Study", zhvilluar në kryeqytet, stenda e universitetit "Luarasi" është "pushuar" nga maturantët. Qindra të rinj kanë shfaqur interes për të studiuar në këtë institucion elitë të arsimit të lartë dhe janë informuar në mënyrë të detajuar mbi programet e studimit në 3 fakultetet e "Luarasi" si në nivelin Bachelor, ashtu edhe në master. Staffi akademik i këtij universiteti i ka shpjeguar maturantëve edhe ofertën financiare të ofruar nga Luarasi për vitin 2019-2020. Drejtuesja e departamentit të Menaxhimit-Biznesit, Aelita Mani tregon se gjimnazistët kanë shprehur dëshirën për t'u regjistruar e për t'u bërë pjesë e KUL. "Universiteti "Luarasi", gjatë panairit "Work and Study", ka prezantuar ofertën akademike për vitin 2019-2020. Stenda e Universitetit "Luarasi" ngjalli shumë interes për maturantët pjesëmarrës në këtë panair, të cilët priten pozitivisht ofertën akademike të universitetit tonë. Në ditën e parë të Panairit Work and Study", stenda e universitetit "Luarasi" tërhoqi vëmendjen e gjimnazistëve të shumtë, të cilët kanë shprehur dëshirën e tyre për të vizituar dhe për t'u regjistruar në universitetin "Luarasi". Ne prezantuar, gjithashtu, para të rinjve edhe ofertën akademike dhe financiare për vitin e ri akademik", bën me dije Mani për "Gazeta Shqiptare". Kjo e fundit më tej thekson se akreditimi prej 6 vitesh e ka renditur "Luarasi" në një prej 4 universiteteve më të mira në vend e shton se mbi 80% e studentëve të diplomuar arrijnë të punësohen brenda 6 muajsh. Universiteti "Luarasi" është akredituar maksimalisht për 6 vite e kjo e liston në një ndër 4 universitetet më të mira në vend. Vlen të theksoj se edhe infrastruktura mësimore moderne bashkëkohore bën diferencën duke ofruar kushte studimi brenda standardeve europiane. Gjithashtu, e kemi të provuar se mbi 80% e studentëve tanë punësohen brenda gjashtë muajve mbas diplomimit në një kohë që shumë prej të diplomuarve vazhdojnë studimet doktorale në universitete prestigjioze ndërkombëtare; shton përgjegjësjë e departamentit të Menaxhimit-Biznesit. Ndërkohë pedagogu Fabian Pjetri, i pranishëm në stendën e "Luarasi" gjatë tre ditëve të panairit Work & Study" thotë se numri i maturantëve të interesuar për studime në këtë universitet ka qenë i lartë. "Ditën e parë të panairit qindra studentë kanë ardhur dhe janë interesuar pranë stendës sonë. I kemi pritur me kënaqësi dhe u kemi shpjeguar programet e studimit si dhe bursat e ndryshme që ofrojmë, duke nisur nga bursat e ekselencës deri të ato të nevojës", shprehet Pjetri për "GSH".



"Luarasi" gjatë panairit "Work & Study"

AELITA MANI PUNËSIM PAS DIPLOMIMIT

"Universiteti "Luarasi" është akredituar maksimalisht për 6 vite e kjo e liston në një ndër 4 universitetet më të mira në vend. E kemi të provuar se mbi 80% e studentëve tanë punësohen brenda 6 muajve mbas diplomimit në një kohë që shumë prej të diplomuarve vazhdojnë studimet doktorale në universitete prestigjioze ndërkombëtare", shton Mani.



FABIAN PJETRI PREZANTIMI I BURSAVE

"Ditën e parë të panairit qindra studentë kanë ardhur dhe janë interesuar pranë stendës sonë. I kemi pritur me kënaqësi dhe u kemi shpjeguar programet e studimit si dhe bursat e ndryshme që ofrojmë, duke nisur nga bursat e ekselencës deri të ato të nevojës", shprehet Pjetri për "GSH".



KARAKTERISTIKAT E UNIVERSITETIT:

- ▶ Akredituar maksimalisht për 6 vite;
- ▶ Infrastruktura mësimore moderne bashkëkohore;
- ▶ Besueshmëri e lartë publike;
- ▶ Personel akademik i kualifikuar dhe me eksperiencë në aktivitet shkencor dhe profesional;
- ▶ Besueshmëri e lartë e diplomave të lëshuara nga universiteti "Luarasi";
- ▶ Mbi 80% e studentëve punësohen brenda gjashtë muajve mbas diplomimit; shumë prej studentëve tanë vazhdojnë studimet doktorale në universitete prestigjioze ndërkombëtare;
- ▶ Studentët është në qendër të vëmendjes sonë;
- ▶ Ofron bursa studimi për arrijtjet në fushat akademike, Arte, Sporte, Leadership, si dhe Kategoritë Sociale në Nevojë etj.
- ▶ Edukim cilësor ndërdisiplinor sipas praktikave më të mira bashkëkohore;
- ▶ Nivel i lartë i ndërvëprimit ndërmjet pedagogëve dhe studentëve;
- ▶ Në zëmër të filozofisë tonë qëndron liria akademike, solidariteti, kreativiteti, inovacioni si dhe forca për t'u përballur me sfidat e shumta të shekullit XXI.

tur me kënaqësi dhe u kemi shpjeguar programet e studimit si dhe bursat e ndry-

shme që ofrojmë, duke nisur nga bursat e ekselencës deri të ato të nevojës", shprehet Pjetri

BURSAT QË MUND TË PËRFITONI:

- A. Bursat e Ekselencës** (shuma e bursës vjetore mbi tarifën e studimit 100%)
- A.1** Bursa ekselence 1-vjeçare për maturantët me mesatare të ponderuar 10.00 si dhe fituesit e vendit të parë të olimpiadave rajonale, kombëtare dhe ndërkombëtare në matematikë, fizikë, ekonomi, etj.
- A.2** Bursa ekselence 1-vjeçare për studentët që vazhdojnë studimet në universitetin "Luarasi" dhe kanë mbaruar vitin akademik pararendës me notën mesatare 10.00.
- B. Bursa Sociale**
- B.1** Bursa sociale për studentët: (shuma e bursës vjetore mbi tarifën e studimit 50%)
- ▶ Për aplikantët që vërtetojnë se i përkasin shtresave vulnerabël të shoqërisë;
 - ▶ për fëmijët e policit ose ushtarakt të rënë në detyrë;
 - ▶ etimët deri në moshën 25 vjeç
 - ▶ ata që kanë humbur kujdestarinë prindërore me vendim gjykatë
- se është person me aftësi të kufizuara;
- ▶ ata që vetë deklarojnë/vërtetojnë se janë romë apo ballkano-egjiptian.
- B.2** Bursa sociale për studentët që vërtetojnë si më poshtë: (shuma e bursës vjetore mbi tarifën e studimit deri në 50%)
- Anëtarë të familjeve në nevojë ekonomike:**
- Bursë 50% - 144.000 lekë të ardhura në vit;
- Bursë 40% - 244.000 lekë të ardhura në vit
- Bursë 30% - 480.000 lekë të ardhura në vit
- Bursë 20% - 528.000 lekë të ardhura në vit
- Bursë 10% - 600.000 lekë të ardhura në vit
- C. Bursa Liderशिपी** (shuma e bursës vjetore mbi tarifën e studimit 50%)
- ▶ Për të rinjtë aktivë që angazhohen dhe dinë të angazhohen të tjerë. --Të rinjtë që kanë treguar se kanë aftësi lideri dhe që duan të përfshihen akoma më shumë në zhvillimin e shoqërisë.
 - ▶ janë aktivistë të shoqërisë civile;
 - ▶ kanë eksperiencë në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare;
 - ▶ kanë kryer punë vullnetare që i shërbejnë publikut dhe të mirës publike;
 - ▶ kanë spikatur në forumet rinore të partive kryesore politike.
- D. Bursa Promovimi** (shuma e bursës vjetore mbi tarifën e studimit 50%)
- Për aplikantët që vërtetojnë se kanë prirje dhe arrijnë të spikatin në fusha të ndryshme si: arti, politika, sporti dhe shkenca, përmes certifikatave dhe dëshmimeve të ndryshme.
- E. Bursë për transferimin e studimeve** (shuma e bursës vjetore mbi tarifën e studimit 25%)
- Për studentët që transferojnë studimet nga universitetet e tjera partnere pranë universitetit "LUARASI".
- F. Bursë mbështetjeje**
- Studentët nga e njëjta familje, duhet të jenë në një certifikatë familjare dhe të kenë lidhje familjare si më poshtë:
- motër - vëlla; motër - motër; vëlla - bëlla;
 - prind - fëmijë, të cilët janë në të njëjtën certifikatë familjare;
 - ▶ burrë - grua do të përfitojnë zbritje të tarifës së studimit në formë burse, si më poshtë:
 - ▶ Studenti i parë 100%
 - ▶ Studenti i dytë 75%
 - ▶ Studenti i tretë 50%

për 'GSH'.

FAKULTETET

I pozicionuar në një nga zonat më të preferuara të kryeqytit, me një infrastrukturë të shkëlqyer dhe kushtet më të mira për mbarëvajtjen e mësimit dhe argëtimin e studentëve, universiteti "Luarasi" është një ndër universitetet që maturantët e kanë në opsionet e tyre për të ndjekur studimet e larta. Universiteti "Luarasi" ka tri Fakultete: atë të Drejtësisë, Ekonomisë dhe teknologjive të informacionit dhe inovacionit të cilat ngjallin shumë interes tek maturantët. Pas shpalljes së rezultateve të akreditimit të shkollave të larta publike dhe shtetërore, universiteti "Luarasi" është akredituar maksimalisht për gjashtë vite duke u renditur një në katër shkollat e larta më të mira të vendit duke u bërë kështu alternativa e parë për maturantët.

Dokumentacioni/ Kalendar i plotë edhe për infermierët, logopedistët e fizioterapistët

Zbardhen datat e provimeve të shtetit për profesionet në fushën e mjekësisë

Kur do të testohen mjekët, farmacistët e stomatologët

Voltiza Duro

Nga fillimi i muajit maj të këtij viti e në vazhdim do të zhvillohet provimi i shtetit për profesionet e rregulluara në fushën e mjekësisë. "Gazeta Shqiptare" zbardh sot kalendarin me datat përkatëse të testimit sipas profesionit të mjekut, farmacistit, stomatologut, mamisë, fizioterapistit, logopedistit, teknikut të imazherisë dhe teknikut të laboratorit. Qendra e Shërbimeve Arsimore njofton të gjithë kandidatët që të paraqiten pranë godinës së këtij institucioni 30 minuta para provimit. "Për të gjithë kandidatët aplikantë për provimet e shtetit për profesionet e rregulluara të mjekut, farmacistit, stomatologut, mamisë, fizioterapistit, logopedistit, teknikut të imazherisë dhe teknikut të laboratorit, ju bëjmë me se provimi i Shtetit për profesionet e rregulluara të fushës së mjekësisë do të zhvillohet nga fillimi i muajit maj 2019 e në vijim. Provimi i Shtetit do të zhvillohet në godinën e Qendrës së Shërbimeve Arsimore (më poshtë QSHA me adresë: Bulevardi "Zhan D'Ark", nr. 23, Tiranë (ose godina e ish-ATSH). Kandidati duhet të paraqitet në QSHA 30 min. para fillimit të provimit të shtetit",-bën me dije QSHA.

DOKUMENTACIONI

Qendra e Shërbimeve Arsimore thekson se kandidatët nuk duhet të harrojnë dokumentacionin ditën e testit. "Ditën e provimit kandidati duhet të jetë i pajisur me: Letërnjoftim (Kartë ID ose Pasaportë) për pjesëmarrje në provimin e shtetit (dokumenti origjinal); Kopje të Kartë ID ose Pasaportë; si dhe faturën e pagesës së tarifës së provimit të shtetit për llogari të QSHA, nga një bankë të nivelit të dytë/postë (sipas faturës për arkëtim të publikuar në faqen zyrtare të QSHA) sipas herës së pjesëmarrjes",-nënvizon QSHA. Kjo e fundit shton, gjithashtu, se fatura duhet të ketë vulën e bankës përkatëse.

RREGULLORJA

"Për paraqitjen në qendrat e provimit kandidati duhet të ketë parasysh rregullat e mëposhtme: ndalohe marrja me vete dhe përdorimi i celularëve dhe mjeteve të tjera të komunikimit gjatë zhvillimit të provimit, pasi kjo vlerësohet si kriter skualifikimi; ndalohe duhani, dhe konsumimi i ushqimit në mjediset e provimit; ndalohe komunikimi gjatë zhvillimit të provimit",-bën me dije Qendra e Shërbimeve Arsimore. Ndërkohë, tarifa e depozituar për llogari të Qendrës së Shërbimeve Arsimore, është e pak-



DATAT E TESTIT

"Për të gjithë kandidatët aplikantë për provimet e shtetit për profesionet e rregulluara të mjekut, farmacistit, stomatologut, mamisë, fizioterapistit, logopedistit, teknikut të laboratorit, ju bëjmë me se provimi i Shtetit do të zhvillohet nga fillimi i muajit maj 2019 e në vijim",-bën me dije QSHA.

TARIFAT

Ndërkohë, tarifa e depozituar për llogari të Qendrës së Shërbimeve Arsimore, është e pakthyeshme dhe e vlefshme vetëm për sezonin aktual të provimit të shtetit. Në bazë të vendimit "Për përcaktimin e tarifave për shërbimet e ofruara nga Qendra e Shërbimeve Arsimore" është parashikuar zhvillimi i provimeve të shtetit nga kandidatët, më shumë se 5 herë.

tyshme dhe e vlefshme vetëm për sezonin aktual të provimit të shtetit. Në bazë të vendimit Nr. 560, datë 29.09.2018 të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e tarifave për shërbimet e ofruara nga Qendra e Shërbimeve Arsimore" është parashikuar zhvillimi i provimeve të shtetit nga kandidatët, më shumë se pesë herë. "Për të gjithë kandidatët, lutemi të verifikoni emrin, atësinë, mbiemrin, si dhe datën dhe orën e provimit në faqen zyrtare të QSHA në adresën eëë.qsha.gov.al, rubrika lista e kandidatëve. Kandidatët lutemi të paraqiten vetëm në orarin e përcaktuar dhe publikuar në faqen web të QSHA. Në rast pasaktësie në të dhënat e paraqitura në web, lutemi të njoftoni përpara se të hyni në ambientin e provimit",-thotë QSHA.

E hënë 06.05.2019	E martë 07.05.2019	E mërkurë 08.05.2019	E enjte 09.05.2019	E premte 10.05.2019
		09:00 Mami	09:00 Mami	09:00 Mami
		11:30 Mami	11:30 Mami	11:30 Mami
		14:00 Mami	14:00 Mami	
E hënë 13.05.2019	E martë 14.05.2019	E mërkurë 15.05.2019	E enjte 16.05.2019	E premte 17.05.2019
09:00 Fizioterapi	09:00 Fizioterapi	09:00 Mjekësi	09:00 Teknik Imazherie	09:00 Logopedi
11:30 Fizioterapi	11:30 Fizioterapi	11:30 Mjekësi	11:30 Teknik Imazherie	11:30 Logopedi
14:00 Fizioterapi	14:00 Fizioterapi	14:00 Teknik Imazherie	14:00 Teknik Imazherie	
E hënë 20.05.2019	E martë 21.05.2019	E mërkurë 22.05.2019	E enjte 23.05.2019	E premte 24.05.2019
09:00 Stomatologji	09:00 Stomatologji	09:00 Farmaci	09:00 Farmaci	09:00 Teknik laborator
11:30 Stomatologji	11:30 Stomatologji	11:30 Farmaci	11:30 Farmaci	11:30 Teknik laborator
14:00 Stomatologji	14:00 Stomatologji	14:00 Farmaci	14:00 Teknik laborator	14:00 Teknik laborator
E hënë 27.05.2019	E martë 28.05.2019	E mërkurë 29.05.2019	E enjte 30.05.2019	E premte 31.05.2019
09:00 Infermieri	09:00 Infermieri	09:00 Infermieri	09:00 Infermieri	09:00 Infermieri
11:30 Infermieri	11:30 Infermieri	11:30 Infermieri	11:30 Infermieri	11:30 Infermieri
14:00 Infermieri	14:00 Infermieri	14:00 Infermieri	14:00 Infermieri	
E hënë 03.06.2019	E martë 04.06.2019	E mërkurë 05.06.2019	E enjte 06.06.2019	E premte 07.06.2019
09:00 Infermieri	09:00 Infermieri	09:00 Infermieri	09:00 Infermieri	09:00 Infermieri
11:30 Infermieri	11:30 Infermieri	11:30 Infermieri	11:30 Infermieri	11:30 Infermieri
14:00 Infermieri	14:00 Infermieri	14:00 Infermieri	14:00 Infermieri	
E hënë 10.06.2019	E martë 11.06.2019	E mërkurë 12.06.2019	E enjte 13.06.2019	E premte 14.06.2019
09:00 Infermieri				
11:30 Infermieri				

Kryebashkiaku: Do të hapim edhe 7 mensa sociale

Apartamentet e reja në Tiranë, Veliaj: 3% e tyre do të jepen për strehim social



gjithë aktet nënligjore që ta fusim në veprim, ku ne i kërkojmë ndërtuesve përveç se u kemi 10-fishuar taksat, se unë them që jo me oligarkët flitet me vepra, jo me fjalime. Unë besoj që sh-tesa 3% ndërtesave të reja të vendosura në dispozicionin të fondit të banesave sociale e bën akoma më demokratik këtë proces. Besoj që jemi një ndër vendet e rralla në rajonin tonë që e kemi këtë

politikë dhe që duhet shumë shpejt, vitin tjetër ta fusim në aplikim, por na ndihmon që të mos kthehen hapësirat e qendrave sociale në geto ku ne e dimë që në këtë komunitete dhe në këtë lagje, tek ky stacion autobusi janë vetëm këta të sociale, kurse këta të tjerët që janë më të barabartë se të barabartët janë nëpër lagje të tjera. Kjo s'ka sens dhe evitimi i getove është shumë i rëndë-

sishëm",-tha Veliaj. Ky i fundit shtoi se Bashkia e Tiranës ofron sot një nga paketat më të mira sociale jo vetëm në Shqipëri, por edhe në rajon. "Jam po ashtu krenar për kolegët e Bashkisë, është një ndër bashkitë në rajon që ofron paketën më bujare për qështjet sociale, sidomos për qështjet e strehimit",-u shpreh Veliaj. Kryetari i Bashkisë theksoi, gjithashtu, edhe hapjen e 7 mensave sociale, si një mundësi që çdo kush në Tiranë të mos vuaj për strehim dhe për të pasur një vakt të ngrohtë.

Blendi Salaj: Po e përjetojmë shumë mirë ardhjen e fëmijës

Gazetari i njohur baba për herë të dytë

Atmosfera në familjen Sala

Egla Xhemali

Gazetari i njohur shqiptar, Blendi Salaj më 1 maj festoi 40 vjetorin e lindjes. Ai u surprizua nga kolegët e tij 'live' në emision, megjithatë duhet thënë se surprizën më të madhe e morëm ne. Me anë të një fotoje të publikuar në 'Instastory', Blendi tregoi se bashkëshortja e tij është në pritje të një fëmije. "Është në furrë, po piqet" shkruan Salaj teksa ka vendosur dorën në barkun e partneres së tij. I kontaktuar nga "Gazeta shqiptare", për përjetimet e kësaj kohe kaq të veçantë e të bukur për ta, Blendi mjaft entuziast tha: Ne po e përjetojmë shumë mirë. Atmosfera në familje Salaj duket se është e jashtëzakonshme me zemrën që gufon nga lumturia, teksa presin që shumë shpejt të vij pjesëtari më i ri i familjes. Blendi prej shumë vitesh njihet si një ndër zërat më të ëmbël radiofonik, por jo vetëm. Salaj ka një djalë 8 vjeçar të quajtur Brian. E përtej shkëlqimit në ekran ai është shembull i një familjari që gjithkush do e ëndërronte. Edhe pse ka kaluar kohë nga njohja dhe rënia në dashuri me bashkëshorten e tij Anora, gjithçka duket fare e freskët dhe e prekshme nga rrjedha e kujtimit që do shënjonte një kapitull të ri për të dy. Me dashurinë e tyre ndërtuan një familje. Gazetari ka treguar se historia e tij e dashurisë ka lindur online. Me partneren është njohur në rrjetin social Facebook, e për të gjithë ata që janë skeptik ndaj lidhjeve virtuale, çifti Salaj është shembulli më i mirë që na bëjnë të besojmë se "po gjithçka mund të ndodh kur priremi të ndjekim zemrën". Ata kishin miq të përbashkët, por gjithçka nisi me 'një like' dhe pas saj, biseda me orë të gjata për të njohur më mirë njëri-tjetrin. Ishte koha e përumbjeve të ëmbla në ato ditë që kalonin pa kuptuar. Asokohe Blendi ishte në Shtetet e Bashkuara dhe e folura e tyre mesa ka pohuar vetë ai, ka zgjatur



rrth 2 apo 3 muaj para se ata të takoheshin për herë të parë. Ai është shprehur në media se për të ka qenë shumë e thjeshtë, pasi besonte se ndryshimi mes

personit virtual dhe atij që të paraqitet në të vërtetë është shumë i vogël. Në vendet perëndimore shumica e lidhjeve nisin online. Nga 'një like' në muaj të tërë

bisede virtuale, telefonata dhe lidhje me video-kamera, dashuria e Blendit dhe Anorës lindi dhe jo shumë vonë u zhvillua në martesë dhe u finalizua me ardhjen

në jetë të djalit të tyre. Briani 8 vjeçar para disa kohësh ka kërkuar të ketë një motër. E kështu çifti dha lajmin e bukur. Tanimë, pasi treguam edhe es-

encën e historisë së dashurisë së tyre nuk na ngelet të themi diçka tjetër, veçse të urojmë familjen Salaj që fëmija të vij shëndetplotë e që gjithçka të shkojë mirë!



Mbani frymën njerëz! Dafina Zeqiri bën ndryshimin drastik në pamje, kështu s'e keni parë kurrë

Dafina Zeqiri është padyshim një prej këngëtareve më të suksesshme, po ashtu dhe më të komentuar në show bizz-in shqiptar. Bukuroshja është shumë aktive në rrjetet sociale ku publikon për 1 milion ndjekësit e saj foto e video nga më të ndryshmet. Së fundmi, këngëtarja ka ndarë një imazh në "Instagram", ku ka treguar se ka vendosur t'i shkurtojë flokët dhe njëherë. Ndonëse hera e fundit që e pamë Zeqirin me flokë të tillë ishte viti 2013, në videoklipin e këngës 'Bloodah', mesa duket ajo ka preferuar t'i rikthehet sërish asaj pamjeje. Kujtojmë se në një nga videoklipet e fundit që Dafina ka nxjerrë, është shfaqur me flokë të gjatë në ngjyrë bionde dhe të zinj. Ashtu si çdo herë tjetër, këngëtarja seksi i ka habitur të gjithë me ndryshimin drastik që ka bërë dhe kjo duket fare mirë në komentet në 'Instagram'.



"Rob i shëmtuar je", Aulona Mustaj ikthen përgjigjen epike fanses që e ofendoi


Të gjithë i stepen përgjigjeve të saj të drejt-përdrejta dhe i kanë frikë thumbat që u hedh ajo. Aulona Mustaj është një nga gazetaret më të njohura që flet gjithnjë pa dorashka për personazhet e famshëm të show bizzit shqiptar, por jo vetëm. Ajo është shumë aktive në 'Instagram' ku publikon foto e video të ndryshe nga përditshmëria e saj dhe jo rrallë herë ndodh që kapet me fansat. Së fundmi, moderatorja ka ndarë në llogarinë e saj një foto ku shfaqet duke shijuar një akullore, por si gjithmonë komentet negative nuk kanë munguar. 'Rob i shëmtuar je', ishte komenti i ndjekëses. Ndërkohë nuk mungoi përgjigja epike e Aulonës: 'Me siguri gjithë këtë mllaf do e kesh ngaqë ke hundën e shtrembër për vete. Po s'ka gjë mos u mërzit, se bëhet operacion'.



E pyetën nëse është e lidhur, zbuloni çfarë ka thënë Fifi

Ajo është një nga zërat më po tent të muzikës shqiptare. Fifi është ndër artistet më të dashura për publikun. Përveç se një këngëtare e jashtëzakonshme, Fifi njihet për pozitivitetin që përcjell. Ajo dhe Flor Mumajesi janë një nga dyshet që janë përfolur më së shumti në show bizzin shqiptar. Duke filluar që nga publikimi i videos ku ata shfaqeshin duke kënduar shumë pranë njëri-tjetrit, si dy të dashuruar aludimet nuk kanë pushuar duke hamendësuar se midis tyre ka më shumë se miqësi.


Më pas provokimet e ndryshme për një këngë të re me producentin, i shtuan akoma më shumë këto zëra, mirëpo i kanë mohuar. Së fundmi, Fifi i është përgjigjur pyetjeve që i kanë bërë fansat në 'Instagram' dhe sigurisht që nuk mund të mungonin ato lidhur me Flori Mumajesin. Një fans e pyet nëse Fifi është në lidhje ose single dhe përgjigja e saj ishte befasuese, pasi as vetë këngëtarja nuk e di.



Tiani i vogël feston ditëlindjen, ja urimi i veçantë i Tunës dhe Patrisit

Zhdokja e Tunës nga indus shkaktoi shumë bujë në atë kohë. Por, dukej se artistja përveç se një pushimi të merituar kishte edhe një arsye tejet të veçantë. Së bashku me bashkëshortin e saj, Patrisin ata kishin marrë lajmin e ëmbël se do të bëheshin prindër të fëmije.

Tuna solli në jetë vogëlushin Tian, i cili ditën e djeshme mbush 2 vjeç. Në një video të publikuar në "Instastory", Tuna ka ndarë me ndjekësit momentet e lumtura me të voglin, të cilit i kanë kënduar këngën e ditëlindjes. Patrisi dhe këngëtarja shfaqet në sediljet e para të makinës, ndërsa në pjesën e pasme qëndron Tian me dadon e tij. Ata i këndojnë plot dashuri të voglit këngën e ditëlindjes, ndërsa Tuna filmon të birin.



SAMITI I BERLINIT REAGIMET

Kryeministri kosovar: Samiti i Berlinit ka normalizuar rajonin

'Der Spiegel', flet Haradinaj: Nuk negocioj me një bastard si Vuçiq Thaçi: Me serbët na ndan një lumë me gjak

Ramush Haradinaj, kryeministri i Kosovës në një intervistë për gazetën prestigjioze gjermane, 'Der Spiegel' ka komentuar edhe arsyet pse nuk do të dëshiron të ulej në një tryezë për paqe me presidentin Aleksandër Vuçiq. "Unë nuk do të negocioj me atë bastard", ka thënë Haradinaj, deklaruar të cilën gazeta gjermane e ka vendosur edhe në titull të shkrimit, intervistë kjo e botuar edhe javë më parë, por që është përsëritur nga gazeta gjermane. Në intervistë, Haradinaj përkrahur si një burrë shteti i rafinuar, i cili gëzon popullaritet në Kosovë. "Po mos të ishte Haradinaj dhe shokët e tij, ndoshta Republika më e re në Evropë nuk do të ekzistonte", shkruan Der Spiegel. Në këtë shkrim përmendet edhe nofka e Haradinajt, që ai e mbante edhe gjatë luftës në Kosovë. "Nën nofkën e 'Smajl', ai ka komanduar një pjesë të UÇK-së, që kulmoi me kryengritjen kundër forcave okupuese serbe në Kosovë. Sot ai është kreu i një vendi që kërkon vendin e tij në Evropë", shkruhet në gazetë. Ramush Haradinaj në luftën e Kosovës ka qenë komandant i UÇK-së në Zonën e Dukagjinit. Dy vëllezërit e tij, Luani dhe Shkëlzeni u vranë në luftë e sipër për të çliruar Kosovën nga Serbia. Ndërkaq edhe presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka folur në një intervistë të gjatë për median gjermane "Der Spiegel", e cila njihet për influencë edhe në vendet e tjera. Në këtë intervistë Thaçi ka folur për



Kryeministri i Kosovës,
Ramush Haradinaj

Samitin e Berlinit, për nevojën e një konsensusi ndërmjet shteteve të Quintit si dhe për idenë e tij të bashkëngjitjes së Presheves me Kosovën. Pyetjes lidhur me mundësinë e shkëmbimit të territorit sipas Federica Mogherinit, ai i është përgjigjur se asnjë nga shtetet e mëdha nuk ka qenë dakord për një proces të tillë. "Shtetet e Bashkuara, Gjer-

mania, Franca, Anglia dhe Italia gjithmonë kanë qenë të pajtimit që nuk duhet të ketë ndryshime të kufijve të rinj në Ballkanin Perëndimor. Tani ata si duket nuk flasin më me një zë. Kjo është e keqe. Një marrëveshje e qëndrueshme ka vetëm atëherë bazë të shëndoshë nëse të gjithë edhe SHBA-të qëndrojnë prapa saj. Sepse sot, serbët dhe kosovarët i

ndanë një lumë i tërë prej gjaku", ka thënë Thaçi. Ndërsa lidhur me Samitin e Berlinit, pas mbledhjes së qeverisë, kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, është shprehur se ky takim ka normalizuar rajonin, dhe se pjesa kryesore e këtij samiti i është kushtuar marrëdhënieve Kosovë-Serbi. Haradinaj ka komentuar edhe takimin e ardhshëm i

cili do mbahet pas 3 muajsh në Paris. "Kosova duhet të plotësojë formatin e tij, sepse nuk bëhet vetëm fjalë për një takim, por për një dialog, dhe se në dialog duhet të jetë edhe delegacioni i mandatar nga parlamenti. Përveç presidentit Thaçi, duhet të jenë edhe Limaj, Pacolli e Ahmeti. Po shkojmë në një proces serioz. Sa i përket marrëdhënieve Kosovë-Serbi, besoj se tashmë kemi formuar, dhe nuk shkohet në dialog për shkëmbim terriore, por për njohjen reciproke. Dhe është qartësuar se nuk do të diskutohet për taksën". është shprehur Haradinaj. Ndërsa tjetra, Haradinaj është ndalur edhe të takimi i Parisit të cilin e ka cilësuar si më serioz, ndërsa ka shtuar se duhet të koordinohen me Amerikën. "Takimi i Parisit është më serioz, dhe duhet të koordinohemi me Amerikën, sepse është garantuese e një marrëveshje". Gjithashtu, kryeministri deklaroi se idetë për shkëmbimin e terrioreve tashmë i përkasin të kaluarës.

SHKURT

Pacolli për Berlinin: Presioni për taksën nisi gjatë koktejt

Behgjet Pacolli, ministri i Punëve të Jashtme, ka dhënë një version të asaj se çfarë ka ndodhur gjatë pushimit në Samitin e Berlinit kur Macron e Merkel kanë biseduar me liderët kosovarë dhe Edi Ramën. Kryeministri Haradinaj ka akuzuar Thaçin e Ramën se i kanë bërë presion më të madh se liderët e Francës dhe Gjermanisë. Pacolli, i cili i ka çuar me aeroplanin e tij liderët e Kosovës dhe Shqipërisë ka thënë se ka pasur presione që taksë të hiqet. Ai tha se fillimisht kërkesën e ka bërë ambasadori amerikan, i cili ka thënë që taksë ta pezullohet për dy javë. Ai më pas ka thënë se edhe Merkel ka kërkuar pezullimin e taksës dhe të shihet nëse dialogu shkon në rrugën e duhur. "Ne patëm një koktej dhe aty filloi presioni, fillimisht kryeministrit që duhet të hiqet taksë dhe të vazhdojë dialogu. Kush iu ka afrua atij i ka kërkuar pezullim të taksës. Pezullim për dy javë i taksës është kërkuar edhe nga ambasadori i SHBA-së. Normalisht z. Haradinaj thotë se taksë nuk hiqet dhe ky presion vazhdon të vendet e Ballkanit Perëndimor. Më vonë këshillat e Merkel kanë qenë që suspendoni këtë taksë dhe i përcaktojnë gjërat si ndodhin. Nëse nuk ndodhin siç parashihet, jeni i legjitimuar për ta vënë përsëri taksën. Pason edhe propozimi i presidentit Macron, e njëjta retorikë", ka thënë Pacolli.

Haradinaj: Mund t'i urojmë qytetarët për liberalizimin e vizave

Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj tha se "po-ja" e shtetit të Gjermanisë për procesin e liberalizimit të vizave për Kosovën, e lejon atë që t'i urojë qytetarët për liberalizimin e vizave. Haradinaj, gjatë qëndrimit në Berlin, u takua me ministrin e Punëve të Brendshme të Gjermanisë, Horst Seehofer, i cili, sipas kryeministrit, i dha mbështetjen procesit të liberalizimit të vizave për zonën Schengen. "Kjo nuk është një po e analizave ose mendimeve, është 'po' e njeriut në detyrë që flet në emër të Gjermanisë - ministri i Punëve të Brendshme, (Horst) Seehofer, ka dhënë 'po' për vizat dhe ka thënë 'po' menjëherë", tha zoti Haradinaj, duke shtuar se "ministri gjerman ka kërkuar menjëherë, aty për aty, të cakton personat përgjegjës që të harmonizohet ana teknike. Kosova është vendi i vetëm në Ballkanin Perëndimor, qytetarët e së cilës i nënshtrohen regjimit të vizave në zonën Schengen. Zoti Haradinaj, por edhe presidenti Hashim Thaçi, janë duke thënë se gjatë muajit qershor, mund të liberalizohen vizat për qytetarët e Kosovës.

Haradinaj ia kthen Ramës: Shqiptarëve u kam borxh të vërtetën

Kryeministri kosovar flet për takimin në Paris: Do shkojmë në dialog për njohje reciproke

Pas mbledhjes së qeverisë në Kosovë, në një prononcim për mediat, kryeministri i Ramush Haradinaj komentoi reagimin në Facebook, të kreu të qeverisë shqiptare, Edi Rama. Haradinaj u shpreh se pa dashur të merret personalisht me Ramën, u ka për borxh qytetarëve të vërtetën mbi këtë proces kaq të rëndësishëm. "Për mua shqiptarët edhe të majtë edhe të djathtë janë vëllezërit e mi, u kam borxh të vërtetën. Atë që ka thënë At Zef Pllumi "Rrno për me tregue". Do ta tregoj të vërtetën edhe kur i pëlqen edhe kur nuk i pëlqen dikujt. Kam detyrim ndaj qytetarëve për një transparencë të asaj që po ndodh. Shyqyr që aty është dikush që tregon të



Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj me
homologun e Shqipërisë, Edi Rama

vërtetën", u shpreh kryeministri Haradinaj. Ai tha ndër të tjera se Samiti i Berlinit ka

normalizuar rajonin, ndërsa komentoi edhe takimin e ardhshëm, i cili do mbahet

pas 3 muajsh në Paris. "Kosova duhet të plotësojë formatin e tij, sepse nuk bëhet

vetëm fjalë për një takim, por për një dialog, dhe se në dialog duhet të jetë edhe delegacioni i mandatar nga parlamenti. Përveç presidentit Thaçi, duhet të jenë edhe Limaj, Pacolli e Ahmeti. Po shkojmë në një proces serioz. Sa i përket marrëdhënieve Kosovë-Serbi, besoj se tashmë kemi formuar, dhe nuk shkohet në dialog për shkëmbim terriore, por për njohjen reciproke. Dhe është qartësuar se nuk do të diskutohet për taksën Takimi i Parisit është më serioz, dhe duhet të koordinohemi me Amerikën, sepse është garantuese e një marrëveshje"- nënvizoi Haradinaj, ndërsa theksoi se idetë për shkëmbimin e terrioreve tashmë i përkasin të kaluarës.

RAMUSH HARADINAJ

"Kosova duhet të plotësojë formatin e tij, sepse nuk bëhet vetëm fjalë për një takim, por për një dialog. Sa i përket marrëdhënieve Kosovë-Serbi, besoj se tashmë kemi formuar, dhe nuk shkohet në dialog për shkëmbim terriore, por për njohjen reciproke", ka thënë Haradinaj.

Vdiq në spitalin e Trikalasë, mjeku: Ekspertiza mjekësore do japë arsyen

Shqiptari masakrohet me thikë në burgun grek, detaje të reja të krimit

Mediat greke: Ishte gjallë në burg, humbi jetën në spital

V ijojnë ende vrasjet makabre të shqiptarëve nëpër burgjet greke dhe akoma nuk del një autor përgjegjës për t'u dënuar. Një 29-vjeçar shqiptar humbi jetën ditën e martë në burgun e Trikalasë në Greqi. Ngjarja ka ndodhur në orët e para të mëngjesit, ku një grup të burgosurish shqiptarë u përplasën me thika me njëri-tjetrin dhe për pasojë i riu humbi jetën. Lajmi raportohet nga mediat greke, të cilat shkruajnë se 29-vjeçari humbi jetën në spitalin e Trikalasë për shkak të plagëve të marra. Mediat greke shkruajnë se rastet e përsëritura të sherreve mes të burgosurve, janë shenja të qarta se siguria në institucionet e vuajtjes së dënimeve lë për të dëshiruar. Të burgosurit janë shprehur se jeta e tyre është e pasigurtë dhe në rast se nuk shtohen kontrollat, përplasjet do të rriten dhe jeta e tyre praktikisht do të vihet në rrezik. Sipas drejtorit të spitalit Dimitris Parthenis, një raport mjekësor do të japë edhe arsyet e vdekjes së shqiptarit. "Trikalavoicë" shkroi se shqiptari nuk ka vdekur menjëherë në burg, por ishte transportuar edhe në spital.



Ndërkaq, media greke e fokusuar më së shumti në ngjarje të kronikës së zezë "Zougla" raporton se shqiptari është goditur me thika në gjoks e në këmbë. Sipas "Zougla"-s, shqiptari i plagosur rëndë është nisur menjëherë për në spital me ambulancë. Plagët që ka marrë ishin të shumta dhe për rrjedhojë ka ndërruar jetë. Ajo që dihet është se lëndimet që ka marrë në trup kanë qenë në kufijtë e horrorit. Gazeta tjetër helene "Tribune" shkruan se shqiptari 29 vjeç u plagos me thika në gjoks e trup, pas një tjetër përleshjeje të egër mes të burgosurve të Trikalasë. Kjo media thotë se agresorët janë dy të burgosur rusë. "Autorët e therën atë në gjoks, këmbë dhe brinjë", thuhet në artikull. Ky është incidenti i dytë i përgjakshëm midis të burgosurve në burgjet e Trikalasë në 20 ditët e fundit. Më 12 prill, një 55-vjeçar i burgosur shqiptar sulmoi dhe vrau një 66-vjeçar. Ndërkaq, në nëntorin e vitit të shkuar, gazetari shqiptar Shpëtim Zinxhiria që jeton në Greqi ka publikuar një shkrim në faqen e tij në "Facebook" ku rrefën listën e gjatë të shqiptarëve të vrarë në Greqi nga forcat policore. Me poshtë shkruan i tij i plotë: "A do fillojë Prokuroria e Përgjithshme e Greqisë hetimet për vrasjen e mbi 171 emigrantëve shqiptarë të pafajshëm, të pa armatosur me armë, duke filluar nga vrasja e 14-vjeçarit Erion. X (8/02/1996 nga policia në burgun e fëmijëve të Avlonës në Athinë, të Gramoz Palushit (4 shtator 2004) pse veshi një bluze

të kuqe e deri të vrasja e fundit e Pëllumb Marnikolaj (3 gusht 2016) në komisariatit e policisë nga vete autoritetet në Ano Patisia në Athinë? Vrasja e fundit në Shqipëri e minoritarit Kostandin Kacifas është shndërruar në një problem vërtetë madhor për Athinë dhe Tiranën zyrtare, për politikanët dhe media në vendin tonë dhe atë fqinj. Hetimet për vrasjen e tij vazhdojnë, ndërsa Prokuroria e Greqisë ka bërë thirrje që të marrë pjesë në hetimet për ekzekutimin e minoritarit helen në vendin tonë. Një hetim që lë shumë të kuptosh që një vend helen në vendin fqinj, në një kohë kur pamjet filmike tregojnë qartë se viktimat ishin me uniformë ushtarake greke dhe i armatosur me armë moderne. Qeveria e Greqisë në vend që të heshë të dhe të presë hetimet për këtë çast hidhet në sulm duke sulmuar në radhë të parë qeverinë shqiptare, ndërsa media dhe politikanët fajsojnë personalisht fajtor kryeministrin Edi Rama, ndërsa forcat RENEJA si një njësi vrasëse me paramendim. Kjo vrasje ndodhi në vendin e gabuar dhe në kohën e duhur duke u shfrytëzuar shumë mirë nga partitë dhe forcat ekstremiste në Greqi, jo vetëm kaq po u politizua edhe nga vetë kryeministri Tsipras që njëkohësisht mban edhe postin e Ministrit të Punëve të Jashtme. Vrasje e tillë ka tronditur opinionin publik shqiptar dhe atë grek, mirëpo, po të shikojmë anën tjetër se sa shqiptarë janë vrarë në Greqi, kronologjia na tregon se që nga viti 1992 e deri me

sot janë vrarë 171 emigrantë, nga këta 97 janë vrarë nga policia dhe rojet kufitare. Sikur të mos mjaftojë kjo, gjithashtu, kemi edhe 480 fëmijë shqiptarë të zhdukur në Shtëpinë Bamirëse "Agio Varvara" në Athinë në rrugën Singou Fiks. Kujtojmë se kemi edhe zhdukjen e 37 dibraneve në ujërat greke, kemi rreth 540 raste të keqtrajtimit të emigrantëve nga forcat e policisë, si dhe plagosje me armë. Nëse minoritari 35-vjeçar u vra me armë në dorë nga forcat RENEJA, asnjë shqiptar nga 171 të vrarë në Greqi nuk u vra me armë në dorë, apo në shkëmbim zjarri me policinë, përkundrazi ata janë vrarë pse kanë qenë ilegalë dhe pse ishin shqiptarë. Për këto vrasje qeveria greke nuk ka mbajtur asnjë qëndrim ashtu si edhe drejtësia, përkundrazi vrasësit janë duartrokitur (pamjet filmike janë në tv greke). Vrasja e emigrantëve në Greqi duhet të kishte ndërgjegjësuar shtetin grek, por njëkohësisht dhe shtetin shqiptar që me kohë duhet të kishin filluar hetimet rreth të këtyre vrasjeve makabre. Vrasja e emigrantëve shqiptarë në Greqi nuk ka të bëjë fare me kriminalitetin, por thjesht ata janë vrarë se ishin shqiptar Moshë mesatare e emigrantëve të vrarë është 26 vjeç. Moshë më e madhe e të vrarëve është 48 vjeç, ndërsa moshë më e re është 13 vjeç. Studimi shumë vjeçar është bazuar mbi të dhënat zyrtare të mediave greke si dhe të Organizatës Antiraciste Evropiane (YRE)

Nga studimi i viteve 1991-

2010 vërehet se:

Moshë mesatare e emigrantëve të vrarë është 26 vjeç. Moshë më e madhe e të vrarëve është 48 vjeç, ndërsa moshë më e re është 14 vjeç. Për periudhën nëntor 1992 mars të 1997 janë vrarë 47 emigrantë, ku nga këta 45 ishin shqiptarë dhe 2 ciganë. Për këto vrasje janë kryer 141 sulme kundra emigrantëve, ku mekanizmi shtetëror policia ka kryer 86 sulme, ndërsa nga qytetarët janë kryer 67 sulme. Deri më sot dy qeveritë kanë heshtur përball 154 vrasjeve makabre. Lista e gjatë makabre e emigrantëve të vrarë:

1991 - 1 vrasje nga roja e kufirit

1992 - 12 vrasje. 5 janë vrarë nga policia dhe 4 të tjerë nga rojet kufitare

1993 - 6 vrasje me armë zjarri. 4 janë vrarë nga policia

1994 - 6 vrasje me armë zjarri të kryera nga policia

1995 - 9 vrasje. 5 janë kryer me armë zjarri, ku nga këto 3 nga policia dhe 2 nga rojet kufitare

1996 - 10 të vrarë. Ku 6 prej tyre i ka vrarë policia dhe 1 rojet kufitare

1997 - 14 vrasje, nga këto 10 janë kryer me armë zjarri. 10-të i ka kryer policia

1998 - 13 vrasje, nga këto 8 janë kryer me armë zjarri. 4 vrasje mbajnë vulën e policisë

1999 - 15 vrasje, nga këto 7 janë kryer me armë zjarri. 6 vrasje i ka kryer policia dhe 2 rojet kufitare

Nga viti 1992 - 1999 janë vrarë 75 emigrantë. Nga këta, 60 i ka vrarë policia si dhe rojet kufitare, ndërsa pjesa tjetër nga vendasit

2000 - 9 vrasje me armë zjarri. Të gjithë u vranë nga policia

2001 - 3 vrasje të kryera me armë zjarri nga policia

2002 - 3 vrasje me armë zjarri nga policia

2003 - 5 vrasje. 2 janë kryer me armë të policisë

2004 - 6 vrasje. Policia ka kryer një vrasje

2005 - 2 vrasje.

2006 - 2 vrasje.

2007 - 6 vrasje. 2 ka kryer policia.

2008 - 10 vrasje. Një është kryer me armë zjarri.

2009 - 4 vrasje

2010 - 8 vrasje. Nga këto: me armë zjarri 5. 2 vrasje i ka kryer policia.

Nga viti 2000 - 2010 janë vrarë 58 emigrantë. Nga këta, 33 i ka vrarë policia dhe rojet kufitare, ndërsa pjesa

tjetër janë vrarë nga vendasit. Nga viti 1992-2010: janë vrarë 154 emigrantë. Janë verifikuar 135 dhe mbeten për verifikim edhe 19 vrasje të tjera. Në 135 vrasjet e kryera forcat e policisë greke kanë kryer 93. Viti 1991, është fillimi i vrasjeve por edhe i regjistrimeve të krimeve të kryera ndaj shqiptarëve. 6 marsi është dita kur shtypi grek publikon për të parën herë vrasjet e emigrantëve. Nga viti 2000 - 2010 janë vrarë 58 emigrantë. Nga këta, 33 i ka vrarë policia dhe rojet kufitare, ndërsa pjesa tjetër janë vrarë nga vendasit. Nga viti 1992-2010: janë vrarë 154 emigrantë. Janë verifikuar 135 dhe mbeten për verifikim edhe 19 vrasje të tjera. Në 135 vrasjet e kryera forcat e policisë greke kanë kryer 93. Viti 1991, është fillimi i vrasjeve, por edhe i regjistrimeve të krimeve të kryera ndaj shqiptarëve. 6 marsit është dita kur shtypi grek publikon për të parën herë vrasjet e emigrantëve. Po mbas viteve 2010 është policia ajo që kryen vrasje makabre me lloj-lloj mënyrash. Konkretisht autori i krimit është për oficer policie që shërben në parlamentin grek. I është dhënë prokurorisë së Livadhias së qytetit të Thivës. Sipas policisë ngjarja ka ndodhur mëngjesin e 28 tetor të 2011, ku mbas një zënje në makinë në zonën Avlona, e ka mbytur me xhupin e tij grupin shqiptarë 49-vjeçarë. Më pas e ka braktisur në një zonë bujqësore të Sqimatariu, me qëllim që të kuptohej se ishte viktimë e një aksidenti automobilistik. Deri më sot asnjë punonjës policie që ka torturuar dhe vrarë në mënyra nga më të ndryshme emigrantë shqiptarë nuk është dënuar nga drejtësia vendase. Duke u nisur nga këto lloj vrasjesh të ndryshme shikojmë se gjatë periudhës 1992-1999 policia ka vrarë 60 emigrantë shqiptarë, ndërsa më pas vrasjet e policisë ndaj emigrantëve tanë ka ardhur në ulje. Nga viti 2000-2010 policia ka vrarë 33 emigrantë shqiptarë, duke e çuar numrin e përgjithshëm në 93 shqiptarë të vrarë, duke e çuar atë më pas në 97, me rastin e vrasjes së Pellumb Marnikolaj nga vetë autoritetet e ruajtjes së rendit. Emrat e disa shqiptarëve të keqtrajtuar dhe torturuar nga policia:

A.Biba, A. Caco, A. Përla-

lla, A. Hodi, A. Nesto, A. Alkja, A. Torkja, A. Cenika, A. Lleshi, A. Priti, A. Metaliaj, B. Metaliaj, G. Rama, D. Troshku, D. Topallaj, D. Brakolli, E. Sula, F. Ceka, R. Bullari, S. Hallko, S. Allkja, SH. Shabani, ?? Allia, K. Rrapi, B. Meçe, M. Halimi, R. Halili, R. Pashollari, R. Saliq, K. Rrapi, V. Mema, V. Karaj, O. Osmani, S. Gjani.

Asnjë polic nuk është dënuar për vrasjet ndaj emigrantëve. Në vitin 2000 - 2001, vetëm tre policët e akuzuar për tortura dhe abuzim kanë qëndruar në bankën e të akuzuarve. Dy nga të tre të akuzuarit fitojnë lirimin, ndërsa i akuzuari i tretë u dënua me 30 muaj burgim dhe më pas 15 muaj burg me kusht. Asnjë polic nuk është i gjykuar për torturat dhe vrasjet e emigrantëve gjatë tetë muajve të parë të vitit 2002. Nga fillimi i vitit 2000 deri në qershor të vitit 2002, trupat gjyqësore kanë lëshuar vendime për pesë raste të të shtënave me armë zjarri nga ana e policisë. Në dy nga pesë rastet, janë akuzuar dy oficer policie. Kur ka gjetur fajtor oficer policie me akuzën për vrasje janë dhënë "dënime me kusht". Njëri nga oficerët u shpall fajtor për vrasje të shkallës së parë dhe u dënua me 4.5 vjet burg. Më vonë edhe ky (i mjeri) lihet i lirë me kusht; po të vrasë përsëri do të bëj burg jo 4.5 vjet po 9 vjet. Deri në fund të qershorit 2002, nuk ishin akuzuar për vrasje apo tortura në asnjë roje kufitare apo ushtar në incidentet kufitare cituara në raport. Sipas shifrave zyrtare, asnjë polic nuk është detyruar për tortura dhe vrasje dhe abuzim në detyrë të kryera nga 1996 - 2001. Në vitet 2000-2002 u penalizuan për vrasje vetëm pesë policë, po më në fund asnjë nga këta nuk u dënua. Duke ndjekur rrugën e ndjenjave antishqiptare, Greqia i ka mbushur burgjet e saj me emigrantë duke zënë vendin e parë për sa i përket numrit të dënuarve të huaj. Nuk është e rastit që drejtësia greke të mos ketë kurajën morale, për të dënuar asnjë nga vrasësit, të cilët deri më sot nuk u kanë kërkuar të falur familjeve të viktimitave, por përkundrazi janë duartrokitur në sallat e gjykatave. Mos vallë rrethnata e fundit na çojnë për reciprocitet...!.. te shpresojmë se më në fund do të kemi një gjë të tillë.

FESTIVALI



Shtëpia e Pashko Vasos



Shtëpia e Idromenos

Oborri i Idromenos ribëhet kinema për filmat e 'Ekranit të Artit'

Fatmira Nikolli

Shtëpia e Pashko Vasos, shtëpia e Llazanve, "Migjeni" dhe shtëpia e familjes Paci si strehë arti

Veprat që projektohen në festivalin e "Shtëpisë së Artit" këtë vit

Më shumë se 100 vjet nga koha kur shtëpia e Idromenos u bë kinemaja e parë shqiptare, oborri i saj, rindënohet gjurmët e dashamirësve të film-it. Vetëm se qyteti nuk gumëzhi në nga lufta. Mikrpritësit një shekull më pas janë të tjerë.

Një vend 'misterioz' ku ruhen farërat e gjithë globit për të parandaluar humbjen aksidentale të bimëve; një hetim i fotografive të njerëzve që vdiqën në rrënojat e Lampedusës më 2013 dhe 2015 apo raportit ynë me frikërat dhe herët kur arrijmë të qeverisim më mirë frikën tonë.

Tematikat e videoeve dhe filmave që shfaqen sivjet në Ekranin e Artit në Art House në Shkodër, janë të ndryshme. Artistët vijnë nga vende të ndryshme dhe bartin e përcjellin përvoja të ndryshme jetësore e artistike duke e bërë Ekranin e Artit një mundësi ideale për shkëmbime kulturore.

Art House sjell për të tretin vit radhazi festivalin "Ekranin e Artit" ku ndërthuren filmi dokumentar mbi artin me atë eksperimental dhe videoartin. Ajo që pat nisur si një përzgjedhje filmash nga festivali florentin "Lo schermo dell'arte", këtë vit bën bashkë një përzgjedhje filmash nga International Short Film Festival Oberhausen, Lo schermo dell'arte, koleksioni i videos dhe filmat të Van Abbemuseum, një përzgjedhje nga videoarti shqiptar i viteve të fundit, një grup filmash të shkurtër nga regjisorja gjermane Sylvia Schedelbauer si dhe një film me metrazh të gjatë nga artisti shqiptar Pleurad Xhafa. Ajo çka e shenjon mes të tjerash festivalin



është rigjetja në qytet e gjurmëve historike, për t'i ngjallur prej harrese, për t'ia bërë të njohur një publiku tjetër e mandej herë-herë për t'i sjellë sërish në funksionin e tyre të parë. Kështu, Ekranin e Artit i shpërndan projektionet në oborret e shtëpive shkodrane duke gërshetuar hapësirat private me ato publike e njëherit atmosferën tradicionale me atë bashkëkohore. Teatri Migjeni mirëpret ceremoninë e hapjes shoqëruar me përzgjedhjen e parë filmike e në vijim projektionet do të vazhdojnë në hapësirat e Art House, oborri i shtëpisë së Pashko Vasës, i shtëpisë së Llazanve dhe asaj të Kolë Idromenos, ku është hapur e para kinema shqiptare në fillim të shekullit XX. Programi filmik do të shoqërohet me momente muzikore në ambi-

entet e Qendrës Rinore Arka me të ftuar të veçantë Kolë Lacën me projektin e tij Shkodra Elektronike.

PUNËTORI I PALODHUR

"Punëtori i palodhur" i Pleurad Xhafës (2013) tregon historinë e Haxhi Xhihanit (Xhiku) që ka lindur në vitin 1953. Që nga 1973, ka punuar në fabrikën e bunkerëve "Josif Pashko" në Tiranë. I vlerësuar si punëtor model në punën kolektive, është dekoruar me Medaljen e Nderit "Punëtori i Palodhur" nga brigadieri Jani Ciko. Pas regjimit komunist, një pjesë e fabrikës u shkatërrua dhe ajo që mbeti u privatizua dhe u shndërrua në fabrikë për prodhimin e pllakave për trotuar. Pronari i fabrikës është ish-brigadieri. Sot, Xhiku paguhet 3 euro në ditë.

Pleurad XHAFJA (Lushnjë, Sh-

qipëri, 1984) është një artist pamor dhe kineast që jeton dhe punon në Tiranë. Ai ka studiuar në akademinë e Arteve të Bukura në Bolonjë, Itali, dhe është diplomuar me një Master në Artet Pamore në vitin 2012. Në 2014 ai ishte fituesi i çmimit "Ardhja" për artistët e rinj pamor shqiptar, organizuar nga T.I.C.A - Tirana Institute for Contemporary Art. Puna kërkimore dhe kritike e tij vjen si rezultat i një praktike post-konceptuale, e cila vepron mbi një bazë dokumentuese për t'u raportuar më pas vizualisht dhe politikisht me kulturën e kohës sonë. Punët e tij janë prezantuar, gjithashtu, ndërkomëtarisht në ekspozita si: Les Rencontres Internationales, Paris/Berlin (2015-2016); "Teatri i Gjëlberimit", Galeria FAB, Tiranë (2016); Shame On You, Celje (2015); Çmimi Ardhja, Galeria Zeta, Tiranë (2014); Lavoro/Eork/Vore, Udine (2013); Bienala e 6-të e Arteve Bashkëkohore, Berlin (2010); Bienala e 4-rt e Tiranës (2009); Çmimi Onufri XIV, GKA, Tiranë (2008); dhe Every Revolution is a Throë of Dice, Gjenova (2006).

MAGICAL WORLD

Vepra e Johanna Billing (2005) është video. "Magical world" vjen si rezultat i një bashkëpunimi me një grup fëmijësh në një klub muzikor passhkollor në një ish-qendër kulture të viteve '80 në Durrës, periferi e Zagrebit. Fokusi është në përsëritjen e një kënge "Magical world", të përzgjedhur nga Billing dhe të shkruar nga këngëtarin amerikan me ngjyrë Sidney Barnes (1968). Kënga rrefën

një periudhë tranzicionale personale dhe mund të lidhet me zhvillimin me hapa të shpejtë të një vendi të ri i cili përballet me kërkesat për aderim të Bashkimit Europian. Kjo artikulohej edhe në vëshitërishtë e fëmijëve për të përshtatur me përdorimin e gjuhës angleze e për të kuptuar fjalët e këngës. Provat ndërthuren me momente nga jeta e përditshme, jashtë klasës, që krijojnë një performancë intime të fëmijëve.

Johanna BILLING (Jönköping, Suedi, 1973) punon me videon që nga viti 1999 duke e ndërthur atë me muzikë, lëvizje dhe ritëm. Adreson çështje klimatike dhe të kulturës duke i transformuar ato përmes dokumentarëve. Shpesh përdor muzikën në të cilën duart bëhen pjesë e rëndësishme e komunikimit, kujtesës dhe rindërtimit.


MAM' MË FAL

"Mum, I'm Sorry" është një veprë e Martina Melillit realizuar më (2017). Videoja e Martina Melilli paraqitet si një hetim analitik dhe në të njëjtën kohë emocional i fragmenteve, objekteve personale, fotografive të njerëzve që vdiqën në rrënojat e Lampedusës më 13 tetor 2013 dhe 15 maj 2015. Video-ja zhvendoset ngadalë nga një detaj në tjetrin, nga njëri objekt në tjetrin, sikur të ishte një nga reliket që do të merrreshin në pyetje, duke kërkuar përgjigje përmes palosjeve të sipërfaqes. Sipërfaqja zakonisht përcaktohet si pamja e jashtme, pak a shumë e sheshtë dhe me dy dimensione, e një objekti ose trupi çfarëdo. E njëjta gjë thuhet edhe për detin, sipërfaqen e tij, pjesën që ne mund ta shohim edhe nga



Shtëpia e Ilazanve

larg duke u rudhosur në erë, të ndriçojë në diell, duke zbuluar detaje të vogla gjatë natës. Duke e detit është e pangatërrueshme, kripë e bartur nga mikro-pika të ujit, kripë. Kripa gërryen me kalimin e kohës, çdo objekt, telefonat celularë, dokumentet e identitetit, dëftesat, fotografitë; kështu që sipërfaqet ndryshojnë, konturet ndërthuren, ngjyrat përzihen mes tyre duke gjenuar kthesa të papritura, boshllëqe që duhet të ishin plot, roza dhe vjollca duhet të ishin kuq dhe blu. Objektet zbulohen ngadalë, të gërryera në sipërfaqet e tyre, të zbrazura nga thellësia e tyre, të privuara nga jetët që shoqëronin dhe të ngarkuara me tregime që mundemi vetëm t'i imagjinojmë dhe nga të cilat mbesin dëshmitarë stoikë. Objektet e zgjedhura për të përfaqësuar veten dhe për t'u paraqitur pas mbërritjes në Botën e Re (Vjetër). Dhe cilat objekte do të zgjedhim ne për



të na prezantuar përtej detit? Gjithmonë natyrisht, në qoftë se do të jemi mes atyre që arritën të qëndrojnë në sipërfaqe.

Martina MELILI (Itali, 1987) është e interesuar në përfaqësimin e individit dhe kujtesës kolektive në lidhje me kujtesën dhe realite-

tin dhe në marrëdhënien mes individit dhe hapësirës. Kërkimi i saj është vizual dhe konceptual dhe punon me video, film, fotografi, shkrim duke përdorur dokumentarin si një mjet kreativ për të organizuar workshop-e dhe për të kuruar ekspozita për filmin.



FRIKA SI EMOCION

Videoja "Chiropteres Bats" e Romeo Grunfelder trajton Frikën. Emocioni njerëzor më i vjetër dhe më i fuqishëm është frika, dhe frika më e lashtë dhe më e fuqishme është frika ndaj së panjohurës" ka thënë Hoëard Phillips Lovecraft. Vepra vë në dukje se zakonisht arrijmë të qeverisim më mirë frikat tona nëse mund të përcaktojmë dhe t'i japim formë asaj që na frikëson, por frika rritet nëse ajo më të cilën përballlemi është "e paformë", në kuptimin që nuk ka një formë të saktë, pra është e pa identifikuar. Një perde që lëviz para nesh, në një hapësirë sterile, pa referenca të tjera, kthehet në një terror të pastër nëse ajo që e lëviz na duket se është një genie e gjallë që mund të përpiqemi ta identifikojmë vetëm nga tingujt e krahëve, një zhurmë e thatë, si ajo e një membrane, pa pupla, ndoshta një lakuriq nate, siç na sugjeron edhe titulli i videos, një kafshë mitologjia e së cilës lidhet me natën, me të panjohurën, me diçka të pështrirë që i afrohet limitit ku na shtyn terrori. Artisti Romeo GRÜNFEELDER (Hamburg, Gjermani, 1968) ka studiuar muzikë, filozofi për mediat dhe komunikim vizual në Hamburg, ku jeton dhe punon. Filmat e tij janë mes dokumentarit dhe arteve vizuale. Fokusi i punës së tij janë tematikat e lidhura me paranormalen.

"WILD RELATIVES"

Vepra e Jumana Manna është e vitit dhe zgjat 70 minuta. "O David! Ne të kemi vendosur si të Dërguar në tokë, prandaj gjyko mes njerëzve sipas të vërtetës

dhe mos ndiq pasionin që do të largonte nga Rruga e Zotit dhe ata që devijojnë nga Rruga e Zotit do të kenë një dënim të dhunshëm për faktin që kanë harruar ditën e Llogarisë.

"DITA E LLOGARISË" KUR'ANI, XXXVIII: 26"

Në tekstin e Morgan Hoaus, shënohet se në fillimet e kohës, njeriu kultivues kërkoi harmoni me territorin, ai ngriti sytë lart duke pritur diellin, thithte ajrin për të ndjerë nëse era do sillte shi, e tija ishte një bujqësi e bërë nga njohuri të trashëguara gojorishit dhe në një marrëdhënie të ngushtë me natyrën. Megjithatë, thotë Hoaus, shekullin e kaluar, industrializimi hyri fuqishëm edhe në bujqësi, duke transformuar atë njeri nga një dëgjues të vazhdueshëm të natyrës, në një profesionist që punon me makineri pothuajse të një laboratorit shkencor, duke i dhënë jetë një epoke të re bujqësore pa fermerë. Kërkesat e tregut, jo më lokale por globale, kanë ndryshuar kultivimet, luftëra, fatkeqësi natyrore kanë zhdukur të korra, kështu që sot në 1,200 km nga Poli i Veriut, pikërisht në arkipelagun e largët Arktik të ishujve Svalbard, në Norvegji, qeveria norvegjeze ka krijuar "Depozitën Globale të Farave të Svalbard", një qendër e përbërë nga tre salla me gjatësi prej 27 metrash, 10 gjerësi dhe 6 lartësi, kretjësish në beton, ku ruhet trashëgimia gjenetike e farave të të gjithë globit të tokës për të parandaluar çdo humbje të mundshme botanike "aksidentale", edhe pse përfaqësuesit e qendrës shpresojnë që kurrë të mos jenë të detyruar ta përdorin këtë trashëgimi gjenetike pas një katastrofe globale. Filmi tregon një vit pune dhe shkëmbim farash mes Libanit, Sirisë dhe Norvegjisë, punën dhe angazhimin e shumë njerëzve për të studiuar dhe kataloguar gjenet e drithërave dhe farave të ndryshme duke përfshirë ato të një prej banorëve më të lashtë të planetit Tokë, grurin, gjenomi i të cilit zë terabyte të tërë informacioni, pasi është më i gjatë se ai i njeriut.

Jumana MANNA (1987) është një artiste amerikane me origjinë palestineze që jeton në Berlin. Punon kryesisht me filmin dhe skulpturën. Në punët e saj adreson tematika të lidhura me trupin, nacionalizmin, historinë dhe ndërtimin e komunitetit. Punët e saj janë shfaqur në Points of Departure në Institutin e Artit Bashkëkohor, Londër (2013), Future Imperfect në Tate Modern, London (2013), Berlinische Galerie's 12x12 video lounge (2013) dhe në shumë festivale ndërkombëtare të filmit. Në vitin 2012, ka fituar çmimin e parë të Qattan Foundation për artistët e rinj palestineze.

"ZETA' SHPALL ÇMIMIN "ARDHJE 2019"

Qendra 'ZETA' shpall të hapur aplikimet për çmimin 'ARDHJE 2019' për artistët e rinj, nën moshën 35 vjeç. Këtë vit, 'ZETA' organizon edicionin e XI të 'ARDHJES' në bashkëpunim me Residency Unlimited (RU), institucionin i cili pret artistin fitues për një rezidencë dy-mujore në New York, me mbështetjen e Ministrisë së Kulturës dhe fondacionit, The Trust for Mutual Understanding, NY.

Çmimi ARDHJE organizohet nga Qendra ZETA, si një konkurs dhe çmimi i përvitshëm, që ka për qëllim të nxisë krijimtarinë, ekspozimin publik, dhe promovimin e artit bashkëkohor në Shqipëri dhe ndërkombëtarisht. ARDHJE është pjesë e rrjetit Young Visual Artist Award që nga viti 2007. Ashtu si dhe çmimet simotra nëpër Europën Lindore dhe Juglindore, ARDHJE është një konkurs i hapur, që fton artistët të marrin pjesë në një proces transparent, që ofron jo vetëm

mundësi për krijimin dhe prezantimin e veprave të reja në një ekspozitë të përbashkët, por edhe mbështetje në zhvillimin e tyre artistik dhe profesional. Një juri e përbërë nga profesionistë të fushës, vendas dhe ndërkombëtar, do të përzgjedh 4 finalistë, të cilëve do t'ju mundësohet një buxhet prodhimi prej 50,000 lek, si dhe një kurator për ekspozitën. Fituesi/ja e çmimit do të zgjidhet për meritën dhe premtimin artistik të demonstruar në bazë të portofolit artistik dhe CV-së, veprës së ekspozuar në ekspozitën e finalistëve, intervistës me jurinë ndërkombëtare dhe potencialit për të përfutur nga përjetimi i skenës artistike të New York-ut, përgjatë dy muaj qëndrimi tek Residency Unlimited. Afati përfundimtar për të dërguar aplikimet është 30 maj, 2019. Lista e shkurtër e 4 artistëve të përzgjedhur si finalistë do të publikohet pas dt. 15 qershor 2019. Hap-

ja e ekspozitës së 4 artistëve finalistë dhe shpallja e fituesit do të mbahet në Nëntor 2019. Kriteret e aplikimit janë disa. Çmimi dhe rezidenca në NY është projektuar për një artist individual, nën moshën 35 vjeç. Thirrja është e hapur për artistë aktivë në skenën e artit bashkëkohor në Shqipëri, si dhe ndërkombëtarisht, prej së paku 3 vjet. Artistë shqiptarë që jetojnë jashtë Shqipërisë, duhet të jenë pjesë e komunitetit artistik në vend, duke ekspozuar rregullisht gjatë 3 viteve të fundit. Artistë që nuk janë shtetas/e të Shqipërisë mund të marrin pjesë vetëm nëse kanë një kontribut të posaçëm në zhvillimin e skenës së artit në vend, si dhe karriera e tyre artistike të jetëngushtësisht e lidhur me Shqipërinë. Mund të aplikojnë artistë, të cilët punojnë në të gjitha gjinitë e artit pamor, që përfshijn pikturë, skulpturë, grafikë, vizatim, instalacion, fotografi, video, mediat e

reja dhe performancë. Përjashtohen artistët që punojnë kryesisht në artet e aplikuara, dizajn, teatër, vallëzim, dhe film artistik. Aplikanti/ja duhet të ketë mbaruar studimet universitare dhe të mos jetë student gjatë fazës së aplikimit dhe rezidencës. Artistët duhet të aplikojnë drejtpërdrejtë si individë. Nuk pranohen aplikime prej grupeve artistike, pasi rezidenca në NY mund të mikpresë vetëm një artist individual për vend. Aplikanti/ja duhet të jetë në dispozicion të udhëtojë dhe marr pjesë në rezidencën 2 mujore në NY përgjatë muajve maj-qershor, 2020. Artistët që nuk mund të angazhohen në këtë kohë, luten të aplikojnë herë tjetër. Aplikanti/ja duhet të zotëroj anglishten e folur dhe të shkruar me qëllim që të marrë pjesë në programin e rezidencës, të komunikojë dhe të shkëmbejë me profesionistë të fushës, në New York.

In Memoriam

Iku Zonja, e u përcoll Çupa...

Nga FANO HALLKO

Vargu i makinave që udhëtojnë në atë ditë drejt Fushëbardhës, kishte zënë gjithë gjatësinë e rrugës, që nga Ura e Kardhiqit, e deri në fshat.

Të gjitha Qafat, "nxinin" nga makina të markave të ndryshme, makina që vinin kryesisht nga Tirana, por edhe nga rrethet e tjera të Shqipërisë.

Trafiku ishte si në Tiranë tonë, kur bie shi. Qafa e Zenele, Lapidari i Prongjisë, Fusha e Kardhiqit, Kakodhiqi, e Qafa e Taroninës, plot me makina që shkonin në Fushëbardhë...

...Të njëjtat makina, e kishin përshkuar këtë rrugë, vetëm katër ditë më parë. Ato makina atë ditë, shoqëronin "dhëndrin", të zotin e shtëpisë në Fushëbardhë, Gjençi Kazon.

Kurse vetëm katër ditë më pas, ato makina, por edhe shumë të tjera, që nuk ishin herë e parë, shoqëronin "nusen", Çupën (alias Afërditën), zonjën e asaj shtëpie, bashkëshorten e Gjençit...

MISTERI I EMRIT "ÇUPA"

Ditën e premte, ditën që u përcoll Gjençi Kazo, kryeplaku i Fushëbardhës i cili mbajti Fjalën e Lamtumirës, tekta fliste për jetën e tij, ndër të tjera, tha: "Gjençi e ndërtoi familjen e tij me Çupën"...

Qysh ditën që mësova emrin me të cilin njihje nga i gjithë komuniteti nëna e familjes Kazo-Çupa, më ka intriguar veçanërisht ky fakt.

Më intrigoi në dy drejtime: Së pari, pse i mbeti ky emër? E së dyti, si qe e mundur që ky emër i mbijetoi Asaj, aq sa ajo jetoi, duke ekskluzuar tërësisht emrin Afërdita, të shkruar në letrat zyrtare të shtetit?

Pse i mbeti emri i pandryshueshëm Çupë? Pse ishte e paracaktuar që ajo të kishte dy emra në jetën e saj; njërin që e dinte vetëm gjendja civile dhe ca njerëz të paktë, e tjetrin, atë me të cilin e njihje e gjithë shoqëria? Çfarë ka qenë ajo zonjë, qish në paralindjen e saj? Apo mos kishte të drejtë Naimi, kur shkruante për paralindjen e tij, e mos vallë Naimi ndoshta parashkroi edhe se çfarë do të ishte Çupa? Sepse Naimi shkroi në dy shekuj e për të gjithë shekujt, shkroi për të gjallët, të vdekurit, por edhe për ata që do të lindin në shekuj, pas vdekjes së tij... Pra, mos kishte të drejtë ai kur shkruante: "Qeshë Diell, ishnja Hënë/ U bëshë ujë e bal të dhe erë/ Yll e zog, e dash kam qenë/ Pa dhe njeri, shumë herë"?

Nuk është thjeshtë çështje kërshtërie, e as kureshtje e njeriut që mëton të studiojë fakte dhe fenomene, e të shkojë deri në rrenjën e gjërave. Është shumë më tepër sesa aq, shumë më përtej kureshtjes. Gjithë sa pyeta, m'u përgjigjen me një singleritet vrazdat duke ngrihur supet: "Po ja, babai i saj i thoshte çupa, e ashtu i mbeti!"

E pamundur kjo. Sepse çdo baba e çdo nënë, e përdor këtë fjalë kur i referohet fëmijës që ka lindur femër. Ashtu siç përdoret fjala bijë, por në përdorim të gjerë, edhe fjala vajzë.

Nuk e kemi edhe aq të varfër gjuhën tonë Shqipëre në sinonime. Pavarësisht se këto katër përcaktimet;



koce (në trajtën nëndialektale), çupë, vajzë, e bijë, fliten në faza të ndryshme të jetës së femrës. Për shembull, fjala bijë, e ndjek pas gjithë jetën femrën. Sepse ajo, edhe kur bëhet gjyshe në derën ku ka shkuar nuse dikur; për derën nga ku doli vajzë, domethënë në derën e babës-apo në Gurin e Babës, siç i thonë, mbetet Bijë. E prandaj bijave, u rezervohej nderim dhe vend i veçantë.

E prandaj ekziston edhe sot shprehja: "Bijat, në qoshë". Në dhomën e grave, kuptohet.

Kurse fjala çupë, me njohuritë modeste që ka shkruasi i këtyre radhëve në gjuhësi, ka tjetër kuptim, e tjetër kumbim.

Që një femrë t'i mbetet emri Çupë, do të thotë që personi që e bart përjetësisht këtë emër apo "paranom"-siç thotë huazimi gjuhësor, të ketë cilësi të veçanta. Jo thjesht të jetë e zgjuar, apo me zgjuarsitë jashtëzakonshme siç ishte Çupa, jo thjesht të jetë e pastër, jo thjesht të jetë e singertë, jo vetëm të jetë e çiltër, por të jetë...e qashtë.

Ashtu siç një jetë të tërë ishte Çupa-Afërdita Kazo(Mullai), bijë dhe nuse e Fushëbardhës. Një grua fisnike, e një femër e qashtë.

Asaj gruaje, ndoshta do t'i shkoni për shtat vargjet që Naimi ynë i madh, në dedikimin që i bëri nënës: "E lartme dhe" poshtme/ E gjithësisë je ti/ S'e di se ç'je/ Por gjithësisja je vetë!"

U GJITHËRUAN EDHE HURIDITË, PËR ÇUPËN...

Shprehjen e mësipërme që është nëntitull, e tha nënë Alemja, bashkëmoshatare e Çupës. Ajo e tha, por e përjetuan edhe gjithë sa ishin atje. Ashtu siç e shprehu nënë Alemja...

...Çupa erdhi në jetë ndaj të gdhirë, atë mëngjesit, "sa kishte dhënë dritë", një ditë pranverë. Prandaj edhe kur e regjistruan, nuk e vranë mendjen shumë. "Aty më të dirë, leu çupa. Shkruaje Afërditë-i thanë nëpunësit të gjendjes civile. Po ku u dinin ata, se do të mbizotëronte në gjithë jetën e saj, ai emri i parëndësishëm

në dukje-çupa, që e thanë si nëpër dhembë atë ditë?

Ky popull, shumë gjëra nuk i ka shprehur me fjalë. Ose për mungesë njohurish në gjuhësi (patjetër kjo e shkon), por edhe për kryeneçësi.

Por familja, fisi, komuniteti, fshati e më gjerë, e gjithë "gjendja" siç i thonë në ato vise, i ka bërë "grafinë" e shpirtit secilit e secilës, ndër vite, ndër shekuj.

Një lloj grafie, që nuk mund ta realizojnë dot t'rezet e rontgenit. Grafinë e Shpirtit.

E kjo lloj grafie, e këtij njeriu, për pastërtinë dhe qashtërsinë e karakterit të saj, pranonte vetëm një emër: Çupë. Emri Çupë dikur, u mbetet përjetësisht vajzave që kur në s'u martuan, por edhe që kurrë nuk patën "partner", siç me pacipësi e shqiptojmë sot, këtë fjalë të pështrirë. E pështirosi vetë njeriu shqiptar, me konotacionin që i dha, duke nënkuptuar vetëm marrëdhëniet seksuale.

Por kjo ishte e vetmja çupë që u martua dhe lindi fëmijë, që e mbajti emrin Çupë.

ATA I RIMARTUAN...

Ata i ndau fati. Iku Gjençi. Po pse të mos themi, se Gjençi shkoi në Fushëbardhë, "për ca punë, e për pak ditë", "për të punuar dhe krasitur" pemët e selitura të asaj shtëpie, se stina e tyre ishte.

Atëherë, "e drejta" e tyre, të ribashkoheshin. Atë ditë, Çupa, pësoi goditje nga hipertensioni arterial.

Kaluan tre ditë. E veçili donte edhe gruan në shtëpi. Atëherë duhej t'i shkoste atje pranë, në shtëpi. E tha, dhe e bëri. 24 orë para se të nisej për në shtëpinë e saj, nuk komunikoi me njeri. E la veten në intimitetin e vetvetes. Fundjafare, truri i saj që kishte punuar si "perpetuum mobile" për 76 vite e 349 ditë rreshat, a nuk e kishte të drejtën të pushonte, qoftë edhe vetëm 24 orë??? Ajo iku ndaj të gdhirë, një ditë të hëne. Ashtu siç erdhi ndaj të gdhirë, një ditë pranverë.

Dhe sipas kërkesës së saj, e çuan në shtëpinë e saj, në Fushëbardhë. Atje ku kishin gjithë mundin dhe dërsën e jetës së saj dhe të

burrit.

Në atë shtëpi, nuk ishte hequr xhezvia nga zjarri. Ziente kafeja, e bijtë e Derës ndanin me lugën e kafes, me miqtë dhe me shokët, hidhërimin për babain e tyre, Gjençin. Gjençi punëtori proverbial i minierës, burri që kërkoi aq shumë nga vetvetja dhe nga të afërmit e tij, të cilët i deshi po aq shumë në mënyrën e vet.

E futëm Çupën në shtëpinë e saj. Me të gjithë nurin dhe hiret që pati një jetë të tërë. Në atë shtëpi mbizotëronin dy aroma, në gjithë mjediset e saj: Aroma e Djesës dhe Aroma e Gjerges!

Hyri zonja brenda, e pyeti: "Po i zoti i shtëpisë, ku është?"

"Ka shkuar të çlodhet në "Shullëre"-i thanë.

"Mirë, më çoni edhe mua atje, përkrah tij, të çlodhemi bashkë-tha Ajo.

Dhe ashtu u bë...

Fushëbardha, i ngjan një amfiteatri gjigand, i cili përshkohet nga një lumë, i cili në gjysmën e muajve të vitit, është i rrëmbyeshëm. Diku aty nga kreu i "shkallëve" të këtij amfiteatri, është një kodrinë e bukur, rrëzë një pylli. "Shullëret" quhet vendi që Fushëbardha ka zgjedhur si Fjetinë të përjetshme, për të pushuar atje, në amshim të ikurit. Një kodrinë e bukur që shikon diellin, e punuar me merak, nga duart e të gjallëve. Nëse kemi parasysh aksiomën se varrezat e një vendi tregojnë kulturën e tij, Fushëbardha e justifikon plotësisht nivelin e qytetërimit që ka...

Mbishkrimi poetik në varrin e Abdyll Frashërit, ishte një perlë bektashiane. Nga Naimi, ose nga Samiu (nuk dihet saktësisht), janë përzgjedhur dhe shkruar dy vargje: "Njeriu i gjallë është në gjumë. Kur vdes, zgjohet nga gjumi". E Naimi me zgjimin e tij, zgjoi një popull të tërë, por edhe e bëri komb. Dhe po e mban zgjuar, për ata që dinë të lexojnë...

Nëse çdo jetë e ka vdekjen si mundësi, ka edhe vdekje që kanë mundësinë e mos vdekjes. Ashtu siç u krijua kjo mundësi, për çiftin Kazo...

...SEPSE LANË PASARDHËS

....1500 vjet para erës së re, në Egjipt u shkrua "Libri egjiptian i të vdekurve". Në mbyllje të atij libri, shkruhen vargjet: "Vdekja është në sytë e mi sot/Si malli i njeriut për t'u kthyer në origjinë/Jetën e rëndë, për ta zhveshur si një rrobë!"...

...Ne vdekatarët e zakonshëm, ende nuk kemi mësuar për të vdekur siç duhet. Sepse ende nuk kemi mësuar të jetojmë siç duhet. Ti, Çupa e përjetshme, ke ditur të jetosh, prandaj ke ditur edhe të vdesësh. Kjo botë, sa vjen dhe bëhet më tepër një vizion, një shpirt i shkëputur nga trupi i vetvetes. Ndodh rëndom ky fenomen, por jo me familjet e shëndetshme.

Të katër fëmijët e këtij çifti të mrekullueshëm, Eldari, Njaziu, Anxhelua dhe Vjollca, i përcollën prindërit e tyre, në moshën kur kishin njohur dy jetë njëherazi: Jetën e prindërve të tyre, por edhe jetët e tyre personale.

Prandaj ata sot nuk janë si ai nxënësi që pyeti dikur Konfucin: "Çfarë kuptimi ka vdekja? E Konfuciu iu përgjigj: "Kur ende nuk ke kuptuar jetën, si mund të kuptosh vdekjen"?"

Fëmijët e atij çifti, janë të gjithë në moshë të pjekur, me familjet dhe fëmijët e tyre. "Kurrë në jetën time, nuk e kisha bërë rrugën nga shtëpia deri në Shullëre me vrap"-thotë Anxhelua. Dhe kishte të drejtë, sepse nxitoi të shkoste e t'i takonte të dy Kur shkoi për të dyzatat e Çupës...

Kur të rriturit vdesin, fëmijët e tyre dhe fëmijët e fëmijëve të tyre, që gjithmonë lindin në pambarinj, i mbartin ata në trupat e tyre. Por jo vetëm në trupat e tyre. Fëmijët dhe stërnipat i mbartin paraardhësit e tyre, në karakterin e tyre, në sjelljen e tyre, në jetët dhe arritjet e tyre.

NË VEND TË MBYLLJES

...Perënditë janë fatkeqe dhe të mjerë, pikërisht sepse nuk dinë të vdesin fizikisht. Kjo edhe për arsyeën se ato kurrë nuk ekzistuan fizikisht, por vetëm në fantazinë njerëzore. Kurse njerëzit vdesin fizikisht dhe sigurojnë pavdekësinë e tyre, vetëm nëpërmjet pasardhësve dhe cilësisë së tyre....

Njerëzit e mençur të kësaj bote, mendojnë pas-vdekjen. Çfarë gjurmësh lamë në jetë? Çdo të rrugëtojnë pas fundit tim?-shtrohet pyetja. Sepse ajo që mbaron, përherë nis. Në një formë tjetër, e me thelb të njëjtë.

Ndoshta vdekja është fundi i të gjitha fundeve. Apo është fillimi i të gjitha fillimeve???

Me shumë dhimbje, e plot të drejtë dhe me kulturë, zoti Nexhip Onieja, në fund të fjalës së Lamtumirës që mbajti, kërkoi duartrokitje.

Në këtë kuptim, duartrokitjet që shoqëruan vendosjen e Çupës në banesën e përjetshme, të përthyerë në lotët e të gjithë të pranishmëve (lotët nuk mund të diktohen dot), e në ndesat e gjithë fëmijëve të Çiftit që sapo u rimartua, kishin brenda tyre, dy fjali thirre, në shqipërimin e pastër: "Në djall vdekja! Vdekje vdekjes!"...

Opinion **i** Ditës

Kryetarja e LSI-së artikull për portalin evropian "EuropeanInterest.eu"

Një Shqipëri evropiane ka nevojë për një shtet të fortë, dhe jo për një drejtues të fortë

Nga Monika Kryemadhi

Shqipëria është një vend, i cili endet prej 28 vitesh në një tranzicion politik, social dhe ekonomik. Shqiptarët vuajnë ende sot nga mentaliteti dhe kultura e trashëguar e diktaturës së egër 45-vjeçare, e cila është e rrënjësor edhe te liderët e sotëm shqiptarë.

Kanë kaluar rreth 27 vite që vendi është pozicionuar drejt një perspektive të qartë euroatlantike. Shpeshherë integrimi si proces mbetet thjesht një strategji në letër, apo në ëndrrat e shqiptarëve. Edhe pas 3 dekadash ne vazhdojmë të mbetemi një vend kandidat për anëtarësim në Bashkimin Evropian dhe marrëdhënia dhe procesi i vërtetë i integritimit, që do të fillonte me çeljen e negociatave, duket të jetë ende larg. Shqipëria ka bërë pjesë të grupit i atyre vendeve si Bullgaria dhe Rumania, ku në mes të viteve '90 u afrua një mundësi e artë bashkëpunimi me BE, por konflikti i brendshëm politik, ngjarjet e vitit 1997, bënë që ne mos të ndiqnim ritmin e Kroacisë, e cila e nisi procesin e anëtarësimit disa vite pas nesh.

Sot duket qartë se edhe Serbia, Mali i Zi, por edhe Maqedonia e Veriut, do të jenë sërish disa hapa para, duke e lënë Shqipërinë të izoluar mes konfliktit të brendshëm politik, mungesës së theksuar të dialogut, shtetit të kapur dhe rrëshqitjes drejt autokracisë. Është pikërisht ky realitet i hidhur shqiptar, ku sot më shumë se kurrë palët janë të polarizuara në skajet e kundërt dhe se drita jeshile në mes të tunelit të errët thuhet është e padukshme!

Ruajtja e stabilitetit nëpërmjet status-quo-s dhe mosfunksionimi i shtetit të së drejtës, kanë bërë që Shqipëria të ketë një qeverisje arbitrare, ku qytetarëve iu cenohet e drejta e pronës dhe e jetës, ku liria e medias është relative, në bazë të interesave individuale dhe partiake, ku administrata publike përdoret dhe vihet në shërbim të partisë në pushtet dhe jo të qytetarëve, ku reformat shtet-formuese kthehen fatkeqësisht në reforma propagandë në favor të pushtetit.

Opozita në vend nuk është perfekte. Ndonjëherë peng edhe e gabimeve të së shkuarës, është në përpjekjet e saj për një reformim të brendshëm, por edhe për të ndryshuar një sistem që ka rrënuar çdo qelizë të demokracisë. Opozita, e ndodhur para një fushe loje me rregulla të pabarabarta, duke i hequr të gjitha mjetet ligjore parlamentare dhe në mungesë të disa prej organeve kyçe të drejtësisë, si Gjykata Kushtetuese dhe ajo e Lartë, në pamundësi për të ngritur e trajtuar ligjërisht problemet e mëdha, me të cilat përballlet ven-



di, ka vendosur me vetëdije të plotë të ndërmarrë një akt radikal, si ai i djegies së mandateve. Dikush mund të pyesë me të drejtë, a është i drejtë ky akt? Fatkeqësisht edhe unë mendoj që po është i drejtë, në rrethanat dhe në situatën ekstreme, në të cilën ndodhet Shqipëria.

Ne kemi një qeverisje monopartiace, një parlament monopartiak që çdo ditë e më shumë po rrëshqet drejt regjimit diktatorial. Korrupsioni në nivelet e larta ka sjellë kosto të larta për qytetarët dhe ekonominë, mbështetja zgjedhore e faktuar tashmë, që iu dha partisë në pushtet nga krimi i organizuar ka sjellë, për fat të keq, kapjen e shtetit prej tij, ka sjellë kapjen e

ekonomisë dhe kontrollin e shpenzimeve publike.

Situata ekonomike është tepër komplekse, pasi ekonomia jonë është e monopolizuar dhe në duar të vetëm pak individëve. Qytetarëve iu mungon akses i nëpunësim, biznesi i vogël dhe i mesëm është i detyruar të shkojë drejt falimentit, për shkak të taksave të larta. Fermerët ndodhen në protesta të përditshme për shkak të mungesës së gjetjes së tregut për të shitur produktet e tyre, kostove të larta të prodhimit dhe konkurrencës së pandershme. Rinia ka humbur shpresën, duke iu drejtuar shteteve evropiane, si zgjidhjen e vetme për një jetë më të mirë.

Ne kemi shkuar aq larg, sa kemi shkelur marrëdhënien me të rëndësishme kontraktuale me BE, siç është Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit, e firmosur në vitin 2006. Sot disa prej këtyre shkeljeve janë në hetim edhe nga vetë institucionet evropiane, të cilat i kërkojnë llogari qeverisë shqiptare se pse nuk është zbatuar kriteri i konkurrencës së lirë dhe transparencës në investime madhore si aeroporti i Vlorës, apo Teatri Kombëtar, ku nuk janë lejuar të marrin pjesë në garë investitorë evropianë. Pandëshkueshmëria është një tjetër çështje madhore. Për herë të parë zgjedhjet e vitit 2017 në Shqipëri na prezantuan me fenomenin e përfshirjes së kriminit të organizuar në shitblerjen e votës. Fakt ky që u vërtetua nga përgjimet e prokurorisë shqiptare dhe ku u zbulua se zyrtarë të lartë ishin të përfshirë në këto afere kriminale. Ende dhe sot drejtësia heziton të hetojë deri në fund këto çështje. Drejtësia është në duar e pushtetit dhe mungesa e Gjykatës Kushtetuese e ka bërë të vështirë luftën opozitare brenda institucioneve.

Të gjendur përpara një situatë të tillë, opozita nuk kishte asnjë rrugëdalje tjetër, veç asaj të djegies së mandateve dhe kërkesës së preur dhe të qartë për zgjedhje të lira dhe të ndershme, që do t'i japin

mundësinë shqiptarëve të zgjedhin të lirë qeverinë që duan.

Djegja e mandateve në asnjë rrethanë nuk është motivuar nga neglizhimi i përgjegjësjve politike dhe përfaqësuese. Në thelb, ajo është një rrugë ekstreme e ndër-marrë në kushtet e sjelljes refraktare dhe injoruese të institucionit të opozitës nga mazhoranca, me qëllim përshpejtimin e një konkurrimit të drejtë e të ndershëm në një proces zgjedhor jo të kontrolluar nga krimi, apo nga mazhoranca.

Partnerët ndërkombëtarë të Shqipërisë, përfshirë Komisionin Evropian, shpesh kanë mbyllur sytë përballë sjelljes politike të mazhorancave dhe trajtimit prej tyre të problemeve të mëdha të vendit, duke toleruar arrogancën dhe "dorën e fortë", në këmbim të stabilitetit në dukje që ajo sjell. Ne besojmë në vlerat dhe demokracinë evropiane dhe jo në stabilitetin imagjinar, që në vetvete destabilizojnë vendet me demokraci të brishtë si Shqipëria. Frika se djegja e mandateve dhe rrëzimi i një qeverie mund të kthehet në një precedent edhe për vendet e tjera të rajonit, nuk është argument i qëndrueshëm. Unë dëshiroj t'iu drejtoj një pyetje të gjithë atyre që i druhen ndryshimit politik në Shqipëri: Mos ndoshta është më mirë krimi i këtij precedenti që të parandalohet edhe në vendet e tjera instalimi i një regjimi autokrat, siç po ndodh në Shqipëri? Mos vallë është më e rrezikshme mungesa e demokracisë, institucioneve dhe reformave shtet-formuese sesa thjesht rrëzimi i një individi nga pushteti? Sot të gjithë ne duhet të tolerojmë diçka nga vetja për të bërë shtet. Shqipëria nuk ka nevojë për liderë të fortë, por mbi të gjitha për të është jetike një shtet i fortë, i drejtë dhe i barabartë për gjithë qytetarët shqiptarë. Këto janë vlerat që qëndrojnë në themel të Evropës, të cilës ne duam t'i bashkohemi.

Situata në të cilën ndodhemi ka vetëm një zgjidhje, një pakt kombëtar, ku të gjitha palët të kenë si pikënisje rivendosjen e dialogut politik në vend. Politika shqiptare duhet të fillojë të ndajë një herë e përgjithmonë programet partiake me interesat kombëtare. Kjo duhet të nisë me ndryshimin e mentalitetit, me alternativat konkrete që duhet të vendosen në tryezë për ndryshimin e këtij sistemi të rrënuar. Pakti kombëtar duhet të jetë për shqiptarët dhe lufta politike duhet t'i shërbejë ofrimit të mundësive dhe të një jetese më të mirë për ta. Kjo është oferta e Lëvizjes Socialiste për Integrim, ofertë për Shqipërinë dhe të ardhmen e saj evropiane.

Opinion i Ditës

Për ata që kanë naftë në vend të mushkërive

Nga Fatos Çoçoli

(vijon nga faqja 1)

... brez naftëtarësh tejet i vuajtur, i cili vjen drejt për së drejti pas asaj plejade të naftëtarëve të parë heroikë, të cilët krijuan nga hiçi industrinë shqiptare të naftës dhe gazit në vitet 30-40-të të shekullit të kaluar. Sot pjesa më e madhe e tyre nuk jetojnë më dhe një numër shumë i vogël jetojnë ditët e fundit në moshën e tretë, me një pension varferie. Pas vitit 1992, filloi për naftëtarët tanë një presion i jashtëzakonshëm psikologjik. Nisën kërcënimet me humbjen e vendit të punës. Shkurt vihej në diskutim buka e gojës. Pasiguria për vendin e punës, kushtet e vështira ekonomike dhe pasiguria për jetën i detyroi shumicën e punonjësve të naftës, sidomos inteligjencën e naftës, që të përfundojnë emigrantë nëpër botë. Ligji Nr. 8/2017 "Për Statusin e Punonjësve të Industrisë së Naftës dhe të Gazit" (i mbiquajtur Statusi i Naftëtarit) i shkurtit 2017, me gjithë qëllimin e mirë ose butaforik (për të marrë vota për zgjedhjet e qershorit 2017) për të cilin u përgatit, është i pazbatueshëm sot. Për të përfutur "Statusin Naftëtar" me këtë ligj, është miratuar që kufiri minimal të jete jo më pak se 20 vjet punë në naftë për burrat dhe 15 vjet për gratë. Mirëpo me kusht që të kenë një kontribut sigurimi të përgjithshëm në punë përkatësisht 30 vjet dhe 25 vjet! Bazuar në këtë ligj, pjesa më e madhe e naftëtarëve që kontribuan në industrinë e naftës pas vitit 1974, ku përfshihet ajo pjesë që në masë emigran jashtë shtetit, ata që u hoqën nga puna padrejtësisht për motive



politike, apo një pjesë e inteligjencës që u transferua nga sektori i naftës për shkak të riorganizimit ose për arsye të ndryshme, nuk e përfitojnë "Statusin Naftëtar". Këta mund të jenë më shumë se gjysma e naftëtarëve. Atëherë përse bëhet ligji për statusin e tyre, kur nuk e përfitojnë shumica e naftëtarëve? E atyre që kanë naftë në vend të mushkërive? Që vuajnë nga sëmundje respiratore dhe profesionale të egra? Së

pari, kjo kategori punonjësish ka punuar më pak ose rreth 20 vjet në industrinë e naftës, sepse emigrimi ose heqja nga puna për arsye të mësipërme filloi menjëherë pas rënies së sistemit komunist, që në vitin 1992. Ndërkohë që vjetërsia minimale në punë për të përfutur një pension të pjesshëm ose gjysmë pensioni, në të gjithë sektorët e ekonomisë tonë, është sanksionuar me ligj me 15 vjet kontribut sigurimi. Së dyti, po kjo kategori

punonjësish (që për arsye më lart janë larguar nga nafta), edhe nëse ndonjëri prej tyre ka punuar 20 vjet ose dikë më shumë në industrinë e naftës (ose 15 vjet për gratë), prapë nuk e përfiton Statusin, nga që kontributi i tij/saj i sigurimit është ndërprerë. Pra, nuk plotëson kriterin tjetër të ligjit që kërkon që punonjësi të ketë një kontribut të përgjithshëm sigurimi 30 vjet për burrat ose 25 vjet për gratë! Një kriter realisht absurd. Së treti,

naftëtarët e mbledhur dhe më 1 maj në Kuçovë, u shprehën se projektligji i përgatitur për trajtimin financiar shtesë i profesionëve të vështira (minatorëve, naftëtarëve dhe metalurgëve) është i mangët, pasi nuk përfshin dakordësinë e shprehur që më 26 prill 2018 mes Ministrisë së Energjetikës dhe Infrastrukturas dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, që trajtimi financiar shtesë i pensionistëve nga këto profesione të ishte sa 40 për qind e pagës minimale të vendit (që është 260 mijë lekë të vjetra në muaj), pra 100 mijë lekë në muaj. Trajtimin financiar të fiksuar në projektligj prej pak më tepër se një të tretën e këtij dakordësimi (3.800 lekë në muaj), naftëtarët, njëjloj si dhe minatorët që protestuan përpara Kryeministrit një javë më parë, e konsiderojnë një tallje ndaj vuajtjeve të tyre. Madje edhe ndaj vullnetit të kryeministrit për të zgjidhur këtë padrejtësi shoqërore të mbartur 28 vjet! Naftëtarët në Kuçovë thanë që se kosto financiare vjetore për buxhetin tonë të shtetit për ta ndrequr këtë padrejtësi për kategorinë e tyre është vetëm 2.3 milionë euro në vit. Ndërkohë kur buxheti i shtetit nga puna e tyre ka arktuar në 15 vjet e fundit 2 miliardë euro në formën e taksave. Naftëtarët i dërguan një peticion kryeministrit, me këto kërkesa të tyre për të ndryshuar statusin që kanë marrë, si dhe projektligjin për trajtimin financiar shtesë. Do ta konsiderojë vallë kryeministri këtë peticion?

Opinion i Ditës

Shkon haka te i zoti?

Igli Tola

Në çdo bisedë mes miqsh, kolegësh apo goftë edhe mes të panjohurish që i bën bashkë marrja e kafes, apo ndonjë gotë në banakun e klubit diskutimi dashje-padashje dominohet nga aktualiteti i politikës. E në një vend të vogël si ky i yni ku pas një bisede disa minutëshe me dikë dalim kushërinj apo të njohur, aktualiteti analizohet në rrafshin personal. E kështu ligjëratat merr trajta konfidenciale, kur bashkëbiseduesi ia pret: "Mos më fol mua për X, e kam pasur shok banke në shkollë, mezi e mësoi tabelën e shumëzimit në vit të fundit gjimnaz".

Mbas kësaj 'qyfyreje', të gjithë i kap gazi dhe fillon konkurrenca kush e butaforizon dhe hiperbolizon më këndshëm historinë jetësore të VIP-it që e ka të 'vetin'. Por, këto situata përveçse të na shkaktojnë ilaritet nuk ka pse të na bëjnë përshtypje. Në shoqëritë tona, sigurisht jo vetëm atë shqiptare por edhe globale, ndodh në masë që njerëz që nuk kanë njohuritë minimale, bëhen ekspert të mar-

rëdhënieve ndërkombëtare, të punëve politike, të llogaritjeve astrofizike apo edhe të teorive të konspiracionit.

E këto nuk janë raste sporadike, por fenomene sociopsikologjike që janë provuar dhe analizuar shkencërisht. Shpjegimin e parë ezaures ia dha dyshja e shkencëtarëve Dunning dhe Kruger, në studimin që përmbledhet në "efektin Dunning-Kruger". Fenomeni i përshkruar në vitin 1999 ka të bëjë me një crregullim të njohjes, për shkak se njerëz që dinë shumë pak, tentojnë të mbivlerësojnë aftësitë e tyre dhe të sillen me arrogancë. Thënë ndryshe, sa më pak di, aq më shumë pretendon se di.

Pikërisht ajo që ka ndodhur dhe po ndodh në jetën politike shqiptare, veçanërisht në organin më lartë legjislativ, parlamentin e Shqipërisë mund të jetë pjesërisht pasojë e efektit të sipër analizuar. Persona me CV super modeste, pa eksperiencën publike, që zor se kanë lëcurtur ndonjë libër në jetën e tyre, pa diploma ose me diploma fiktive (të blera) 'sajohen' në lista për tu zgjedhur ndër 140 përfaqësuesit e

popullit.

Nga njëra anë kemi profesorë, teknikienë apo intelektual të cilëve edhe ndër të paktat raste kur u propozohet të jenë pjesë e politikës, dyshojnë dhe mendojnë se do të ishin më të vlefshëm në sektorin apo lëmin e tyre, duke mos e parë veten në 'lartësinë' e duhur të postit të ri. Kundërpartia tjetër janë ata që preferojnë të vendosen edhe të "140+1"-të në listë, vetëm që të krekosen 'jam kandidat për deputet'. Më pas, fillojnë e mendojnë se janë 'Mesia'. Fillojnë dhe e bindin veten se kanë monopolin e vendimmarrjes, misionin hyjnor të shpëtimin të fatëve të kombit, e vetos në ndarjen mes gjërave të drejta dhe atyre të gabuara. Me mediokritet i bëjnë karshillëk çdo ekspertizë që vjen nga jashtë, pasi ata kanë 'votat e qytetarëve' dhe i bëjnë 'sehir' çdo akuzë konstruktive me imunitetin që gëzojnë. Jo më kot, janë me 'pikatore' akademikë dhe profesionistë në këto legjislaturat e fundit që kanë ndënjur më shumë se një mandat në sallën plenare. E të mendosh që parlamenti është pjesë më e evidente në 'maleware'-in e

sistemit të promovimit që ndjek shoqëria.

Kësaj situatë i shkon përshant shprehja e popullit: "Sa kohë mendohet i zgjuari, budallai ka mbaruar punën", aforizëm të cilin një prej themeluesve të filozofisë analitike të shekullit të XX-të, Bertrand Russell e formulonte: "Problemi i njerëzimit është se budallenjtë janë shumë të sigurt në vetvetë, ndërsa të mençurit plot me dyshime".

Për të dalë nga kjo situatë nuk mund të ketë receta me garanci 100% për kurimin e fenomenit. Nuk ka zgjidhje imediate, por duhet të fillojmë të angazhohemi për gjërat që vërtetë vlejnë për ne. Deri më sot vetëm ankohe mi për gjërat që nuk na pëlqejnë ose nuk shkojnë sipas pritshmëriëve tona, duke e parë fajin te të tjerët; pa marrë përgjegjësi mbi vete. Po që se duam të trajtohe mi me dinjitet për atë që vërtetë përfaqësojmë në shoqëri, duhet të fillojmë të veprojmë aktivisht si qytetarë.

Realitetin mund mos ta ndryshojmë, por së paku ta përmirësojmë sado pak duke dalë jashtë 'comfort-zone'-së sonë, duke u an-

gazhuar dhe ushtruar përgjegjësi të tona sociale. Pa ekuivok secili prej nesh të nisë të 'përballë' frontalisht me injorancën dhe injorantët, pa u stepur nga klishetë dhe stereotipet e së kaluar që na këshillojnë ta toleronim atë? "Hapi rrugë budallait". Çdo dallkaku apo satrapi, jo vetëm të politikës, por i çdo fushe goftë ai, që vjen dhe mundohet të na imponojë respekt dhe simpati përmes propagandës, apo dogmave që as vetë nuk i kupton duhet të mos hezitohet për t'ia thënë troç se nuk e 'honesim' dot nivelin e tij. Troç, sepse heshtjen e marrin për aprovim dhe vijnë t'i hyjnë 'detit në këmbë'.

Po vetëm kaq mund të mos mjaftojë që këto 'sqimtarë' të tërhiqen nga 'ëndrra' e tyre. Paralelisht duhet të paraqiten alternativa të denja, të pastra dhe të pakontestueshme. Përpara figurave me integritet dhe me 'themel' solide intelektuale që prodhojnë platforma dhe teza të argumentuara e logjike kategoria e sipër shqyrtuar do të fillojë të ndiejë 'tik-takun' e 'countdown'-it...

Opinioni **i** Ditës

Drama në Berlin, kush, çfarë i tha kujt (dhe Baton Haxhiu über alles)

Nga Berat Buzhala

(vijon nga faqja 1)

... të rëndësishme për të gjithë Ballkanin. Pasgjerë ishin Presidenti Thaçi, Kryeministrat Rama dhe Haradinaj, Lordi vetë, si dhe gazetari zyrtar i shtetit të Kosovës, zoti Baton Haxhiu.

Gjatë gjithë udhëtimit, thuhet që, vetëm piloti kishte qëndruar neutral karshi taksës ndaj mallrave serbe, të cilën qeveria e Kosovës e ka vendosur muaj më parë. Të tjerët, secili duke përdorur taktikat më të mira personale për mashtrim, kishin provuar - për të disatën herë - ta bindnin Kryeministrin Haradinaj se taksa e kishte dhënë efektin e vet. Refreni që taksa e ka dhënë efektin e vet ka filluar të përsëritet ditën e nesërme të vendosjes së saj. Sot e kësaj dite askush nuk e di se me çka është konstatuar dhënia e efektit të taksës!

Nuk kishte vazhduar për shumë kohë përpjekja për ta bindur Haradinajin. Diku mbi qiellin e Bosnjës kishin hequr dorë. Në pamundësi për ta thyer Kryeministrin Haradinaj pasgjerë kishin filluar që të flasin, siç do të thoshte Batoni, për "gjëra të bukura". Se çfarë mendon Haxhiu me "gjërat e bukura" kjo është një enigmë e madhe, por është e rëndësishme që të thuhet se palët kishin zbritur nga avioni i Lordit pa ndonjë marrëveshje se çfarë do të flasin ose çfarë nuk do të flasin në takimin për ku ishin nisur.

Rrugës për në hotel dy delegacionet ishin ndarë, ai i Shqipërisë për në Regent Hotel, këta të Kosovës për në Hilton. Batoni në udhëkryq, për të qëndruar sa më afër të dyja ekipeve. Paradite të Thaçi, pasdite të Rama. Të hidhëruar që nuk e kishin bindur Ramushin që të subordinohej veprimet e tij me ato të Ramës dhe Thaçit, këta të dytë, bashkë me Batonin e kishin marrë për dorë edhe të diturin Gent Caka dhe kishin ngrënë drekë së bashku. Se çfarë kanë biseduar gjatë drekës është e vështirë të dihet. Ndoshta edhe aty Batoni ka vazhduar që të flasë për gjërat e bukura, si bie fjala pikurë, art, muzikë klasike, kinematografi të viteve të 50'ta dhe 60'ta. Tek e fundit Thaçi shquhet për shije të holla kulturore. Ka mundësi që pjesën më të madhe të kohës së tij në udhëtime ai e kalon nëpër galeri të ndryshme, jashtë syve të opinionit.

Pasi që e kishin ngrënë drekën, delegacioni nga Kosova ishin nisur për ta takuar ambasadorin amerikan në Berlin, Richard Grenell, njëra prej figurave më kontradiktore të administratës së Presidentit Trump. Prej kur ka zbarkuar në Gjermani, ky ambasador ka provuar që ta sabotojë kancelaren Merkel, qoftë përmes intervistave në media të ndryshme, qoftë duke i takuar me një pompozitet liderët e Alternativës Për Gjermaninë, grup i ekstremit të djathtë, të lidhur në një formë me liderin rus Vladimir Putin. Meqë nuk jemi në vizitë për të zgjedhur, e as për t'ia përcaktuar Presidentit Trump ambasadorët,



atëherë nuk na mbetet tjetër për të thënë, përveçse shumë mirë që e takuan atë.

Gazetari zyrtar i shtetit, Batoni, nuk ka qenë në këtë takim, anipse ka mundësi që paraprakisht e ka ditur deri në detaje se çfarë do të flitet aty brenda. I ka treguar dikush atij. I ka Batoni disa kontakte misterioze në nivele të larta botërore që e njoftojnë paraprakisht se çfarë do të ndodhë me ne, por edhe me rajonin, në disa dekada të ardhshme. Se në çfarë guhe komunikon ky me ta, kjo është, gjithashtu, shumë misterioze. Nëse një gjë e tillë bëhet në gjuhën angleze, atëherë frikësohem shumë që mesazhet do të lexohen gabimisht. Bashkë, Thaçi dhe Batoni nuk arrijnë ta flasin dot një anglishte të nevojshme për të mbijetuar për bukë dhe për ujë.

Sido që të jetë, pas takimit me amerikanin, Thaçi, i shoqëruar nga Bekim Collaku, Haradinaj, i shoqëruar nga Lordi, ishin nisur për në zyrat e Kancelares Merkel, ku do të vinte Presidenti Makron dhe pjesa tjetër e delegacionit nga rajoni i Ballkanit Perëndimor. Gazetari i shtetit, në anën tjetër, ishte nisur për në sheshin afër portës së Brandeburgut, prej ku do të raportonte në kohë reale për në Kosovë, se çfarë po ndodhte atje brenda. Pa filluar mirë takimi, kur palët ende nuk i kishin zënë ulëset, Batoni i armatosur me fuqi paranormale, po tregonte se atje brenda punët ishin llugë. Po, po, llugë. Dukej që nuk po flitej për gjëra të bukura. Gjithsesi nuk dëshiron të lëshojë shumë në detaje, sepse çfarë kuptimi do të kishte pastaj i gjithë takimi, që supozohet të ishte me dyer të mbyllura. Mirëpo për Batonin nuk ka dyer të mbyllura. Fuqia e tij i thyen ligjet e fizikës. Ai ka mundësi që të jetë fizikisht në të njëjtën kohë në, se paku, dy vende. Vuan gjithashtu edhe nga sëmundja e leximit të mendimeve të të tjerëve, në një përmirë prej disa kilometrave.

Në ndërkohë kur gazetari shtetëror po fliste në disa media, në të njëjtën kohë, brenda zyrës së Kancelares Merkel po vazhdonte takimi. Thaçi të tjera fjalë i kishte folur në ambasadën amerikane në Berlin, e të tjera fjalë po i fliste në këtë takim. Amerikanëve u kishte thënë se pa ju nuk bëhet dot gjë, tash të njëjtën po ua thoshte zonjës Mer-

kel dhe zotit Makron. Ata që kishin qenë pjesëmarrës në takim kanë treguar që pjesa kryesore e tij ishte zhvilluar në një sallë, ku pjesëmarrësit po qëndronin në këmbë dhe në grupe. Vëmendja ishte e përqendruar te kryeministri Haradinaj. Dy udhëheqësit më të fuqishëm të Bashkimit Evropian, Merkel dhe Makron, kishin filluar të ushtronin trysni te Haradinaj për çështjen e taksës. I kishin kërkuar atij që ta suspendonte atë për katër ose gjashtë muaj. Në një moment të caktuar Merkel dhe Makron e kishin nxjerrë Haradinaj në terracën e ndërtesës ku po zhvillohej e gjithë ngjarja. I mbështetur për muri Haradinaj u kishte thënë atyre "a të kërcëj nga ndërtesa?"

Vuçiç, në anën tjetër, duke e parë këtë situatë, duke e parë që Haradinaj nuk po thyhej i kishte thënë zonjës Merkel, me zë të lartë "kot po flisni me të, sepse atij dikush nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës i ka thënë që të mos e heq taksën".

Në vend që ta ndihmonte, Kryeministri i Shqipërisë Edi Rama kishte vendosur që ta godiste kolegën e tij nga Kosova, edhe në gjuhën angleze që ta kuptonin të gjithë, por edhe në gjuhën shqipe. Rama ishte kujdesur që sa herë i kishte thënë Haradinajt që ta hiqte taksën, atë ta dëgjonin edhe Merkel edhe Makron. Pastaj, në gjithë këtë situatë Haradinaj e kishte humbur paksa toruan. Kur Rama i kishte thënë, tash në gjuhën shqipe, që ta hiqte taksën, Haradinaj i ishte kthyer Ramës sikur vëllai-vëllait, duke ia ofruar për desert një organ trupor. Mirëpo termin që Haradinaj e kishte përdorur për organin nuk ka qenë shumë brutal, më shumë është një trajtë që nënat e përdorin për fëmijët e tyre të vegjël. Duke e parë se sa është sahati, Rama kishte vendosur që të spostohej, bashkë me Thaçin, në një kauç që ndodhej diku në sallon. Kishin mbetur krejtësisht të paangazhuar dhe irrelevant. Në një fotografi që arrita ta shoh, Thaçi dhe Rama të ulur në atë kauç, dukeshin më shumë si dy burra të mërzhitur në një pasdite vere, se sa si dy burrështetas që ishin pjesë të një takimi të rëndësishëm racional. Ajo çfarë Haradinaj i kishte thënë, Ramës i kishte mbetur

pikë në kokë. Diku kah fundi i takimit i kishte thënë kryeministrit të Kosovës "përse me ofendove?" Haradinaj i është ankuar Ramës se po i bën shumë presion.

Thaçi, prej anës së tij, kishte vazhduar që të lobonte që të hiqte taksa e "Hoxhajt dhe Veselit", por nuk ishte angazhuar që të komunikonte me Haradinajin në biseda private. Presidenti i Kosovës kishte folur për audiencën ndërkomëtare. Mirëpo, secili hallet e veta në këtë takim, edhe Thaçi i kishte pasur të tijat. Ai ishte preokupuar tej mase që të mos konsiderohej heretike, dhe e tejkakuar, ideja për korrigjimin e kufijve në mes të Kosovës dhe Serbisë, për të cilën ai dhe Vuçiç kanë shpenzuar shumë energji, e ndoshta edhe pare. Mirëpo përfaqësuesi mysliman i Bosnjës dhe Hercegovinës ishte kujdesur që kjo temë të hapej, në mënyrën më të keqe për Thaçin. Ai, në një fjalim të gjatë, kishte thënë që nëse preken kufijtë, kudo në Ballkan, atëherë tragjeditë janë të pashmangshme. Ai kishte thënë që rajoni do të zhytet në luftë dhe masakra, nëse kjo ide gjen zbatim praktikë. Në këtë moment Thaçi ishte shqetësuar, ndoshta jo aq përse po fliste një politikën nga Bosnja, por që këto po i dëgonte një politikane nga Gjermania. Shumica dërrmuese e të pranishmëve në takim ishin pajtuar me politikanin boshnjak. Fjalimi i tij për rrezikun e prekjës së kufijve konsiderohet që ishte gozdhë e fundit në arkivin e kësaj ideje.

Ka që thonë se takimi në Berlin kishte qenë një dështim. Ka mundësi që ka qenë i tillë, mirëpo vetëm për disa ishte i tillë. Në Berlin thjesht ka dështuar plani për ndarje të Kosovës. Fare në fund të tij të gjithë pjesëmarrësit janë ulur prapë rreth një tryeze të përbashkët. Makron dhe Merkel janë dukur të relaksuar. Ata i kanë ftuar palët që të shkonin në Paris me 1 korrik për të vazhduar përpjekjet për të gjetur një zgjidhje në mes të Kosovës dhe Serbisë. Deri atëherë ata do të dërgojnë në rajon përfaqësuesit e tyre për të diskutuar për modalitetet.

Kryeministrja e Gjermanisë dhe Presidenti i Francës janë të bindur që Bashkimi Evropian ka kapacitet, por edhe detyrim, për t'i mbyllur zënkat në rajon. Ka mundësi që personaliteti i vetëm në Ballkan që edhe më tutje nuk është i bindur në fuqinë gjermane është gazetari zyrtar shtetëror, i cili ka disa muaj që në udhëtime zyrtare të Presidentit Thaçi po e shoqëron atë, duke e zëvendësuar kështu Nqadhimj Kastatin, i sapozgjedhur drejtor i RTK-së.

Me fjalë të tjera kjo ishte historia e takimit në Berlin. Mirëpo kjo është historia sipas meje, që do të thotë është histori relative. Ju të dashur lexues, që erdhët deri në fund të këtij shkrimi, historinë e vërtetë, atë absolute, atë që e mbanë vullën e Thaçit dhe të Ramës, kërkojeni te Batoni.

HOROSKOPI

DASHI
Energjia juaj është në nivelin më të lartë sot dhe fokusi juaj është mjaft i mprehtë. Nëse jeni duke pritur për të organizuar jetën tuaj, kjo është ajo dita e duhur. Vendosni rregullat tuaja për kohë të pasur kaos.

DEMI
Para se ta lejoni veten që të zemëroheni, bëjini vetes një nder dhe rishikoni situatën. Përpigjuni të mos merrni asgjë personale. Jini objektive, analitike dhe të kujdesshëm si dhe dëgjoni anën tuaj konservatore duke mos e lënë veten të kapeni nga emocionet.

BINJAKET
Rishikoni ngarkesën tuaj në punë dhe rivelesoni pishmerrësit që keni për veten tuaj dhe për njerëzit me të cilët punoni. Tani për tani, duhet të keni një pikëpamje të re për gjërat. Sapo të pranoni se gjërat nuk do të ndodhin ashtu siç dëshironi, do të zbuloni planin e ardhshëm më të mirë.

GAFORJA
Çështjet e pronës mund të marrin zgjidhje sot nëse tregoni zgjuarsi në momentin e duhur. Favorizoheni në nënshkrimin e kontratave dhe dokumenteve. Në vendin e punës mund të merrni mbështetje nga një koleg.

LUANI
Sot, përpigjuni të merrni në konsideratë vetëm gjërat që dini në jetën tuaj. Janë pikërisht ato faktet ku duhet të mbështeten. Tani për tani, të panjohurit nuk kanë fuqi dhe janë të parëndësishme. Njerëzit që ju duan do t'ju japin atë që ju nevojitet ashtu siç dëshironi.

VIRGJERESHA
Askush nuk e do krijesën, madje edhe atë konstruktive. Por me kalimin e kohës, të gjithë duhet ta dëgjojnë atë, duke përfshirë edhe ju. Ju do të merrni një përfundim të madh nga reagimet që njerëzit e tjerë ju japin sot.

PESHORJA
Ata njerëz që nuk ju kanë vënë re deri më sot duhet të kenë kujdes! Sepse ju jeni gati për të bërë një shpërthim, dhe ata do të pyesin veten se ku kanë qenë që nuk ju kanë dalluar. Kjo është një kohë e ndritshme për ju.

AKREPI
Një mik është plot me ide të reja të ndritshme. Problemi është se do të shihni menjëherë disa vrima në logjikën e tyre. Yjet ju këshillojnë të mos harroni se çdo person është i lirë të bëjë gabimet e veta dhe të mësojë prej tyre.

SHIGJETARI
Ndonjëherë stili juaj i komunikimit thotë më shumë për njerëzit sesa fjalët që shprehni. Jini të vetëdijshëm për qëndrimin që po jepni dhe jini shumë të kujdesshëm me mënyrën se si flisni.

BRICJAPI
Ju jeni duke hyrë në një fazë më të qetë të jetës suaj. Ju keni disa vizione për të ardhmen për të cilat nevojiten disa ndryshime të mëdha, prandaj përdorni këtë kohë të qetë për t'u përgatitur.

UJORI
Vetëm për shkak se madhështia juaj nuk ka patur mundësi të shfaqet kohë e fundit nuk do të thotë se ju mungon talenti. Në çështjet e dashurisë mund të keni disa surpriza të këndshme ditën e sotme.

PESHQIT
Jini të hapur për të ndryshuar mendim mbi një çështje të caktuar. Një person inteligjent nuk ka frikë të rishqyrtojë situatën e ndryshme veçanërisht në aspektin profesional. Situata ekonomike parashikohet të mos ketë luhataje.

ISH-DONATORI

Pak ditë pasi kryebashkiaku Erjon Veliaj deklaroi publikisht se kishte nxjerrë në shitje 34% të aksioneve të Tiranës, vlerën që zotëronte Bashkia e kryeqytetit, del në skenë publikisht emri i parë mes atyre që dëshirojnë të zotërojnë këtë pjesë të klubit. Ish-donatori i Tiranës, Julian Morina, bën të ditur se është



gati të kthehet dhe ka një plan konkret për të ndihmuar ringritjen e bardhebluve. Morina, i cili ka financuar te bardheblutë edhe në vitin e krizës 2013-2014, deklaroi se është gati të japë përsëri kontributin e tij financiar, ndërsa pret që të ketë trajtim të veçantë nga Bashkia, ashtu siç duhet të kenë të gjithë ata që kanë investuar në këtë klub. "Unë

Morina: Kam një projekt, dua të blej aksionet e Tiranës

nuk besoj se është diçka preferenciale, por është e shkruar në ligj. Këshilli bashkiak ka miratuar që për donacionet që do të jenë në shitje, do të merren parasysh ata që kanë qenë investues më parë. Unë jam një ofertues në këtë

anë, padiskutim do të jenë edhe të tjerë dhe është plotësisht logjike dhe ligjore që ne që kemi kontribuar të jemi pjesë e shitjes, në përlligjeritjen e vlerave për ofertuesit", shpjegoi Morina për RTSH. "Pres që financimin që kam

bërë të llogaritet në shitjen kur bashkia do të nxirrte aksionet e saj në shitje. "Unë kam shprehur dëshirën të jem pjesë e këtyre aksioneve. Mund të mos jem vetëm unë, nuk ka rëndësi. Kushdo qofshin, jemi për të mirën e Tiranës. Unë kam një projekt që duhet të bëhet më prezent në momentin që do të zotëroj aksionet", deklaroi biznesmeni



Jeton Selimi

Gjopa për Tiranën dhe Skënderbeun, ndërsa është hapur hetim për incidentin Batha-Radas

Disiplina trondit Partizanin, Telushi dhe Gega pezullohen

Mesfushori ndëshkohet me 4 ndeshje, trajneri me 2

Komisioni i Disiplinës ka vepruar me dorë të rëndë ndaj Partizanit për atë që ndodhi në fund të ndeshjes me Laçin. Mesfushori i ekipit të kuq, Bruno Telushi, ka marrë një dënim prej katër ndeshjesh. Trajneri Skënder Gega është dënuar me dy ndeshje për protesta. "Lojtari i KF "Partizani", Bruno Telushi, për sjellje jo sportive ndaj zyrtarit të ndeshjes, në bazë të Nenit 49/1/a të KDS, dënohet me 4 (katër) ndeshje pezullim nga aktivitetet. Zyrtari i KF "Partizani", Skënder Gega, për protesta ndaj zyrtarit të ndeshjes, në bazë të Nenit 56/1/a të KDS, dënohet me 2 (dy) ndeshje pezullim nga aktivitetet", lexohet në vendimet e disiplinës. Kështu, Telushi do të jetë një mungesë e sigurt për dy ndeshjet e ardhshme, atë ndaj Flamurtarit në Vlorë, që është edhe origjina e tij, si dhe në derbi ndaj Tiranës. Ndërkohë, për dy takimet me Teutën në transfertë dhe Kukësin në shtëpi, për të mund të konvertohet në para gjysma e dënimit. Sidoqoftë, dilemat e "demave" për titullin që e kanë shumë pranë, mund të mbyllën brenda dy javëve të ardhshme, dhe Telushi me siguri do të festojë nga tribuna këtë arritje të



madhe. Nga ana tjetër, trajneri Gega nuk do të jetë i pranishëm në stolin e ekipit, ndërkohë që edhe për të gjysma e dënimit mund të kon-

vertohet në para, për derbin ndaj Tiranës. Me gjobë janë dënuar klubet e Tiranës dhe të Skënderbeut, për shkak të sjelljes së gabuar të tifozërve të tyre në ndeshjet e fundit. 1. KF "Tirana", për sjellje të gabuar të tifozërve, në bazë të Nenit 66/2 të KDS, dënohet gjobë në masën 100.000 (njëqindmijë) lek. 4. KF "Skënderbeu", për sjellje të gabuar të tifozërve, në bazë të Nenit 66/1 të KDS, dënohet gjobë në masën 100.000 (njëqindmijë) lek". Po ashtu, ka nisur një procedim disiplinor në lidhje me incidentin mes Marko Radas të Skënderbeut dhe Idriz Bathës së Flamurtarit. "24. Çeljen e hetimit disiplinor për incidentin midis lojtarit të FC "Flamurtari", Idriz Batha dhe lojtarit të KF "Skënderbeu", Marko Radas, thuhet në vendimet e publikuara nga FSHF.

Alegri: Çdo vit më largojnë, por po fitoj titullin prej 5 sezonesh

E ardhmja e Masimiliano Alegrit është tema më e diskutuar këto ditë në ambientin që rrethon Juventusin. Tekniku i Zonjës së Vjetër nuk ka vendosur ende nëse do të vazhdojë të udhëheqë bardhezinjtë edhe vitin tjetër apo presidenti Anjeli do të preferojë dikë tjetër, që mund të i garantojë suksesin evropian. Në konferencën e djeshme për shtyp para derbit të qytetit ditën e nesërme përballë Torinos, tekniku livornez theksoi se duhet të takohet me presidentin, ndërsa sa i përket zërave që e shohin larg Juventusit shtoi se ka 5 vite që dëgjon të njëjtat gjëra. "Përgjigja nëse do të qëndrojë apo jo është e thjeshtë. Duhet të flas me presidentin dhe të programojmë vitin tjetër, të flasim dhe të diskutojmë për atë çfarë nuk shkoi këtë sezon. Duhet të flasim për mundësin se si të përmirësojmë edhe më tepër skuadrën. Ndërsa për të tjerat, zërat që qarkullojnë jam mësur. Thujasë në çdo vit duhet të largohesh, por ky është viti i 5 këtu", përfundoi Alegri.

SITUATA

Barcelona tallet me UEFA-n për më të mirin e ndeshjes

Si çdo fund ndeshjeje, profili "Twitter" i UEFA Champions League, hap sondazhin mes ndjekësve të saj për të nxjerrë lojtarin më të mirë të dy takimeve gjysmëfinale të luajtura në këtë mesjavë. Katër të përzgjedhurit e UEFA-s janë Doni van Bek, Frenki De Jong, Luis Suarez dhe padyshim Lionel Mesi. Por, mes përgjigjeve të shumta spikat ajo e Barcelonës, që në profilin e



saj bën shaka me UEFA-n, duke shkruar: "Hë pra tani UEFA Champions League, seriozisht e ke këtë pyetje?". Natyrisht referimi është për "Pleshtin", që kundër Liverpulit shënoi një dygolësh, të kurorëzuar me atë goditje të mrekullueshme dënimi.

SULMUESI


Reali do presë dhe 1 vit për Neymar që ta marrë me ulje

Transferimi i brazilianit Neymar te Reali i Madridit është më shumë sesa një obsesion merkatoje, pasi prej dy vitesh është shndërruar në një tele-novelë të vërtetë, me çdo dritare merkatoje, e cila duket si më e përshatshmeja për ta veshur me fanellën e bardhë të madriellëve, yllin e Paris Sën Zhermenit. Por sipas "Mundo Deportivo", ekziston një klauzolë shitjeje "e pranueshme" për dikë që kërkon të shpenzojë, por hyn në fuqi vetëm në vitin 2020 dhe, sipas



gazetës spanyolle, kush dëshiron të blejë brazilin, duhet të derdhë 170 milionë euro në arkat e klubit parizien dhe që ka trembur jo pak tifozët e PSG, pasi Real Madridi është vënë prej kohësh në ndjekje të Neymarit.

Fjalëkryqi (1)



HORIZONTAL

2. Gjëja e latinëve.
5. Ai i Kuq u hap për hebrejtë.
9. Eshhtë fjala e për e foshnjës.
11. Ministri Ekonomisë e Pune
13. Marubi i fotografisë.
14. Bel i Mapupassant.
15. Bëhet duke tregtuar objekte të shenja.
18. Derek aktore.
19. Gjysmë totale.
20. Eshhtë art i të folurit
22. Një patriark biblik.
24. Mund të jenë zemërkau të tilla.
26. Janë dëshmorë të Kishës.
28. Eshhtë lloj papagalli.
29. Eshhtë lloj papagalli.
30. Qerre pa qe.

VERTIKAL

1. Novarro që qe aktor.
3. Kusturica regjisor.
4. Eshhtë e jashtëzakonshme.
6. Inicialet e Kazan.
7. Ishte qyteti i 100 portave.
8. Pinci i Dy herë mat.
9. Janë të mirat që prodhohen.
10. Eshhtë ai që gënjen për t'u bërë i njohur.
11. Një markë celulari.
12. Ushtrohej nga fillbustierët.
16. Një përsiatje.
17. Agjencia Informative Tiranë.
21. Një brejtës pylli.
23. Një Gjon që qe aktor i yni.
25. Titulli i Byron.
27. Në radhë të parë.
31. Emri i Amundsen.
36. Moore aktore.
39. Pishtarë pa pishë.
41. Gjysmë vatani.
43. Rruga e Molnar.
45. Një fazë gjumi.
47. Inicialet e Redford.
48. Në krye të notarëve.
49. Inicialet e Reitman.
51. Unë dhe ti.


Fjalëkryqi (2)

HORIZONTAL


1. Nuk kalohet nga mbetësi.
5. U printe gladiatorëve
12. Bëhet duke shkuar lart e më lart
14. Tatum që qe pianist.
15. Një që lufton për para
16. Mund të bëhet me safari
17. Breshkat luftarake të kartonave
19. Ngjitet kur nuk nget
20. Në mes të rrugës
21. Sporti me rikisha
25. U shkrua nga Hesiodi
26. Një sferë për model
27. Mbyllin një sirtar
28. Makina Tipò
30. Inicialet e Bean, aktor
31. Nino, kompozitor i famshëm italian
33. Ramiro pa zë.

VERTIKAL


34. Neill i Jurassic park.
35. E bukura e belle epoque.
37. Qe mbreti i elfëve
39. Farrow, aktore
40. Hagen rockstar
41. Walter i Kush do ta vrasë Charley Verrik
45. Në fund majtas
46. Mund të preken nga morbusi i Basedow
47. Ad... për të ngarkuarin me punë
48. Loach regjisor
7. Kompozoi Mefistofele
8. Në radhë të parë.
9. Qytet zviceran
10. Në krye të kryesisë
11. Ughi violinist
13. Carlos që qe pilot i Formula 1
15. Ekstremitë në muzg
18. Inicialet e Steinbeck
22. Gruda, "Njeriu me top"
23. Eshhtë X ajo e sulmit
24. Paradhoma e parajasës
28. Eshhtë edhe ai i luftës
29. Janë edhe ato të cirkut
31. Mbarojnë fare
32. Inicialet e Reed, aktor
34. Të parët në sondazh
36. Eshhtë taksa
38. Një mund të jetë emërore
39. Një pjesë e marrëzisë
41. Gjysmë mimoze
42. Hundë kur s'jam unë
43. Skuadër greke
44. Lempër, këngëtare gjermane
46. Fundi i një akti



Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

SUDOKU

		9						3
			2				6	
5	8		4					1
			9	3	1			
			1					7
				6			4	
	7			9				
9	1			8				
3					8	2		

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

6	4	3	7	9	5	2	1	8
9	5	8	6	1	2	7	3	4
1	7	2	3	8	4	9	6	5
7	3	1	9	2	8	5	4	6
5	6	9	4	3	7	8	2	1
2	8	4	5	6	1	3	7	9
4	9	6	8	7	3	1	5	2
3	2	5	1	4	9	6	8	7
8	1	7	2	5	6	4	9	3

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Argëtim filozofik

- Vlera që mer diçka që ke fituar, nuk ka të bëjë vetëm me atë që ju ofron, por dhe me çfarë është sakrifikuar për të arritur atë.

- Respekti nuk imponohet, por fitohet.


- Të gabosh është njerëzore, por të falësh është hyjnore.

- Me kalimin e viteve, disa vetëm rriten dhe disa bëhen të pjekur.

KRIPTOSKEME

KRIPTOSKEME

Përgjigja e numrit të djeshëm



- Nuk më vjen keq për gënjeshtat që më the, por më vjen keq se unë kurrë nuk kam për të të besuar përsëri.
- Një gënjeshtër bëhet më e besueshme kur fshihet në mes të dy të vërtetave.
- Pika më e lartë në një kishë nuk është kryqi por rufepëritësja. Një ironi e fizikës, në metafizikë...
- E vërteta shkëlqen akoma edhe kur askush nuk e kërkon.

PËRGJIGJET E FJALËKRYQJEVE TË NUMRIT TË KALUAR

FJALËKRYQI (1)

A P M P K A G I T M
 T I K M O D E I E T R I
 K A P I T E N E T R I Z
 P I R A T E R I A S O
 P A R A K A L I M E T R
 E R C G E R O R A R I
 N O I R E T P E L L E A
 M T N A R A G O N T A
 L E E D S A T E S T E R
 A T I D S A T E S T E R
 N E S O N O R S E A T
 G U T T I S O E D I T I

FJALËKRYQI (2)

E D L T E C M A F I A
 C K O P E R R D E R R
 G H A R A D I A M A N T I
 E P E R D I T S H M E A
 S T A D I U M E T I R A A
 D I K A S T E R I R A A
 M E N N I S S A N
 N O T A S U E L E N A
 O R F T R I M A B O N E
 V E S I M O T E N D
 A A M E N E T R E N E
 K A R A K T E R E T T R

Thënie të mençura

